

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS**  
**SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE**

**SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT DHE**  
**E ARDHMJA E KOSOVËS**

Kollokuiumi Shkencor,  
15 qershor 2011



**PRISHTINË**  
**2012**

**KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS**  
**SECTION OF SOCIAL SCIENCES**

**THE STATE-BUILDING CHALLENGES  
AND THE FUTURE OF KOSOVA**

Scientific Colloquium,  
15 June 2011

Editorial board: academician Esat Stavileci, academician Hivzi Islami and  
academician Pajazit Nushi



**PRISHTINA**  
**2012**

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS**  
**SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE**

**SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT DHE**  
**E ARDHMJA E KOSOVËS**

Kollokuiumi Shkencor,  
15 qershor 2011

Këshilli redaktues: akademik Esat Stavileci, akademik Hivzi Islami dhe  
akademik Pajazit Nushi



**PRISHTINË**  
2012



---

Akademik Pajazit Nushi

**Fjala e hapjes** dhe e përshëndetjes e Akademik Pajazit Nushit, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

I nderuari Kryetar i ASHAK-ut, kolegë, studiues dhe mysafirë,

Hapi punimet e Kollokuiumit Shkencor “Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Republikës së Kosovës”. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Seksioni i Shkencave Shoqërore të saj përcjell vazhdimisht dhe me kujdes proceset politike, ekonomike dhe sociale të shtetndërtimit të Kosovës. Në këtë drejtim ASHAK, për më tepër Seksioni Shkencave Shoqërore dhe anëtarët e këtij institucioni janë angazhuar si në pikëpamje teorike, ashtu edhe në rrafshin praktik në identifikimin e sfidave të shtetndërtimit të Kosovës dhe në zhvillimin e atyre kushteve dhe raporteve që i kontribuojnë konsolidimit të veprimtarisë së të gjitha organeve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. Kemi konsideruar se në këtë kohë, tri vite pas shpalljes së Republikës së Kosovës, studiues profilesh të ndryshme mund t’i paraqesin qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre, të diskutojnë për çështjet me interes të veçantë për të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës, si edhe mund të rekomandohen drejtimet e proceseve, kushtet dhe raportet e përballimit të dukurive, proceseve dhe gjendjeve që do të mundësojnë daljen nga situatat e tashme të Kosovës dhe avancimin e zhvillimit shtetëror të Kosovës. Siç është e njohur, Republika e Kosovës edhe më shumë se tri vjet prej shpalljes së pavarësisë së saj po sfidohet me vështirësi dhe probleme në disa fusha të jetës politike, ekonomike, juridike dhe ndërkombëtare; kanë stagnuar disa procese të shtetndërtimit dhe për këtë shkak Republika e Kosovës ende nuk i ka fituar të gjitha atributet e një shteti funksional në kuptimin e mirëfilltë. Duke u nisur nga kjo gjendje i kemi vënë vetes detyrë të hapim debatin rreth mundësive të përshpejtimit të proceseve shtetndërtuese në Kosovë dhe të ofrojmë ndihmesë profesionale dhe shkencore për të gjitha organet dhe institucionet e Kosovës të të gjitha niveleve.

Lutjes sonë për të marrë pjesë në këtë kollokuium i janë përgjigjur shumë studiues nga Kosova dhe Shqipëria, duke propozuar për shqyrtim tema specifike nga fusha teorike dhe empirike e gjurmimeve të tyre. Në këtë mënyrë u krijuan mundësitë e përpilimit

të programit të punës së këtij kollokuiumi. Siç keni mundur të vëreni, programi i punës së këtij kollokuiumi ka një shtrirje prej katërbëdhjetë temash nga fusha juridike, ekonomike, demografike, politikologjike, të sigurisë, të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të zhvillimit të shkencës dhe mendimit shkencor përgjithësisht.

Qëllimi kryesor i këtij kollokuiumi është ngritja në nivel më të lartë të shqyrtimit teorik dhe praktik të sfidave bashkëkohore të shtetndërtimit të vendit tonë në kuadrin e raporteve të ndërlikuara kombëtare dhe ndërkombëtare Zbërthimi i këtij qëllimi kryesor na shpie të besojmë se pjesëmarrja e studiuesve me përmbajtjen e temave të konceptuara do të sjellë rezultate që mund të deduktohen së paku në dy pikësnyime kryesore: 1. Lartësimi i nivelit dhe i mënyrës së mendimit për gjendjen e tanishme të Kosovës në shumë fusha të ndërlidhura veçore si kusht i përshpejtimit të shtetndërtimit dhe 2. Sugjerimi i ideve, provave, përfundimeve, etj. veprimtarëve politikë në përputhje me vlerën dhe rëndësinë e zgjidhjes sa më të drejtë dhe të plotë të atyre sfidave që e avancojnë ardhmërinë e shtetit tonë – të Republikës së pavarur dhe sovrane të Kosovës. Sikur të arrijmë ta realizojmë këtë qëllim dhe dy pikësnyimet e dala nga qëllimi kryesor i këtij kollokuiumi do t'i bëjmë shërbim të madh kauzës së shtetit të Kosovës dhe zhvillimeve rajonale në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale. Këtë e premtim shumëllojshmëria e temave që do të shqyrtohet, si edhe autoriteti i lartë profesional dhe shkencor i trajtuesve të këtyre temave.

Siç mund të vërehet nga programi i punës së këtij kollokuiumi, përmbajtja e temave që do të shqyrtohen ka të bëjë me rrathë çështjesh të ndërlidhura ndërmjet tyre. Këto rrathë janë: 1. Sfidat e shtetndërtimit dhe 2. E ardhmja e Republikës së Kosovës. Lidhur me rrethin e parë të çështjeve që do të shqyrtohen do të përmendi këto çështje:

1. Kosova, OKB, NATO dhe Bashkimi Europian,
2. Problemet me Veriun dhe në veriun e Kosovës,
3. Çështja e sigurisë së Republikës së Kosovës,
4. Republika e Kosovës dhe të drejtat e liritë e njeriut,
5. Korrupcioni dhe dukuritë e tjera negative në Kosovë,
6. Problemet e sundimit të ligjit në Kosovë, zhvillimi ekonomik në Republikën e Kosovës,
7. Mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare dhe njohjet e pakta ndërkombëtare të Kosovës,

Sa i përket të ardhmes së Republikës së Kosovës çështjet më të rëndësishme për shqyrtim janë:

1. Zgjerimi i numrit të shteteve që e pranojnë Kosovën,
2. Anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Europian,
3. Shteti i së drejtës dhe sundimi i ligjit në Kosovë,
4. Rezoluta 1244 dhe Kosova sot,
5. EULEX-i dhe çështja e sundimit të së drejtës në Kosovë,
6. Kosova dhe bashkëpunimi rajonal,
7. Evropa dhe Kosova, etj.

Duke dëshiruar punë të mbarë, Ju falënderoj për vëmendje.



Akademik Esat Stavileci

## REPUBLIKA E KOSOVËS TRE VJET NGA SHPALLJA E PAVARËSISË

### Qasje e përgjithshme

#### Vrojtime hyrëse

Seksioni i Shkencave Shoqërore i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, po sikurse dhe vetë Akademia si institucion, në kuadër të angazhimit për të bërë publike opinionet rreth rrjedhave të kohës në periudha të ndryshme ka organizuar dhe ka mbajtur diskutime shkencore në të cilat specialistë të fushave të ndryshme, akademikë dhe studiues jashtë Akademisë kanë rrahur mendimet nga të cilat kanë buruar analiza dhe shqyrtime në të cilat janë ndriçuar shumë prej atyre rrjedhave që nga koha e përpjekjeve për avancimin e pozitës kushtetuese të Kosovës në ish-Jugosllavi deri në përcaktimet për shtet të pavarur dhe sovran. Një numër botimesh flet për angazhimin e Akademisë që të bëhet krah i vullnetit të popullit të Kosovës për të qenë i lirë dhe i pavarur, madje në disa procese për të qenë dhe prijëtare e atij vullneti<sup>1</sup>.

Sot përzgjedhja është e dyanshme: është koha që e ka përzgjedhur temën, por është edhe tema që e ka përzgjedhur kohën.

Kosova po kalon nëpër një periudhë të zhvillimit të saj në të cilën po ballafaqohet me një numër sfidash të shtetndërtimit. Akademia, përkatësisht seksioni i shkencave shoqërore të saj, e pa të udhës që të mbledhë në mjediset e saj studiues të fushave të ndryshme. Për diskutim shkencor përzgjedhi: “Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Republikës së Kosovës”.

Siç dihet, në 17 shkurt 2011, Kosova shënoi trevjetorin e pavarësisë së shpallur. Vërtet bëhet fjalë për një periudhë të shkurtër kohore për të bërë analiza të thella dhe për të nxjerrë përfundime të padiskutueshme se në ç’masë dhe në ç’përmbajtje po realizohet pavarësia e Kosovës. Megjithatë, bëhet fjalë për një periudhë, besojmë të mjaftueshme kohore, për t’u marrë me sfidat e shtetndërtimit dhe për të parashikuar të ardhmen e Republikës së Kosovës kundruall atyre sfidave.

<sup>1</sup> Si në rastin e Deklaratës Kushtetuese në vitin 1990.

Kam synuar që fjala ime të jetë më shumë analizuese se sintetizuese; më shumë shqyrtuese se vështruese; më shumë medituese se verbalizuese; më shumë kritikuese se oportuniste. Kjo qasje vetvetiu e ka bërë shumë të vështirë dhe të përgjegjshme si mënyrën e të menduarit, ashtu dhe të nxjerrjes së përfundimeve.

## **Një numër temash për diskutim**

### **Vështirësitë në bërjen e shtetit**

Periodha prej më shumë se tre vjetësh nga shpallja e pavarësisë së Kosovës ka dëshmuar se vështirësitë në bërjen e shtetit të Kosovës vërtet janë të mëdha. Nuk ka fije dyshimi se vështirësitë më të mëdha janë pasojë e ushtrimit të kufizuar të sovranitetit. Kosova është e kufizuar në një numër dimensionesh që parashiheshin në Planin e Ahtisaarit dhe që u bënë ‘pjesë përbërëse’ e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, madje edhe duke ia marrë asaj primatin e të qenët ‘akt më i lartë juridik i shtetit’. Me këtë dokument Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar është pushtet kryesor, me autoritete të gjera ekzekutive, që e bëjnë të jetë superior ndaj organeve të zgjedhura të Republikës së Kosovës. Njëkohësisht ai është edhe autoritet i fundmë i interpretimit të Planit të Ahtisaarit, ndërkohë që vetë Plani i Ahtisaarit përbën ‘shtyllën kurrizore’ të Republikës së Kosovës. Prandaj edhe vetë Deklarata e Pavarësisë së Kosovës ishte, në fakt, siç është thënë tashmë, një ‘përshkrim i obligimeve’ që kishte marrë shteti i Kosovës nga Plani i Ahtisaarit, në rradhë të parë në lidhje me pozitën e pakicave, në mënyrë të veçantë të pakicës serbe dhe, së dyti, në lidhje me praninë ndërkombëtare.

Statusi i Kosovës është produkt i lëkundjeve të mëdha të bashkësisë ndërkombëtare në mungesë të njohjes të së drejtës për vetëvendosje, siç parashikojnë vlerat dhe parimet demokratike për popujt. Kai Eide qysh në raportin e tij në vitin 2005 kishte paralajmëruar se statusi i Kosovës ‘do të zgjidhet ndryshe’ nga zgjidhja e statusit të republikave të ish-Jugosllavisë, po sikurse që kishte paralajmëruar një ‘autonomi të gjerë’ për serbët në veri të Kosovës.

Rrethanat e krijuara politike në Europë nxorën opcionin për pavarësinë e mbikëqyrtur të Kosovës si ‘kërkesë të moderuar të shqiptarëve’, duke menduar se ky opcion do ‘të gjente’ mbështetjen ndërkombëtare. Edhe pse si ‘kompromis’ ky opcion i shqiptarëve u

kundërshtua nga serbët, po sikurse që më vonë u kundërshtua edhe shpallja e pavarësisë dhe për këtë, mbi bazë të një kërkese të Serbisë, u deklarua Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, duke konstatuar se shpallja e pavarësisë nga ana e Kosovës nuk binte ndesh me ligjin ndërkombëtar.

### **Nisma për ndryshimet kushtetuese**

Kuvendi i Republikës së Kosovës, kohë më parë miratoi nismën për ndryshimet dhe plotësimet e Kushtetutës dhe ngriti një komision ekspertësh të partive politike, me mandat të kufizuar, por vetë ai kërkoi zgjerimin e mandatit të tij dhe tash shtrohet pyetja se për cilat ndryshime dhe plotësime të Kushtetutës ka nevojë Kosova: për ndryshime dhe plotësime të kufizuara apo për ndryshime dhe plotësime gjithpërfshirëse?

Duke mbështetur opcionin për ndryshime dhe plotësime më të plota të Kushtetutës, do të më lejoni që me një fjali të zgjeruar t'i kthehem tri defekteve më të mëdha të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për të cilat kisha bërë fjalë qysh me nxjerrjen e saj:

një, shprehjen e Kosovës 'shoqëri multientike', përkundër strukturës(reale) etnike dhe demografike të popullit të saj;

dy, tkurrjen e entitetit kombëtar shqiptar me 'heqjen dorë ose fshirjen nga kujtesa e vlerave të trashëguara kombëtare' dhe

tre, ndalesat për 'shtetin sovran' për 'bashkim me një shtet tjetër ose pjesë të një shteti tjetër'<sup>2</sup>.

Edhe pse është thënë edhe prej të tjerëve, nuk mund të mos (ri)theksohet edhe me këtë rast, fakti se Kushtetuta e Republikës së Kosovës u sfidua qysh nga nxjerrja e saj, nga një anë, në 'barazimin ligjor të ombrellës së UNMIK-ut në Rezolutën e pashfuqizuar 1244' dhe, nga ana tjetër, në 'pozitën neutrale të saj, pra të ombrellës së UNMIK-ut karshi statusit të Kosovës', që në fakt do të thotë kundërshtim të tij.

Qysh atëherë parashihnja si sfidë më vete disfunktionalitetin e administrimit të Kosovës, nëse institucionet e saj nuk do të mund të funksiononin 'në tërësinë e vet tokësore me një sistem juridik'. Disfunktionaliteti i shtetit të Kosovës sot është një realitet.

---

<sup>2</sup> Shih: Esat Stavileci në 'Rrugëtimet dhe labirintet e Kosovës dhe shqiptarëve' - Pavarësia e Kosovës - fakt i ligjshëm që nuk mund të zhbëhet, Forumi për Iniciativë Demokratike, Gjakovë, 2009, faqe 747.

### **Reforma e sistemit zgjedhor**

Sfidë tjetër është sistemi zgjedhor. Kosova ka një sistem joadekuat zgjedhor dhe ky është realitet. Vendi ynë kaloi nëpër një proces të vështirë dhe të stërgjatur zgjedhor. Zgjedhjet e fundit në Kosovë ishin një model se si nuk do të duhej të ndodhte demokracia. Ato në të vërtetë dëshmuar se si mund të dhunohet demokracia. Në dhjetorin e vitit të kaluar ndodhi farsa e zgjedhjeve<sup>3</sup>. Nuk u kontestuan vetëm zgjedhjet, por edhe institucionet e dala prej tyre. Kosova duhet të dalë nga kjo gjendje e defekteve zgjedhore në mënyrë që ajo të mos na përsëritet. Reformimin e sistemit zgjedhor e shoh jo vetëm si nevojë, por edhe si domosdoshmëri. Nuk ka dyshim se ka defekte, por edhe mangësi në legjisllacionin ekzistues elektoral dhe ato duhet të mënjanohen.

### **Ekonomia**

Ekonomia dhe shkalla e ulët e zhvillimit të saj paraqiten si sfidë me vete.

Nuk ka asnjë dyshim se Kosova ka një shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik. Ekonomistët këtë e shohin si pasojë të gjendjes së trashëguar dhe ngecjes në zhvillim për një kohë të gjatë. Tranzicioni ekonomik, sikurse edhe në vendet e tjera, ‘ballafaqohet me sektorin e dobët publik’. Ekonomia ka nevoja të mëdha për mjete financiare. Kosova do të ketë nevojë për ‘përkrahje të mëtutjeshme në ndërtimin e kapaciteteve në fushën e menaxhimit zhvillimor dhe të qeverisjes dhe në ndërtimin e marrëdhënieve me institucionet financiare ndërkombëtare’. Objektiv i rëndësishëm i Kosovës duhet të jetë ‘arritja e një niveli më të lartë të rritjes ekonomike, i cili do të frenonte trendin e papunësisë dhe do të ndihmonte në reduktimin e diferencave në zhvillim me vendet në regjion dhe me vendet e tjera europiane’<sup>4</sup>.

---

<sup>3</sup> Shih me gjerësisht në revistën mujore „Juristi“, dhjetor 2010.

<sup>4</sup> Kapitulli mbi Bazën shoqërore dhe qëndrueshmërinë ekonomike në librin e Esat Stavilecit ‘Rrugëtimet dhe labirintet’..., faqe 327-332.

### **Problemet me veriun**

Problemet me dhe në veriun e Kosovës veçsa po shtohen dhe ato ndoshta përbëjnë sfidën më të madhe. Ato probleme e kanë origjinën që me vendosjen e trupave ndërkombëtare në Kosovë. Qysh atëherë kishte ndodhur një ‘ndarje e heshtur’ e pjesës veriore të Mitrovicës dhe veriut përgjithësisht<sup>5</sup>.

Bashkësia ndërkombëtare me kohë nuk u mor me mundësitë e parandalimit të ndarjes së Kosovës. Në veriun e Kosovës Serbia ndërmori shumë veprime në të cilat nuk u reagua nga ana e saj. Të kundërtën, disa prej tyre ndodhën dhe me miratimin e saj, ndërkohë që edhe institucionet e Kosovës ‘shtireshin’ sikur asgjë nuk po ndodh ose sikur po ndodh në një territor të një shteti tjetër.

Përpjekjet e mëvonshme për t’i bashkuar pjesët e ndara nuk dhanë ndonjë rezultat. Nga një problem i paqenë, Mitrovica dhe veriu u bënë ‘çështje ndërkombëtare’. Për pasojë, ndodhi boshatisja e veriut nga shqiptarët. UNMIK-ut joefikas iu shtua EULEX-i jorendimental në fushat për të cilat kishte shtrirë vendosjen e tij. Madje pati dhe përplasje autorizimesh. Institucionet e Kosovës nuk arritën që të shtrijnë pushtetin, ligjin dhe kontrollin në atë pjesë të territorit të Kosovës. Si rrjedhojë, u pamundësua sovraniteti i Kosovës dhe u zgjerua ndikimi i strukturave paralele (ilegale) qeveritare serbe. Involvimi i Beogradit në atë pjesë të territorit të Kosovës është i madh dhe i ndikueshëm te banorët lokalë serbë, të cilët mbajnë qëndrim kundërshtues ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës. Nga zyrtarë të bashkësisë ndërkombëtare vijnë zëra se veriu ‘nuk do të ndahet’ dhe se ‘nuk do të lejojmë ndarjen e tij’, ndërkohë që ‘ndarja’ është bërë ‘fjalor zyrtar’ i Beogradit zyrtar. Një gjë është e sigurt: kufiri me Serbinë nuk është te lumi Ibër, e ura është bërë ‘pikë ndarjeje’ dhe ndërkombëtarët për këtë janë të vetëdijshëm. Ndërkohë që flitet për ‘mosndarje’ nuk ka asnjë angazhim për ‘bashkim’ të dy pjesëve të Kosovës. Veriu mbetet kapitull i papërfunduar dhe storie që nuk e mbyllin dot deklaratat e ndërkombëtarëve. Institucionet e Kosovës ende po tregohen të pafuqishme dhe atyre po u mungojnë iniciativat dhe përpjekjet për ta ndryshuar gjendjen.

U provua me një të quajtur ‘strategji për veriun’, por ajo përfundoi në një raport ku vetëm u konstatua gjendja faktike në këtë

---

<sup>5</sup> Esat Stavileci, Kosova dhe shqiptarët në udhëkryqet e kohës - Political History of the Kosova Issue, Instituti për Studime Bashkëkohore, Prishtinë, 2005, faqe 44.

pjesë të territorit të Kosovës. Raporti në të vërtetë flet jo vetëm për ekzistencën, por edhe për ‘forcimin e vazhdueshëm të Serbisë në veri të Kosovës’.

Një gjë duket e qartë: sa më shumë që zgjasin ‘hamendjet’, trashen prolemt, sa më shumë që trashen problemet, bëhen më të vështira për zgjidhje.

### **Persiatjet për ndarjen e Kosovës**

Persiatjet për ndarjen e Kosovës, veçanërisht ato serbe, paraqesin modele dhe propozimzgjidhje që mund të rrezikojnë drejtpërsëdrejti stabilitetin e Kosovës dhe të rajonit përgjithësisht. Serbët historikisht kanë pasur oreks për ‘mbajtjen nën kontroll’ të hapësirës dhe territorit të Kosovës gjoja në emër të ‘posesivizmit serb’, i cili megjithatë, nuk mund të qëndrojë për shkak të mungesës së bazës etnike.

Idetë, propozimet dhe projektet serbe për ndarjen e Kosovës nuk janë të reja, prandaj nuk duhet të na befasojnë as këto të fundit. Të vazhdueshme kanë qenë përpjekjet serbe për gëllabërimin e tokave shqiptare. Ndër popujt e Ballkanit, shqiptarët kanë pësuar copëtimin territorial më të madh. Sot trojet e shqiptarëve ndodhen të pjesëtuara ndërmjet disa shteteve të Ballkanit.

Janë zhvilluar disa runda bisedimesh Prishtinë – Beograd.

Edhe pse bisedimet janë quajtur ‘teknike’, në BE janë dëgjuar zëra se në to do të duhej të përfshihej edhe ‘fati politik dhe administrativ i veriut të Kosovës’, ndonëse jo dhe statusi i saj, pa vra mendjen se veriu dhe fati politik dhe administrativ i tij ndërlidhet pikërisht me statusin e Kosovës. Ndërkohë që BE-ja njëanshëm porositi se ‘çfarëdo që do të ndodhte në fund të këtyre bisedimeve rreth situatës në veri të vendit, duhet pasur kujdes që të mos hapen plagë të reja në Luginën e Preshevës dhe në Maqedoni’, edhe vetë e ndërgjegjshme për ndërlidhjen apo ‘fatin e përbashkët të tyre’. Ka pasur zëra për ndonjë model, si ai i Tirolit Jugor, apo për ndonjë lloj tjetër autonomie në veri që për Kosovën janë zgjidhje të papranueshme.

Pati një iniciativë për ndërprerjen e bisedimeve me Serbinë së cilës Kuvendi i Kosovës nuk i dha mbështetje, por ai vuri ‘vijat e kuqe’, duke u deklaruar se nuk mund të jenë pjesë e dialogut teknik

me Serbinë statusi i Kosovës, sovraniteti dhe integriteti territorial i vendit.

Serbia po kërkon ‘hise’ në territorin e Kosovës, pa qenë e ndërgjegjshme se është pikërisht ajo që e kishte pushtuar Kosovën nga 1912-ta dhe disa herë të tjera, më 1918, më 1945 dhe më 1989.

Është thënë me të drejtë se ‘kufiri duket më qartë’ mbi urën e Ibrit në Mitrovicë, ‘sesa atje ku do të duhej të ishte një kufi ndërshtetëror me Kosovës dhe Serbisë’. Kjo është një ndarje ‘de facto’ e Kosovës, të cilën bashkësia ndërkombëtare ‘nuk e pranon’, sepse ‘vërtet është kundër ndarjes formale të Kosovës duke iu frikësuar një domino efekti në një rast të tillë’.

Një gjë është e sigurt: ‘logjika e ndarjeve’ nuk do të mund ‘as të fillonte dhe as të përfundonte me Kosovën, por do të zhvillohej si një proces zinxhiror’. Kjo është arsyeja që bashkësia ndërkombëtare mban një qëndrim kundërshtues ndaj konceptit të ndarjeve në rajon përgjithësisht.

Serbia po ‘tregohet zemërgjerë’ dhe po na ‘ofron bashkimin me Shqipërinë’ nëpërmjet ‘ndarjes së Kosovës midis Serbisë e Shqipërisë’, pa vra mendjen se Serbia asnjëherë më nuk do të mund të vendosë për Kosovën dhe se do të jetë çështje e popullit të Kosovës për të vendosur për fatet dhe të ardhmen e tij.

Serbia, duke e ‘ndarë Kosovën midis saj dhe Shqipërisë’, do të dëshironte që ‘t’i shmangej’ njohjes së Kosovës si shtet.

### **Shteti i së drejtës**

Krijimi i shtetit të së drejtës është ndër objektivat e rëndësishme të Kosovës, por edhe sfidë më vete për institucionet në shtetin e ri të Kosovës. Shteti i së drejtës vështirë se mund të krijohet pa një shkallë të kënaqshme të sundimit të ligjit në Kosovë. Shteti duhet të ndërtohet mbi bazën e ligjeve. Vetë organet e pushtetit duhet t’u nënshtrohen ligjeve. Legjislacioni duhet të jetë i formuluar mirë, në mënyrë të qartë e precize. Qeverisja duhet të bazohet në parimin e ndarjes së pushteteve në mënyrë që të mos lë hapësirë që të jetë autoritare. Në mënyrë të veçantë duhet të sigurohet pavarësia e pushtetit gjyqësor.

Për të siguruar një ndarje më të qëndrueshme të pushteteve do të duhej të funksiononte sistemi i kontrollit dhe i ekuilibreve të pushteteve<sup>6</sup>.

### **Ecejaket e diplomacisë**

Kosova ende nuk ka një diplomaci vepruese. Janë të pamjaftueshme rezultatet e deritashme të saj. Sfidë më vete paraqesin disa qendra të diplomacisë së Kosovës.

Kosovën e kërcënon ‘diplomacia paralele’. Mendohet se do të duhej të kishte një ‘zinahir komandues’, një ‘hierarki të qartë’. Kemi përshtypjen se Kosova nuk është me një adresë të qartë në fushën e diplomacisë. Nëse i referohemi Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nga ajo mësojmë se presidenti udhëheq me politikën e jashtme, ndërkaq në qeveri përgjegjës është ministri i punëve të jashtme. Mirëpo në këtë fushë janë angazhuar edhe dy zëvendëskryeministra, kështu që ka një konfuzion dhe ‘përplasje kompetencash’ dhe për pasojë mungesë bashkërendimi të bartësve të politikës së jashtme të Kosovës.

Nuk është bërë sa duhet në shpërndarjen e së vërtetës në lidhje me krimet e kryera të Serbisë në Kosovë. Përgjithësisht, Serbia ka përfitur jo vetëm nga heshtja jonë, por edhe nga ‘heshtja botërore’ për krimet e kryera jo vetëm ndaj shqiptarëve, por edhe ndaj popujve të tjerë në Ballkan. Bota ende nuk e ka marrë të vërtetën e plotë. Na takon edhe neve që ta themi pjesën tonë të së vërtetës për krimet e Serbisë në Kosovë.

Kosova pa dyshim se ‘ka nevojë për një përmirësim të imazhit të saj të dëmtuar’. Njëkohësisht ka nevojë ‘të promovojë vlerat e veta në botë’.

### **Njohjet**

Dialogu me Serbinë po reflekton negativisht në procesin e njohjeve. Serbia arriti që të bindë një numër shtetesh që të presin se çfarë do të sjellë dialogu me Prishtinën, në të cilin ajo hyri pa parë as qëllimin dhe efektet dhe as fundin e tij, madje edhe pa një qëndrim të harmonishëm të forcave politike.

---

<sup>6</sup> Me gjerësisht: Luan Omari, Shteti i së drejtës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, ‘Elena Gjika’, 2004.

Problem më vete paraqet tendenca e Serbisë për ndërrim të ‘dimensionit të dialogut’ dhe për këtë flet kryesuesja e dialogut. Në fakt bëhet fjalë për synimin e Serbisë që ‘ta bëjë politik dialogun’.

Ritmi i njohjeve të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës pas GJND-së, që u shpreh se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk bie ndesh me normat e së drejtës ndërkombëtare, në vend se të përshpejtohej, ai u ngadalësua, madje dukshëm. Një kohë Serbia kërkonte mosnjohjen e pavarësisë dhe të sovranitetit të Kosovës nga vendet e tjera në pritje të një mendimi të GJND-së; mandej në pritje të një rezolute të OKB-së që do të ftonte palët në dialog, e tash në pritje të rezultateve të dialogut. Një zyrtar yni, i angazhuar në lobim për njohjen e Kosovës nga shtetet e tjera, deklaroi para disa ditësh se ‘shumë shtete thonë se ju jeni duke biseduar tash, – rregulloni marrëdhëniet me Serbinë dhe ne ju njohim më vonë’.

Pseudoshkenca serbe ka bërë dhe vazhdon të bëjë propagandë për ta paraqitur Kosovën si ‘tokë të veten të shenjtë’, pa vra mendjen se nuk mund të qëndrojnë shkencërisht pikëpamjet mbi gjoja të ‘drejtën historike serbe’ në trojet e Kosovës. Vlen të theksohet se qytetarët e Kosovës edhe në kohën e pushtimit të saj nga Serbia e ndienin këtë troll të vetin dhe të patjetërsueshëm.

## **Integrimi**

Procesi i integrimit të Kosovës në strukturat europiane është një sfidë e madhe për institucionet e Kosovës. Kjo sfidë është më e madhe për shkak të mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës nga pesë shtete anëtare të Bashkimit Europian.

BE-ja do ta ndihmojë integrimin e Kosovës nëse institucionet e saj do të kenë një agjendë të qartë për integrim të vendit - porosisin zyrtarë të BE-së. Institucionet e Kosovës duhet të jenë të përkushtuara për ‘të përmbushur kushtet e kërkuara nga BE-ja për integrim të vendit’.

Në BE thonë se pa njohjen nga të gjitha vendet anëtare ‘nuk mund të ketë raporte kontraktuale me Kosovën’.

Në BE mund të hyjnë vetëm ‘vendet e lira, vendet ku sundon rendi e ligji, ku mediat janë të lira, ku gjykatësit janë të pavarur, ku politika nuk është profesion për t’u pasuruar’. Prandaj ‘Kosova europiane’ realisht është ende larg.

Anëtarësimi i një vendi në Bashkimin Europian nuk shihet si ‘një akt’, por si një ‘proces’. Ky proces niset nga të qenët ‘shtet sovran’ dhe transformimi në ‘shtet anëtar’, duke kaluar statusin e ‘shtetit pretendues’, pastaj të ‘shtetit aspirant’, të ‘kandidatit potencial’, më tutje në ‘shtet aplikant’, në ‘shtet kandidat’, mandej në ‘shtet negociator’ deri në statusin ‘shtet-anëtar’<sup>7</sup>.

Anëtarësimi i Kosovës në OKB dhe në NATO janë një perspektivë e Kosovës, sigurisht më e largët se që e mendonin dhe e parashihnin zyrtarët e Kosovës.

### **Bashkëpunimi me vendet e rajonit**

Shkalla e bashkëpunimit rajonal nuk po ecen me ritmin e duhur. Ka një shkallë bashkëpunimi, por ende të vakët. Natyrisht se nuk ka bashkëpunim me Serbinë.

Njohja e Kosovës nga ana e Serbisë nuk shihet si kusht për Serbinë për anëtarësim në BE edhe pse ky në fakt do të duhej të përbënte kushtin më kryesor zyrtar.

‘Raportet e mira të Beogradit dhe Prishtinës thonë shumë për Beogradin, por pothuajse asgjë për Prishtinën’; do të thonë shumë për Beogradin, të cilit i nxitohet për të marrë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE<sup>8</sup>.

### **Lidhjet e Kosovës me Shqipërinë**

Kosova dhe Shqipëria mund të bëjnë shumë më tepër në thellimin dhe forcimin e bashkëpunimit. Shqipëria dhe Kosova një kohë shumë të gjatë janë sjellur si dy botë krejtësisht të ndara njëra me tjetrën. Ka pasur dhe ka përpjekje për bashkëpunim, por ai nuk është ende në përputhje me mundësitë dhe nevojat që kanë dy vendet. Shqipëria dhe Kosova janë më shumë se dy vende fqinje. I lidh gjaku, gjuha dhe gjeografia, prandaj ato do të duhej të vendosnin marrëdhëniet që nuk do të vënin në pyetje identitetin e njëjtë kombëtar të popullsisë shumicë në to, një edhe të padiskutueshëm që vetvetiu mban të hapura shtigjet për integritet brendakombëtarë pothuajse në të gjitha fushat.

<sup>7</sup> Shih Blerim Reka, Gjeopolitika dhe teknika e zgjerimit të UE-së, Bruksel, Shkup, 2010.

<sup>8</sup> Augustin Palokaj i bëri një vështrim të mirë këtij problemi në „Koha ditore“ të Prishtinës, të datës 28 mars 2011.

## **Një numër përfundimesh**

Një numër përfundimesh nga kjo fjalë që po mbaj sot në këtë kollokuium shkencor do të mund të nisej nga konstatimi se Kosova paraqet një shtet ende të papërfunduar; me mungesë shtrirjeje të autoritetit në tërësinë e vet territoriale; me një legjitimitet ende të panjohur ndërkombëtar; me institucione të dobëta qeverisëse dhe me një mungesë qartësie të pranisë ndërkombëtare. Mbi këtë pjesë të pasqyrës së Kosovës më shumë se tre vjet prej shpalljes së pavarësisë së saj do të mund të nxirreshin disa përfundime për të kapërcyer gjendjen në të cilën ndodhet.

Ndonëse BE-ja shtron tri kërkesa për institucionet e Kosovës: luftën kundër korrupsionit, përmirësimin e sundimit të ligjit dhe reformat, fjalën time do ta përmyll me një spektër më të gjerë problematikash me të cilat ballafaqohet aktualisht Kosova, duke pasur parasysh edhe temat që do të shtrohen për diskutim në këtë kollokuium shkencor.

Ato nuk i shoh vetëm të nevojshme, por të domosdoshme. Mbështes angazhimin për ndryshime dhe plotësime në më shumë fusha e jo vetëm në atë që ndërlidhet me zgjedhjen e presidentit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës duhet rishikuar në raport me gjendjen që është paraqitur në fushën e zbatimit të saj dhe duhet ndryshuar dhe plotësuar aktin kushtetues të vendit nëse mungesa e normave dhe zgjidhjeve kushtetuese është bërë vetë pengesë e zbatimit të saj. Një qëndrim kritik duhet mbajtur veçanërisht ndaj zgjidhjeve që i referohen pranisë së theksuar ndërkombëtare dhe mandatit ekzekutiv të saj.

Sa i përket reformës zgjedhore, zgjidhja mund të kërkohet në ‘kombinimin e sistemeve zgjedhore’. Në këtë fazë Kosova ballafaqohet me kufizime kushtetuese. Ndoshta ‘duhet që të arrijë një marrëveshje që të prodhojë një legjitimitet për një sistem mazhoritar me sistem proporcional, me ekuilibrat e pranueshëm, në mënyrë që t’u mundësojë qytetarëve që në mënyrë të drejtpërdrejtë të zgjedhin’. Padyshim se ndihet nevoja për reformë substanciale të sistemit zgjedhor. Vendi duhet të ndahet në zona zgjedhore: deputetët duhet të kenë ‘adresën e saktë të përgjegjësisë’.

Edhe pse me vokacion nuk jam ekonomist, më shqetësojnë problemet që e shoqërojnë transicionin ekonomik. Sfidat e zhvillimit

ekonomik mund të kenë një shtrirje më të gjerë, por më duket se kanë përparësi, si rekomandojnë vetë ekonomistët<sup>9</sup>.

Veriu mbetet segmenti më i ndjeshëm i stories së papërfunduar të shtetit të Kosovës.

E ardhmja e Kosovës duhet të ndërtohet mbi ‘bërthamën e demokracisë’, e cila ‘balancën e koparticipimit të pakicës demografike’ në pushtetin politik e vendos me respektimin e realitetit demografik të gjithë territorit.

Do të duhej të eliminohej fuqishëm dhe përfundimisht involvimi dhe ndikimi i Beogradit në jetën politike dhe proceset zhvillimore në Kosovë. Ky na duket ‘çelësi’, ndoshta më kryesor, i tejkalimit të problemeve në veriun e Kosovës.

Duhet të kihet parasysh se Kosova ka një kushtetutë, një sistem ligjor që duhet të shtrihet në gjithë territorin e saj, prandaj janë të papranueshme përpjekjet për të vendosur dy sisteme të ndryshme konkurruese juridike.

Lidhur me dialogun mendoj se ai ka qenë dashur të kushtëzohet me arritjen e një konsensusi në politikën e jashtme të BE-së ndaj Kosovës, meqë siç dihet, politika e BE-së ndaj Kosovës ‘përcaktohet nga pesë vende që ende nuk e kanë njohur Kosovën’.

Sundimi i ligjit duhet parë si një segment shumë i rëndësishëm për integritet europian. Avancimi i sistemit të drejtësisë është një prej parakushteve për të ndërtuar shtetin e së drejtës dhe për të siguruar sundimin e ligjit, nëse nuk duam që nga pretendimet për ta krijuar shtetin e së drejtës të mos rrëshqasim në kërcënimet për t’u ndeshur me shtetin e së padrejtës.

Kosovës i duhet një diplomaci shumë më aktive dhe më vepruese. Lobimi për njohjet duhet të jetë më i organizuar dhe më i konsoliduar, por para së gjithash i bashkërenduar.

Diplomacia e një shteti sot është e rëndësishë kapitale jo vetëm për atë shtet, por në përgjithësi për rrjedhën e tërë marrëdhënieve ndërkombëtare. Synimi themelor i strategjisë diplomatike të Kosovës duhet të jetë ‘transformimi i pozitës së Kosovës nga një objekt i

---

<sup>9</sup> Kapitulli për bazën shoqërore dhe qëndrueshmërinë ekonomike në ‘Rrugëtimet dhe labirintet’): shtrirjet në ‘rritjen ekonomike’, ‘frenimin e trendit të papunësisë’; ‘frenimin e tendencave në zhvillimin ekonomik regjional brenda Kosovës’ dhe ‘reduktimin e diferencave në zhvillim me vendet në regjion dhe me vendet europiane’.

marrëdhënieve ndërkombëtare në subjekt të tyre'. Platforma e diplomacisë së Kosovës duhet të synojë, së paku, dy rezultate konkrete: një, hapjen e perspektivës europiane të Kosovës dhe dy, hapjen e shtegut për anëtarësimin e vendit në mekanizmat ndërkombëtarë.

Kosova duhet të ndërgjegjësohet se 'procesi i transformimit nga shteti sovran në shtetin anëtar të Bashkimit Europian është një proces i gjatë, i ndërlikuar dhe jo gjithnjë i sigurt'<sup>10</sup>. Përgjithësisht, Ballkanit Perëndimor 'i nevojitet integrimi në Bashkimin Europian', si mendohet 'për t'i relativizuar kufijtë e imponuar që sollën aq shumë tragjedi njerëzore', sepse 'zgjidhjet territoriale të problemeve kombëtare nuk e qetësojnë Ballkanin' për shkak se 'jo të plotë u treguan edhe përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare...'

Bashkëpunimi rajonal duhet zhvilluar mbi bazën e respektit të ndërsjellë. Ky parim nuk po respektohet. Po ndodh që Kosova ndonjëherë të përjashtohet fare nga ky bashkëpunim. Kosova duhet të mbajë qëndrimin e një shteti të pavarur dhe sovran dhe të mos i nënshtrohet presioneve. Kosova duhet të angazhohet në zhvillimin ekonomik dhe të mirëqenjes së përgjithshme në të gjitha shtetet e rajonit, duke synuar bashkëpunimin me të gjitha shtetet e rajonit në të gjitha fushat. Unifikimi i qëndrimeve dhe politikave me qëllim të zhvillimit të përbashkët të vendeve të rajonit si 'mundësi për anëtarësim sa më të shpejtë në Bashkimin Europian dhe në strukturat tjera ndërkombëtare'.

Bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri po jep rezultatet e para, por larg mundësive dhe kërkesave për vënien e lidhjeve në të gjitha fushat e jetës.

Për të qenë shtet në kuptimin funksional, Kosovës i duhet:

- (1) Marrja e përgjegjësive të plotë për të qeverisur me të.
- (2) Sigurimi dhe garantimi i tërësisë territoriale.
- (3) Supermacioni i kushtetutës ndaj rregullave të tjera.
- (4) 'Veshja' me sovranitet.
- (5) Subjektiviteti i plotë politik, juridik dhe ndërkombëtar<sup>11</sup>.

---

<sup>10</sup> Blerim Reka, po aty.

<sup>11</sup> Esat Stavileci, Shteti, shqyrtime të përgjithshme me vështrim rasti i Kosovës, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2008.

Për ta përmyllur fjalën, nuk mund të mos i kthehem nevojës për ‘t’u bërë bashkë’ në veprime të përbashkëta; për të kërkuar dhe për të gjetur udhët për daljen nga një gjendje që mund të na ‘sjellë në rreth’.

Ndërkohë, një pyetje pret përgjigje: nëse Kosova nuk po arrin ende të bëhet një shtet funksional, kur mund të bëhet dhe a mund të bëhet në kornizat e tanishme? Mbase kjo pyetje mund të jetë objekt më vete i një debati tjetër.

Prof. dr. Arian Starova

## **MBI SFIDAT PARËSORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Më lejoni fillimisht të shpreh mirënjohjen time për ftesën që të marr pjesë në këtë Kollokuium Shkencor dhe për mundësinë që të shprehem rreth një teme kaq të rëndësishme për sigurinë dhe të ardhmen e Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj, siç është tema e sfidave të shtetndërtimit.

Rëndësia e trajtimit të kësaj teme madhore mund të jetë e shumëfishtë, por unë do të doja të theksoja vetëm dy përbërës të saj që sipas meje qëndrojnë në themel të kësaj rëndësie: i pari, shtetndërtimi i suksesshëm në Kosovë është argumenti më i fortë në procesin e mundimshëm politik të forcimit të vendit dhe të rolit të Republikës së Kosovës në sistemin e sotëm ndërkombëtar dhe, i dyti, shtetndërtimi nuk është qëllim në vetvete, por vetëm mjeti për krijimin e një jetese dinjitoze ekonomike dhe shoqërore për qytetarët e Kosovës.

### **Republika e Kosovës ka lindur në një truall me traditë të vjetër shtetndërtuese**

Fillimisht do të doja të them pak fjalë përreth idesë se Republika e Kosovës si shtet është krijuar në vijim të një tradite të vjetër shtetndërtuese, por me këtë ide nuk synoj as të debatoj me historianët që pa dyshim janë më të informuar dhe as të përpiqem të konkurroj me ta. Arsyetimi që më ka çuar te kjo ide është i lidhur, nga njera anë, me disa fakte të mirënjohura të historisë dhe, nga ana tjetër, me faktin kryesor bashkëkohor të procesit të suksesshëm të shtetndërtimit në Kosovë. Përgjithësisht mund të pranohet arsyetimi sipas të cilit mund të ekzistojnë procese të sukseshme shtetndërtuese edhe pa përvojë të mëparshme. Megjithatë, kur ekziston një përvojë e mëparshme shtetndërtuese, siç është rasti i Kosovës, atëherë kjo çështje vendoset në rrethana historike të vërteta dhe bart ngarkesë argumentuese me vlerë në debatin e vjetër i cili ndonjëherë shfaqet tërthorazi edhe sot mbi traditën shtetformuese të shqiptarëve.

Shteti si koncept ka, natyrisht, përcaktimet e tij shkencore të cilat sado të ndryshojnë prej njeri-tjetrit kanë një thelb të përbashkët që lidhet me elementë përbërës të tillë si: vetëdija historike për

dallueshmëri kombëtare e qytetarëve të tij dhe një ideologji që lidhet me të, territori i caktuar i lidhur patjetërsueshmërisht me jetën e këtyre qytetarëve, institucionet vetëqeverisëse të ndryshme të vështruar pavarësisht prej formës së tyre, elita drejtuese vendëse, aftësia e shtresave të ndryshme të qytetarëve për të ushtruar fuqi apo pushtet në emër të një dallueshmërie kombëtare, tërësia e rregullave apo ligjeve që përcaktojnë mënyrën e të drejtuarit të bashkësisë njerëzore të qytetarëve që i përkasin shtetit, aftësia e qytetarëve për t'u vetorganizuar për shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të ndryshme shtetësore, etj., etj. Në vijim të kësaj ideje do të doja të sqaroj se unë e vështroj shtetin në këtë fjalë timen dhe rrjedhimisht shtetndërtimin në një kuptim më të gjerë sesa vetëm si tërësi e institucioneve politike dhe juridike.

Vështruar në këtë mënyrë, tradita shtetndërtuese në Kosovë ka qenë përherë e pranishme dhe e pavaruar prej pushtimit serb. Ajo ka kaluar përmes shekujve me luftra e përpjekje të shumta të armatosura të shqiptarëve për pavarësi për të arritur te simbole të ndryshme të përpjekjeve për shtetndërtim si Lidhja e Prizrenit, Konferenca e Bujanit, Krahu Autonom e Kosovës e viteve 1970, organizimi i strukturave vepruese shtetërore paralele të fshehta të Kosovës të viteve 1990 dhe përvoja e re “de facto” thujse dhjetëvjeçare e Republikës së Kosovës së sotme. Historia e Kosovës dhe e gjithë shqiptarëve tregon qartë për këto përpjekje shtetndërtuese. Elita drejtuese politike dhe shoqërore e Kosovës së sotme është vijimësi e kësaj tradite të çmuar. Pavarësisht se në të kaluarën e afërt kjo elitë ishte më shumë e lidhur me profesionet e veçanta, me kulturën dhe mbahej prej rregjimit serb larg vendimmarrjes së vërtetë në interes kombëtar të Kosovës, pikërisht prej kësaj elite lindi dhe u krijua elita e sotme politike dhe shoqërore e Kosovës demokratike, e cila përfaqëson dhe drejton me aftësi institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, por edhe veprimtarinë e institucioneve joqeveritare.

Idëja ime kryesore në këto arsyttime paraprake është të theksoj diçka që ndoshta e kemi menduar jo si shumë të rëndësishme, pra të theksoj faktin që Republika e Kosovës vjen nga një traditë e pasur shtetndërtuese e cila qëndron në rrënjë të sukseseve të saj të deritanishme dhe përbën garanci për sukseset e ardhshme në çështjet e shtetndërtimit. Dhe, natyrisht, me këtë nuk dua të mohoj aspak rolin e madh të faktorit ndërkombëtar në ngritjen dhe forcimin e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës. Kollokuiumi i sotëm është rast për të shprehur edhe një herë mirënjohje të thellë ndaj

të gjitha institucioneve ndërkombëtare për rolin e tyre të jashtëzakonshëm për ndërtimin e institucioneve shtetërore të Kosovës së sotme.

### **Shteti i sotëm i Kosovës është i aftë, veprues dhe i vlerësuar ndërkombëtarisht**

Çështja e shtetndërtimit jo vetëm në Kosovë, jo vetëm në Shqipëri, por ndoshta në të gjithë botën është diçka që në thelb nuk mbaron kurrë. Institucionet shtetërore dhe ligjet që lidhen pazgjidhmërisht me to përballen përherë me realitete që ndryshojnë e zhvillohen dhe në përpjekje për t'iu përshtatur atyre lind nevoja që ato të ndryshojnë, të përmirësohen dhe të përsosen. Pavarësisht prej kësaj së vërtete të njohur, përparimet në shtetndërtim janë të matshëm dhe të vlerësueshëm.

Megjithë problemet e shumta që mund të ketë ndërtimi e përsosja e institucioneve shtetërore të Kosovës sot, vlerësimet e përgjithshme për to janë shumë të mira dhe premtuese për përparime edhe më të përshpejtuara në vitet që vijnë. Mendoj se në mbështetje të këtij sukcesi në fushën e shtetndërtimit të Kosovës mund të sjellim disa argumente të qarta e të dukshme, të cilët janë pranuar e vlerësuar nga faktorë të ndryshëm ndërkombëtarë.

- Njohja e Republikës së Kosovës nga shumë shtete numri i të cilëve ka arritur në ditët e fundit në 76, shifër e cila është shumë premtuese për përshpejtimin e njohjeve në vijim. Këtu ndoshta mund të përmendnim edhe fakte të tillë, si rritja e mbështetjeve të shteteve të fuqishme të veçanta për Kosovën, mbështetje e cila shkon shumë përtej njohjeve zyrtare shtetërore, duke çuar edhe në formësime lobimesh ndërkombëtare për Kosovën, siç janë:
- Ekzistenca e një sistemi shumëpartiak modern, veprues dhe i frytshëm;
- Organizimi i disa zgjedhjeve demokratike të përgjithshme dhe vendore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare, pavarësisht se ato kanë qenë të shoqëruara edhe me probleme të ndryshëm të natyrshme për një shtet të ri;

- Krijimi dhe zhvillimi i institucioneve të tilla të shtetit si Kuvendi, Presidenca dhe Qeveria dhe agjenci të tjera të veçanta;
- Krijimi dhe forcimi i sistemit të forcave të sigurisë dhe të policisë, të cilat japin ndihmesën e tyre gjithnjë e më të madhe e të veçantë krahas faktorit ndërkombëtar;
- Ekzistenca e një infrastrukture ligjore demokratike e cila pasurohet e përsoset vazhdimisht me ndihmesën e veçantë të Kuvendit të Kosovës;
- Organizimi dhe përmirësimi i sistemit gjyqësor të pavarur, i cili bëhet gjithnjë e më shumë garantues i zbatimit të ligjit të barabartë për të gjithë në Kosovë;
- Hedhja e themeleve të një administrate publike të aftë e moderne;
- Ngritja dhe zhvillimi i një sistemi modern arsimor publik e privat;
- Përmirësimi i ndjeshëm i marrëdhënjëve ndëretnike dhe respektimi i të drejtave të pakicave sipas standardeve ndërkombëtare;
- Forcimi i themeleve të ekonomisë së tregut dhe fillimi i rritjes së investimeve të huaja dhe vendëse;
- Organizimi i një sistemi mediatik të mirë dhe veprues i cili bën të mundur informimin e opinionit publik dhe nxit debatin politik e shoqëror për probleme të ndryshëm të jetës së gjithanshme të Kosovës;
- Krijimi i një tërësie organizatash të larmishme joqeveritare dhe jofitimprurëse të cilat ndihmojnë në shfaqjen dhe mbrojtjen e interesave të grupeve të ndryshëm të shoqërisë ose në zhvillimin e vlerave të ndryshme të jetës shoqërore në Kosovë;
- Zgjerimi dhe zhvillimi modern i elitës drejtuese vendëse në të gjitha fushat e veprimtarisë politike, shoqërore, shkencore dhe kulturore të Kosovës;
- Krijimi dhe zhvillimi i lidhjeve dhe marrëdhënieve diplomatike ndërkombëtare me shtete dhe organizata ndërkombëtare në rajon dhe në botë.

Natyrisht, për të gjithë këta argumentë të njohur madhorë të lartpërmendur mund të flitet me vlerësime pozitive edhe më të hollësishme, por unë jam ndalur vetëm në një vështrim të

përgjithshëm të tyre prej një këndvështrimi politik dhe të prirjes së përgjithshme të zhvillimit të shtetndërtimit. Hulumentimi më në thellësi i tyre ekziston i pasqyruar në qindra e ndoshta mijëra dokumente të tjera vendëse dhe të huaja të cilët janë objekt dhe frut i punës së një tërësie ekspertësh e specialistësh shqiptarë e përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare.

Megjithatë, si në çdo fushë veprimtarie përsosuria është e pamundur dhe aq më shumë për një shtet të ri të pavarur si Republika e Kosovës. Sfida të shumta janë ndeshur e do të ndeshen edhe në vitet e ardhshme në rrugën e gjatë e të vështirë të forcimit të institucioneve shtetërore demokratike të Kosovës.

### **Disa sfida parësore të Republikës së Kosovës**

Mendoj se ndër sfidat e panumërta që has shtetndërtimi në Kosovë, disa prej tyre mund t'i veçojmë si më parësore. Unë jam munduar të sjell disa prej tyre, të cilat po i rendis më poshtë të shoqëruara me ndonjë ide që mund të ndihmojë për përballimin, zgjidhjen apo kapërcimin e tyre, si:

- Forcimi i institucioneve demokratike dhe kalimi i plotë dhe i përsheptuar i të drejtave ligjore përkatëse nga institucionet ndërkombëtare te institucionet shtetërore shqiptare. Ngadalësia në këtë proces pengon në ushtrimin e plotë të të drejtave ligjore institucionale, por edhe në mbajtjen e përgjegjësisë ligjore për moszbatimin e ligjit si për institucionet ndërkombëtare ashtu edhe për institucionet e Kosovës.
- Zhvillimi i aftësive të nëpunësve të administratës publike dhe themelimi i një shkolle të veçantë të administratës publike për ta përsheptuar këtë proces. Synimi në fushën e aftësive të nëpunësve publikë duhet të jetë tërësia e aftësive që bëjnë të mundur krijimin dhe zbatimin e politikave të institucioneve të ndryshme publike.
- Forcimi i pandërprerë i shtetit ligjor dhe i sundimit të ligjit të barabartë për të gjithë në luftë kundër dukurive të paligjshme, si krimi e korrupsioni dhe i veprimtarive të ndryshme të paligjshme nëpërmjet aftësimit dhe forcimit të pavarësisë së sistemit gjyqësor. Sundimi i ligjit të barabartë për të gjithë kërkon vendosjen sa më shpejtë të sundimit të plotë të ligjit në Mitrovicën e Veriut dhe prishjen e institucioneve paralele të paligjshme serbe atje, po ashtu

siç kërkon edhe të qenët veprues dhe nismëtar në radhë të parë të vetë institucioneve shqiptare të Kosovës për përballimin e çështjeve të pavërteta e me frymëzim politik antishqiptar të tilla si ajo e tregtisë së organeve njerëzore e ngritur nga zvicrani Dik Marti.

- Forcimi i sigurisë së Kosovës nëpërmjet bashkëpunimit me forcat ndërkombëtare të sigurisë, por duke rritur gjithnjë e më shumë vetnijaftueshmërinë dhe pavarësinë e veprimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Duke u ndjerë gjithnjë e më shumë e pavarur për sigurinë e vet, Kosova duhet të ndjehet më shumë edhe aktor veprues në të mirë të sigurisë ndërkombëtare rajonale apo përtejrajonale, duke i shërbyer në këtë mënyrë edhe strategjisë së Kosovës për anëtarësimin e saj në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Veprimet dhe ndihma për sigurinë ndërkombëtare mund të vështrohen edhe si pjesë të detyrimit tradicional moral të shqiptarëve për të shprehur mirënjohjen për ndihmën që Bashkësia Ndërkombëtare dha në vitin 1999 për lirinë e Kosovës.
- Përsheptimi i zhvillimit të ekonomisë nëpërmjet nxitjes më të madhe institucionale për bizneset vendore të Kosovës dhe forcimit të procesit të privatizimeve. Si themel i veprimtarisë dhe i sigurisë së një shoqërie, ekonomia ka fuqi të përmirësojë ose të përkeqësojë gjendjen e përgjithshme të shtetit. Kjo merr rëndësi të veçantë për Kosovën e cila ka probleme serioze me ekonominë dhe papunësia është në shifra shumë të larta.
- Veprimtaria diplomatike për zgjerimin e njohjeve të Republikës së Kosovës. Është arritje shumë e mirë që Ministria e Jashtme e Kosovës ka formuluar një strategji të veçantë për procesin e njohjeve. Është e domosdoshme që për procesin e njohjeve shtetërore të Kosovës të mbahen përherë parasysh dy ide, e para, se themelore për njohjet nuk është zgjarësia për të gjetur argumente bisedimesh zyrtare diplomatike politike apo historike, por aftësia për të gjetur “bashkësinë e interesave” me shtetin që i kërkohet të njohë Republikën e Kosovës dhe, e dyta, se Kosova është një vend me shumë burime për të cilat ka interesa ndërkombëtare. Politika e jashtme dhe diplomacia e Kosovës mund të bëjnë më shumë përpjekje që çështja e njohjes së Republikës së Kosovës të mund të diskutohet në NATO dhe BE për të arritur konsensusin e të gjithë anëtarëve të të dy këtyre institucioneve shumë të rëndësishme.
- Bashkëpunimi Shqipëri - Kosovë është një fushë në të cilën po ecet me shpejtësi, por mundësia e zhvillimit të tij është e pashtershme

dhe për të nuk mund të ketë asnjë pengesë kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Bashkëpunimi Serbi – Kosovë ekziston dhe zhvillohet më shumë në rrafshin ekonomik, por ai nuk pasqyrohet ose është pasqyruar në mënyrë të shtrembëruar në politikën dhe mediat e Kosovës. Është e nevojshme që ky bashkëpunim njerëzor në rrafshin e ekonomisë të bëhet i njohur ashtu siç është, sepse në fund të fundit ai përbën vlerë për shqiptarët, por është edhe tregues i mundësisë së marrëdhënieve të mira shqiptaro-serbe në të ardhmen. Fakti historik mbetet që, megjithë gjenocidin e madh tragjik të vjetër e të ri të serbëve në Kosovë, shqiptarët e Kosovës janë treguar qytetarë të denjë evropianë që e kanë pranuar shumë shpejt e po punojnë për bashkëjetesën me serbët pa paragjykitime.
- Forcimi i veprimtarisë ndërkombëtare e diplomatike të Republikës së Kosovës si shtet i pavarur. Kosova mund të jetë sa më shumë vepruese në bashkëpunimin rajonal pa u ndjerë e penguar nga paragjykitime të ndryshme, ose nga pamjaftueshmëria e njohjeve të saj ndërkombëtare. Ajo mund të bëjë përpjekje për përsheptimin e pjesëmarrjes në nisma të ndryshme rajonale ose të jetë iniciuese e nismave të tilla. Gjithashtu, përderisa i gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor do të jetë i integruar tërësisht në institucionet Euroatlantike dhe për më shumë, NATO dhe BE janë të pranishme prej më se një dhjetëvjeçari në Kosovë, atëherë është krejt normale që Kosova të mendojë për fillimin e procesit të anëtarësimit në këto institucione euroatlantike. E njëjta logjikë përafërsisht mund të shërbejë për bashkëpunimin e Kosovës me organizata të tjera ndërkombëtare, ose me shtete të veçanta. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nga diplomacia e Kosovës përballjes me diskutimet rreth statusit të Mitrovicës së Veriut ose kundërshtimit të ideve të ndarjes së Mitrovicës, duke i vështruar ato si sfida e hapur për mundësinë e shtetndërtimit në Kosovë dhe në kundërshtim me realitetin e vlerësimeve ndërkombëtare për përparimin e shtetndërtimit në Kosovë.
- Dialogu Kosovë – Serbi ka nevojë të përshejtohet, përkundër strategjisë së mundshme serbe të ngadalësimit të njohjeve nëpërmjet ngadalësimit të këtij dialogu. Sado i nevojshëm të jetë dialogu Kosovë – Serbi, i cili ka nisur përpara disa muajve, ai mund të ndikojë për ngadalësimin e procesit të njohjeve dhe për të mos e lejuar këtë ndoshta mund të kërkohet që brenda këtij dialogu të trajtohet në mënyrë të veçantë si çështje teknike ajo e

mirëmbajtjes së vijës së kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Dialogu Kosovë - Serbi është shumë i nevojshëm për aq kohë sa nuk diskutohet rreth statusit të Kosovës dhe pavarësisë së saj.

- Sfida e zhvillimit të një sistemi arsimor sa më të aftë e konkurrues është shumë e rëndësishme, sepse është e lidhur drejtpërdrejt me përgatitjen e elitës profesionale, politike dhe kulturore të shtetit të ri të Kosovës.
- Tejdrukshmëria apo transparenca sa më e madhe në çështjet e shtetndërtimit është shumë e rëndësishme për ecurinë e mirë dhe me mbështetje të këtij procesi jetik. Ajo bën të mundur pjesëmarrje sa më të madhe të publikut në problemet e shtetndërtimit, por edhe përgjegjësi më të madhe të aktorëve kryesorë të institucioneve shtetërore që punojnë konkretisht për shtetndërtimin.

### **Elita politike e Kosovës kundrejt synimit të shtetndërtimit**

E gjithë elita politike shqiptare në Kosovë, si elitë e një shteti të ri, mendoj duhet të bëhet më e vetëdijshme dhe të mendojë më shumë për bashkëpunim ndërpartiak në të cilin çështjet e shtetndërtimit shndërrohen në politika konsensuale sipas idesë se kur Kosova shtetndërton të gjitha çështjet partiake i nënshtrohen këtij procesi themelor në dobi të të gjithëve. Konkurrenca ndërpartiake padyshim e nevojshme mund të shpalojë krejt e lirshme në format, shpejtësitë, mënyrat dhe kostot e shtetndërtimit në të cilat hapësirat janë të shumta.

Prof. asoc. dr. Ibrahim Gashi

## **REPUBLIKA E KOSOVËS SI SUBJEKT LEGAL NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE**

### **- SYNIMET DHE PERSPEKTIVAT -**

Zanafilla e marrëdhënieve ndërkombëtare është e lidhur me ekzistencën e shteteve apo të njësisve të pavarura politike të cilat përfaqësohen nga një qeveri dhe shpallin sovranitetin mbi një territor dhe një popullsi të caktuar.<sup>1</sup> Sipas opinionit të realistëve shtetet kanë sjellje racionale në përshtatjen e fuqisë dhe ambicieve të tyre me sistemin ndërkombëtar.<sup>2</sup> Për Robert Gilpinin shteti është akteri kryesor për faktin se natyra e shtetit dhe modeli i marrëdhënieve midis shteteve janë në çdo moment përcaktuesit më të rëndësishëm të marrëdhënieve ndërkombëtare.<sup>3</sup>

Çështja e lindjes së shteteve nuk është objekt trajtimi për të drejtën ndërkombëtare deri në momentin kur një shtet paraqitet faktikisht në skenën ndërkombëtare, moment ky që konsiderohet si pikënisje e një gjendje juridike. E drejta ndërkombëtare nisët nga ajo se krijimi i shteteve të reja është çështje faktike e jo juridike. Sidoqoftë, shteti bëhet subjekt i të drejtës ndërkombëtare vetëm pas njohjes së tij diplomatike, kurse tri elementet: territori, popullsia dhe pushteti sovran përfaqësojnë gjendjen faktike, e cila pas njohjes së shtetit ndërkombëtarisht shndërrohet në gjendje juridike.

Mbi këtë kriter Republika e Kosovës, më 18 shkurt 2008, vetëm 24 orë pas deklarimit të pavarësisë së saj fitoi njohjen e parë dhe më këtë në vijim edhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me shumë shtete, duke u bërë kështu subjekt i të drejtës ndërkombëtare dhe nisur nga parimi i teorisë konstitutive, me faktin se është njohur, Kosova është bërë anëtare e bashkësisë ndërkombëtare. Në rastin e Kosovës realisht kemi një bashkim thelbësor të elementeve të teorisë deklarative dhe konstitutive, pasi që aspektin e parë e përjetoi Kosova që nga qershori 1999, kur de fakto ishte e pavarur nga Serbia, por ky

<sup>1</sup> Christopher Pierson, *The Modern State*, Second. Routledge, London and New York, 177.

<sup>2</sup> Keohane, R. O, *International Institutions and State Power*, Westview Press, 1989, 38-9.

<sup>3</sup> Gilpin, R. *War and Change in World Politics*, Cambridge: Cambridge University Press, 1981, 18.

fakt u fuqizua juridikisht në momentin e njohjes ndërkombëtare, që ka karakter konstitutiv.

Nuk duhet shtruar për debat dilemën e pabazuar që pati një pjesë e komunitetit të shteteve se a i plotësonte Kosova kushtet për të qenë shtet i pavarur. Që një entitet të konsiderohet shtet, do të shprehej Karen Mingst, duhet t'i plotësojë katër kushte: Së pari, duhet të ketë një bazë territoriale, një kufi të përcaktuar gjeografikisht. Së dyti, brenda kufijve të tij duhet të banojë një popullsi e qëndrueshme. Së treti, duhet të ketë një qeveri të cilës kjo popullsi i detyrohet besnikërisht dhe së fundmi një shtet duhet të njihet diplomatikisht nga shtetet tjera.<sup>4</sup> Teoricienët më tutje shtojnë: “një qeveri shtetërore nuk i përgjigjet asnjë autoriteti më të lartë, ajo ushtron sovranitet mbi territorin e saj...”<sup>5</sup> Shikuar nga kjo perspektivë Republika e Kosovës që në aktin e shpalljes i ka plotësuar në masë të madhe të gjitha këto premisa. Por duke qenë se këto kritere formale nuk janë absolute, ndonjëherë ndonjëri nga këto kritere kontestohet nga një palë tjetër që veten e ka shpallur humbëse në procesin e secesionit dhe kështu situata bëhet më komplekse. Në këtë rast pozicioni i shtetit të saposhpallur në rrafshin ndërkombëtar paraqitet i vështirësuar.

Nëse këto persiatje teorike i zbresim në rrafshin praktik, konkretisht në rastin e Kosovës, atëherë i bie se vështirësitë që dalin në planin ndërkombëtar janë të pritshme që nga momenti i shpalljes. Pra, për institucionet e Kosovës sfida kryesore vazhdon të mbetet afirmimi ndërkombëtar i shtetit të Kosovës, gjegjësisht legjitimitimi i statusit në planin bilateral dhe multilateral.

## **Objektivat e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës**

Politika e jashtme e shteteve është një gamë e gjerë aktivitetesh dhe veprimesh që qeveritë i ndërmarrin për t'u udhëhequr në veprimet e tyre në fushën ndërkombëtare.<sup>6</sup> Politika e jashtme materializon objektivat që kanë vendosur të ndjekin udhëheqësit e shteteve në marrëdhënie me shtetet e tjera, si dhe mjetet e përgjithshme me të cilat ata synojnë t'i realizojnë objektivat e tyre.

<sup>4</sup> Karen A. Mingst, *Essentials of International Relations*, (përkthyer në shqip), AIIS: Tiranë, 2008, 138.

<sup>5</sup> Joshua S. Goldstein, *International Relations*, Washington, 2001, 24.

<sup>6</sup> Joshua S. Goldstein, *International Relations*, Washington, 2001, 167.

Republika e Kosovës si entitet i ri faktik dhe legal në marrëdhënie ndërkombëtare ndërmerr dhe koordinon, madje në baza ditore, një numër të madh veprimesh shtetërore që ndërlidhen me atë që në planin e brendshëm do ta quanim proces të shtetndërtimit, ndërsa në planin ndërkombëtar legjitimim dhe afirmim të shtetësisë së saj. Për të shmangur konstrakte dhe frazeologji politike të shumëdëgjua tashmë, dua të nënvizoj një fakt se rruga e tërthort dhe specifike që arkitektët e pavarësisë së Kosovës kanë zgjedhur si alternativë për të evituar veton ruse në KS të OKB ndaj një rezolute në mbështetje të pavarësisë së Kosovës përben rrethanën më pak të favorshme në procesin e rëndësishëm të pavarësimit.

Ndaj, kundruall kësaj specifike, përpara institucioneve të Kosovës dhe në veçanti politikës së jashtme dhe diplomacisë kosovare është vënë detyra me peshë të madhe kombëtare, afirmimi dhe njohja e shtetit të Kosovës nga të gjitha shtetet anëtare të OKB-së, si parakusht për legalizimin e plotë të statusit të shtetit të pavarur dhe anëtarësimin në komunitetin e shteteve të pavarura të botës (OKB). Kjo detyrë imediate e politikës dhe e diplomacisë kosovare teorikisht nuk është e pamundur, por në praktikë nuk është lehtë e arritshme.

## **Shtetet që e kanë njohur Kosovën**

Deri në momentin kur po flasim janë 76 shtete që e kanë njohur shtetin e Kosovës. Njohjet e para kanë ardhur nga SHBA-ja dhe nga shtetet e fuqishme të BE-së, të cilat kishin qenë thellësisht të involvuara në zgjidhjen e çështjes së Kosovës që nga viti 1990 dhe e kishin trajtuar atë si çështje të pazgjidhur në pakon e problemeve që nxori procesi i shpërbërjes së ish-federatës jugosllave, probleme që përfunduan me gjakderdhje dhe luftëra shfarosëse për shkak të ridaljes në skenë të nacionalizmit ekstrem serb. Për më tepër, ky grup i shteteve do të mbetet shumë i impenjuar në parandalimin e konfliktit në Kosovë, së fundmi edhe përmes fushatës ajrore në kuadër të aleancës së NATO-së. Edhe në periudhen e administrimit ndërkombëtar të Kosovës nga administrata e Kombeve të Bashkuara, roli i shteteve aleate për të ndihmuar konstituimin e institucioneve vetëqeverisëse ka qenë shumë determinues. Në veçanti i shënuar do të mbetet impenjimi i madh i SHBA-së dhe vendeve të Quint-it në procesin negociator lidhur me përcaktimin e statusit final të Kosovës. Rrjedhimisht, këto vende të fuqishme në politikbërjen dhe

vendimmarrjen globale ishin të parat që përmes aktit të njohjes dhe vendosjes së marrëdhënieve bilaterale me Republikën e Kosovës, i siguruan kësaj të fundit legjitimitetin ndërkombëtar. Krahas me këto shtete apo pa vonuar shumë, Republikën e Kosovës e njohën edhe vendet që kishin interesa të drejtpërdrejta me Republikën e Kosovës apo me vendet që tashmë e kishin njohur pavarësinë e Kosovës. Në këtë rast nuk duhet mohuar se te të gjitha vendet që e kanë njohur Kosovën lajtmotiv për të marrë këtë vendim paten qëndrimin parimor të tyre në mbrojtje të së drejtës humanitare dhe principit të vetëvendosjes së popullit shumicë, i cili u terrorizua tmerrësisht, deri në shkallë gjenocidi, nga shteti i Serbisë, me pretendimin se kishte juridiksion “kushtetues” mbi Kosovën.

## **Faktorët që penguan njohjen e shpejtë**

### **Dërgimi i çështjes së Kosovës në GJND**

Padyshim se shpallja e Mendimit të GJND-së (22 korrik 2010) për ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës shënon arritjen më të madhe në konsolidimin ndërkombëtar të shtetësisë. Ky Mendim ka konfirmuar në mënyrë të qartë dhe shprehimore se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka cenuar asnjë normë ligjore të së drejtës ndërkombëtare. Gjykata ka shkuar edhe më tutje, duke bërë të qartë se shpallja e pavarësisë nuk ka cenuar në asnjë mënyrë as Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe as Kornizën Kushtetuese të miratuar nga UNMIK-u.

Mendimi i qartë i GJND-së në favor të ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës nuk ka ndikuar ende që 5-shja europiane, Rusia dhe disa vende të tjera të ndryshojnë qëndrim kundrejt njohjes së shtetit të Kosovës. Mendimi i GJND-së e ka konfirmuar ligjshmërinë ndërkombëtare të shtetësisë së Kosovës dhe ka krijuar kushte më të favorshme për integrim brenda bashkësisë ndërkombëtare. Është e rëndësishme të pranohet se ky vendim i GJND-së, pa ambiguitet, sikur zu në befasi të dy palët e përfshira në këtë kontest. Prishtina zyrtare nga korriku deri në shtator, kur edhe u aprovua rezoluta e OKB-së, nuk arriti mjaftueshëm të kapitalizojë maksimalisht këtë përparësi në rrafshin diplomatik. Megjithatë, përfundimisht ky akt ka krijuar përparësi substanciale, si referencë në argumentimin e shpalljes së pavarësisë në raport me shtetet që pritet ta njohin vendin tonë.

### **Rezoluta e AP të OKB-së e 9 shtatorit 2010**

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 64/298 (9 shtator 2010), e sponsorizuar nga BE-ja dhe Serbia, përpos që e përshëndet gatishmërinë e BE-së për të "ndihmuar dialogun në mes të palëve", lë vend për interpretime të hapura si nga vendet përkrahëse të Kosovës, ashtu edhe nga ato kundërshtarë. Megjithatë, Asambleja e Përgjithshme përfundimisht ka përjashtuar dhe mbyllur mundësinë e çfarëdo dialogu për statusin, shtetësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës. Por në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare ky fakt ka krijuar rrethana të reja, duke i dhënë pretekst të ri një numri shtetesh për të shtyrë edhe më tej njohjen e pavarësisë së Kosovës. Veçanërisht ky ka qenë edhe qëllimi i politikës së jashtme serbe, duke shpërndarë argumentet të cilat devijojnë nga vetë qëllimi i rezolutës lidhur me dialogun për çështje teknike. Si e tillë, duke mos potencuar faktin se ky proces është në shërbim të normalizimit të marrëdhënieve ndërshtetërore, Serbia ka krijuar përshtypje te shtetet hezituese kinse Beogradi përmes këtij procesi po përpiqet të gjeje 'zgjidhje historike të pranueshme për dy palët', prandaj njohja eventuale vetëm do të paragjykonte rezultatin e bisedimeve dhe do të ishte kundër frymës së integritimeve europiane dhe fatit të Serbisë.

### **Kriza institucionale (fondi i v. 2010 - fillimi 2011)**

Pasojat e rënies së koalicionit qeveritar PDK - LDK dhe lënia vakant e shumë ministrive pa nivel ministrash dhe zëvendësministrash në mënyrë të njëanshme, padyshim se paraqet pikën më të dobët të fazës së shtetndërtimit pas shpalljes së pavarësisë. Për herë të parë pas krijimit të institucioneve që nga viti 2000, Kosova pësoi një lloj të kolapsit institucional, e kjo u vërejt sidomos në politikën e jashtme. Dërgimi i sinjaleve nga Kosova për një elitë politike të çakorduar, duke lënë bosh përgjegjësitë publike, pa marrë parasysh veprimet dhe pakënaqësitë e subjekteve politike, nuk shërbeu pozitivisht në krijimin e opinionit publik ndërkombëtar ndaj Kosovës. Në fakt, kjo dukuri tregoi që mentaliteti i drejtuar nga agjendat partiake po mbisundon mbi përgjegjësitë institucionale. Mësimet e nxjerra nga kjo periudhë duhet të shërbejnë si bazë e fortë për udhëheqësit institucionalë të Kosovës. Në fund të fundit, fuqizim i mëtejshëm i pozitës ndërkombëtare të Republikës së Kosovës është prioritet i lartë shtetëror. Kurse thelbësore dhe vendimtare për të realizuar këtë aspiratë është kompletimi i procesit të njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës.

### **Dialogu i filluar më Serbinë**

Kosova tanimë ka një traditë të vendosur të unitetit të forcave politike, qofshin ato në pozitë apo opozitë, në funksion të interesave shtetërore kur është fjala për bisedimet me Serbinë. Por për dallim nga fazat tjera të bisedimeve, pas 2008 Kosova ka marrë përgjegjësi të reja me karakter ndërkombëtar dhe kjo po ashtu përputhet me kultivimin e politikës së fqinjësisë së mirë me vendet e rajonit. Duke respektuar Rezolutën për Kosovën të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të datës 9 shtator 2010, Kuvendi i Kosovës po ashtu ka nxjerr një rezolutë të rëndësishme ku mbështet dialogun midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane, Kosovës dhe Serbisë, për çështje praktike, në interes të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe të avancimit të agjendës europiane për dy shtetet e rajonit. Po ashtu, legjislativi i vendit përmes këtij akti ka rikonfirmuar të drejtën kushtetuese për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që i nënshkruan Qeveria e Republikës së Kosovës, duke ruajtur kështu një rol të rëndësishëm mbikëqyrës në procesin e dialogut me Serbinë. Vlen të theksohet se strategjikisht Kosova duhet të mos lejojë “blerjen e kohës” nga ana e Serbisë dhe eventualisht diskreditimin e procesit, duke zvarritur mundësitë për marrëveshje. Çdo tentativë dhe humbje kohe në këtë proces bisedimesh do të kishte kosto direkte në prurjen e njohjeve të reja.

### **Mungesa e një lobimi më të koordinuar**

Themelimi dhe funksionalizimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme në vitin 2008 deri në 2010, si institucion konvencional që ka për mision formulimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të Kosovës, mbrojtjen e interesave të Kosovës në raport me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, në rrethanat e krijuara pas pavarësisë nuk u mor me seriozitetin e duhur shtetëror. Përkundër problemeve politike, sfidat buxhetore, logjistike dhe mungesa e teknokratëve bipartisane fatkeqësisht nuk kontribuan në një politikë të jashtme proaktive të përshkruar nga një lobim intensiv, siç janë:

- Mungesa e koherencës së aktorëve të politikës së jashtme;
- Roli i vogël i diplomacisë parlamentare;
- Mungesa e bashkëpunimit me faktorë të fuqishëm opozitarë të asaj kohe;
- Mungesa e strategjisë për ndërkombëtarizimin e Kosovës;

- Pafuqia dhe mungesa e kreativitetit në funksionalizimin e shërbimit diplomatik të Kosovës.

## **Si të përshpejtohet procesi i njohjeve**

### **Strategjia e MPJ-së për përmbylljen e procesit të njohjeve<sup>7</sup>**

Përmbyllja e suksesshme e procesit të njohjes së shtetit të Kosovës është parakushti për integrim të plotë të vendit tonë në bashkësinë ndërkombëtare. Strategjia për arritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës është një dokument uniform i strukturuar në tri pjesë kryesore: në pjesën e përgjithshme, pjesën operacionale dhe planin e përgjithshëm të veprimit. Pjesa e parë e platformës është publike derisa pjesa operacionale dhe plani i veprimit është vlerësuar e dobishme të mos behen publike. Pjesa operacionale përmban qëndrimet dhe argumentet e Republikës së Kosovës me vendet që nuk e kanë njohur vendin tonë dhe një analizë e hollësishme e qëndrimeve ndaj pavarësisë së Kosovës e vendeve veç e veç, duke i klasifikuar shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën në katër grupe: Në shtetet që kanë dhënë shenja për njohjen e Kosovës (25 shtete), shtetet të cilat nuk e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës por që ende nuk kanë dhënë shenja të qarta për njohje ( 28 shtete), shtetet të cilat kanë qëndrim neutral apo nuk janë deklaruar fare (31shtete) dhe shtetet të cilat vazhdojnë ta kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës (34 shtete). Konform këtij realiteti janë përcaktuar veprime, metoda dhe strategji specifike, kontekstuale dhe të detajuara ndaj secilit prej këtyre vendeve. Planin e përgjithshëm i veprimit përmban përshkrimin e strukturës dhe të funksionimit të grupit për lobim dhe akterëve që do të përfshihen në këtë proces, përshkrimin e hapave konkret që do të ndërmerren në drejtim të lobimit si dhe në drejtim të konsolidimit dhe ristrukturimit të shërbimit të jashtëm.

### **Konkluzion: Koha e ndarjeve dhe aneksimeve ka përfunduar**

Që në fillim dua të them se personalisht konsideroj se ideja e ndarjes rihap çështje të mbyllura dhe e kthen rajonin në vitet e armiqësive dhe luftërave të shekullit të kaluar. Si e tillë ajo nuk përben

---

<sup>7</sup> Strategjia e MPJ për përmbylljen e procesit të njohjeve është hartuar nga MPJ e Republikës së Kosovës ndërkëq është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e dt. 08.6.2011.

zgjidhje, por opSION që tërheq me vete konsekuenca zinxhirore të përmasave të paparashikueshme. Dua të nënvizoj në këtë tryezë të sotme se askush nga institucionet e Kosovës, në asnjë rrethanë nuk ka të drejtë dhe nuk do të negociojë ndonjëherë këtë opSION së paku për disa arsye formale dhe kushtetuese:

- Së pari, Kosova është shpallur shtet i pavarur në një territor të njësuar, me kufij të qartë të përcaktuar më Kushtetutë.
- Së dyti, Kosova ka respektuar parimet e grupit të kontaktit lidhur me kufijtë e Kosovës.
- Së treti, Kosova ka adoptuar një kushtetutë, që gërsheton qëndrimin e komunitetit ndërkombëtar, të përmbledhur në dokumentin gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari, i cili përkufizon qartë kompetencat e institucioneve të Kosovës dhe shtrirjen e sovranitetit të tyre në gjithë territorin e Kosovës.
- Së katërti, ideja e ndarjes është një atak i drejtpërdrejtë në sovranitetin territorial dhe institucional që i bëhet shtetit të pavarur të Kosovës nga fqinji verior.
- Mendimi i GJND-së lidhur me legjitimitetin e aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës ka mbyllur të gjitha diskutimet në temën se a ishte zgjedhje e drejtë deklarimi i pavarësisë. Mendimi i GJND-së se shpallja e pavarësisë nuk binte në kundërshtim me normat e të drejtës ndërkombëtare është një verdikt edhe për kufijtë dhe territorin në të cilin u shpall pavarësia e Kosovës.
- Edhe Rezoluta e AP-së e OKB-së e 9 shtatorit 2010 e ka përcaktuar qartë se dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit do të jetë për çështje teknike dhe pragmatike dhe se nuk do të ketë dialog për statusin dhe kufijtë e Kosovës.
- Ideja e ndryshimit të kufijve që ka vendosur Paslufta e Dytë Botërore është ide sa e rrezikshme aq edhe komplekse, të cilës është vështirë t'i dihet fundi. Në këtë ide kanë luajtur gjatë gjithë shekullit të kaluar liderët ultranacionalistë, si dhe akademia dhe kisha serbe. Fundi ka provuar se ideja e prishjes së kufijve politikë në Ballkanin Perëndimor, qoftë edhe me një epërsi të madhe në forcën ushtarake, ka rezultuar e dështuar.

Ajo që dua të nënvizoj në këtë moment është se sjellja e tillë e lidërshiptit serb përball një politike ofertuese nga ana e Prishtinës

zyrtare do të duhej të shërbenin si një mesazh i qartë për Brukselin dhe për Uashingtonin se:

- Serbia në shumë nga veprimet dhe qëndrimet e saj po ecën në kundërshtim me trendet civilizuese dhe kooperuese, duke i bërë obstrukcion të hapur perspektivës europiane dhe euro-atlantike të vendeve të Ballkanit Perëndimor veç e veç dhe rajonit si tërësi.
- Lidërshipi aktual në Serbi, i cili veten po e quan demokrat, po udhëhiqet me logjikën e vjetër të ndarjeve dhe aneksimeve. Komuniteti ndërkombëtar duhet të kuptojë një gjë se Serbia në politikën e saj karshi Kosovës dhe rajonit asnjëherë nuk e ka pasur në mendje mbrojtjen e interesave të pakicës serbe atje, por asaj i ka interesuar vetëm territori dhe ky fakt na ben të mendojmë se në politikën e “re” dhe të “moderuar” të Beogradit zyrtar nuk ka asnjë ndryshim nga politika e vjetër së cilës i interesonte vetëm ekspansioni territorial.

Duke i kuptuar drejt konsekuencat që mund të ketë ky opsion vetë komuniteti ndërkombëtar ka cilësuar si opsion riskant që rrezikon progresin e ndërtuar me mund në rajon dhe në Kosovë. Në këtë linjë janë dhënë mesazhe shumë të fuqishme nga personalitete me influencë në vendimmarrjen botërore. Kjo është inkurajuese, por ne presim dhe konsiderojmë se do të duhej që Serbia ta paguante koston e kësaj sjelljeje të papërgjegjshme në stilin e lojës me zjarr.



## **QËNDRUESHMËRIA E POLITIKAVE MAKROEKONOMIKE ZHVILLIMORE TË KOSOVËS**

Rritja e qëndrueshme afatgjate ekonomike është esenciale për arritjen e zhvillimit ekonomik, social dhe politik, për stabilitet dhe konsolidim ekonomik. Rritja ekonomike shprehet me rritjen e outputeve reale si rezultat i rritjes së kapaciteteve prodhuese. Rritja e outputeve të shprehura në produkte, në të ardhura, në konsum ose përfundimisht në produktet e përgjithshme të vendit nxitë zhvillimin njerëzor, cilësinë e jetës së shoqërisë, përmirëson kushtet për arsimim dhe shëndetësi për këtë gjeneratë dhe për ato që vijnë.

Vendet e ndryshme, sidomos ato në zhvillim në ekonominë globale, në rrugën e tyre për arritjen e zhvillimit ekonomik sfidohen veçmas nga:

- Kursimet dhe investimet joadekuate;
- Forca punuese me nivel të ulët të arsimit dhe të shkathtësive profesionale;
- Pabarazia e kushteve të tregut;
- Institucionet e pazhvilluara.

Në zhvillimet e deritanishme në Kosovë është vërejtur mungesë e politikave makroekonomike, të cilat do të tregonin orientimet themelore të zhvillimit të përgjithshëm e sektorial dhe do të krijojnë një perspektivë për zhvillim të qëndrueshëm në rrethana të reja të shtetndërtimit. Kapaciteti financiar dhe potenciali kreditor i bankave është i pamjaftueshëm për të mbështetur transformimin ekonomik dhe konsolidimin e saj, ndërkaq është ngri një potencial i konsiderueshëm i kapitalit financiar në ndërtimet individuale dhe në shpenzime jozhvillimore dhe joproductive. Mungesa e investimeve në sektorin e prodhimit ka krijuar varshmëri nga produktet e domosdoshme të cilat duhet të importohen, në këtë formë konsumi i brendshëm stimulon prodhimtarinë e vendeve të tjera në vend që ta nxisë prodhimtarinë e brendshme.

Burimet e papërshtatshme të financimit të ekonomisë, të investimeve dhe të konsumit, si dhe normat e larta të profitit si rezultat i kërkesës së lartë në raport me ofertën ndikuan në formësimin e një strukture ekonomike të pavolitshme të bazuar kryesisht në tregti dhe

shërbime, duke lënë anash prodhimtarinë vendore dhe sidomos prodhimtarinë bujqësore.

Kjo, veç tjerash, shprehet në bilancin tregtar shumë të pavolitshëm, prandaj edhe në këtë aspekt kërkesa agregate në vend nuk efektin zhvillimin e prodhimtarisë vendore, por përmes importit nxit prodhimtarinë e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera.

Gjendja e tillë i ka shkuar për shtati sektorit bankar, i cili vazhdon të mbajë norma shumë të larta të interesit dhe kushte të pavolitshme të kreditimit për prodhimtarinë vendore. Edhe investimet e jashtme direkte në periudhën e pasluftës janë orientuar kryesisht në sektorin bankar. Në anën tjetër janë të gjitha vlerësimet se risku i moskthimit të kredive në vendin tonë është më i ulët sesa në vendet fqinje, ku aplikohen po nga të njëjtat institucione bankare norma shumë më të ulëta të interesit dhe kushte më të mira të kreditimit të ekonomisë. Gjendja e tillë flet më shumë për një monopolizim specifik të sistemit bankar. Kjo gjendje i përngjanë një karteli të fshehtë financiar, por bankat vazhdojnë ta mbajnë këtë gjendje pa u shqetësuar nga masat e Bankës Qendrore.

Disa koncepte ekonomike të zhvillimit vazhdojnë të jenë peng i gjendjes së kaluar, në të cilën shumica e kapaciteteve prodhuese të Kosovës ishin të dimensionuara për tregun e atëhershëm të brendshëm ose për kontratat që shteti i atëhershëm i kishte me vendet e Lindjes dhe me vendet e tjera për këmbim malli. Sektori privat i porsalindur sfidohet me gjetjen e tregjeve të reja dhe me ballafaqimin me konkurrencën e re në këto tregje.

Deri më tani nuk kanë gjetur vend dhe përkrahje të merituar nga investitorët vendorë dhe të jashtëm konceptet ekonomike për t'u dhënë prioritet veprimtarive ekonomike me vlerë të shtuar në të cilat Kosova mund të ketë përparësi krahasuese, të cilët në ekonominë e tregut janë promotor i zhvillimit. Kosova, për shkak të luftës, është vendi i fundit i kësaj pjese të globit që po zhvillon tranzicionin ekonomik kah një ekonomi e hapur e tregut, por në të njëjtën kohë po ndërton institucionet e pavarura vetëqeverisëse. Janë këto procese mjaft të rënda për një vend me ekonomi të shkatërruar, me strukturë të brishtë qeverisëse dhe po ashtu në një situatë kur ekonomia botërore po ballafaqohet me krizën globale ekonomike, me intensitet të specifikave rajonale dhe problemeve strukturore ekonomike.

Stërzgjatja e procesit të privatizimit, gjendja në të cilin sektori privat i financiar keq dhe me mungesë të konsiderueshme të

përvojave të nevojshme përballëj me një sektor publik të ndihmuar dhe të subvencionuar nga qeveria dhe me mbetjet e një sektori shoqëror pa titullar prone dhe pa përgjegjësi menaxhimi ka dëmtuar thellë konkurrencën e brendshme dhe ka krijuar kushte për përfitime të grupeve të ndryshme të interesit.

Privatizimi i shumicës së kapaciteteve prodhuese, shërbyese, pasurive dhe pronave bujqësore deri më tani ka angazhuar një kapital të konsiderueshëm për kapacitetet dhe rrethanat tona, por ky privatizim nuk është shprehur dhe nuk po shprehet në rritjen e efekteve të zhvillimit ekonomik. Në mungesë të fondeve shtesë për investime dhe të shterjes së burimeve të investitorëve të tanishëm, ndërmarrjet e privatizuara vazhdojnë të mbesin si pasuri potenciale e pronarëve jashtë aktivitetit ekonomik ose si objekte të mundshme të riprivatizimit. Mjetet nga privatizimi që vazhdojnë të mbesin në fondin e mirëbesimit, për kërkesat dhe pretendimet e mundshme të palëve tjera po e zvogëlojnë potencialin e kapitalit ekonomik, duke shkaktuar një recesion relativ ekonomik si pasojë e zvogëlimit të parasë në qarkullim dhe kërkesës agregate në treg.

Shpallja e disa ndërmarrjeve si kompani publike dhe korporatizimi i tyre po ashtu qiti në pah se në këtë fazë të tranzicionit qeveria nuk ka aftësi të menaxhojë në mënyrë korporative sektorin publik dhe se ky lloj menaxhimi është shndërruar në burim të konkurrencës jolojale ndërmjet sektorit publik dhe sektorit privat me pasoja të dëmshme për ruajtjen dhe rritjen e vlerës së tregut të kompanive publike. Në të shumtën e rasteve ekonomia e shkallës së kompanive publike është më e ulët sesa e konkurrentëve privatë të tyre, që nxjerr në pah faktin se nga ato nuk përfiton komuniteti për shkak të shpenzimeve dhe çmimeve të larta të operimit të tyre gati në të gjitha fushat; në fushën e energjisë, telekomunikimit, ujit, trafikut urban, komunikacionit hekurudhor. Vlerësohet se kompanitë publike e kanë humbur rolin të jenë në shërbim të komunitetit, sepse nuk po arrijnë të ofrojnë shërbime më të lira, por si pronë e qeverisë janë shndërruar në mekanizëm të fuqisë së pushtetit, ndërkaq vazhdojnë të ofrojnë shërbime jokonkurrencte dhe joefiçente.

Në zhvillimet e viteve të fundit Kosova ka shënuar një rritje ekonomike vjetore prej 6.9 në 2008, 2.9% në 2009, 4% në 2010 dhe pritet të jetë 5.3% në 2011, por kjo rritje nuk është shprehur në frenimin e trendit të rritjes së papunësisë dhe në zvogëlimin e varfërisë. Ecuritë ekonomike në Kosovë janë ndër shembujt e rrallë

kur rritet ekonomia, por bashkë me këtë edhe varfëria. Pasojë themelore janë politikat ekonomike të cilat e mbështesin rritjen ekonomike të bazuar kryesisht në investimet publike, por me dobësi të shumta të shprehura në menaxhimin e parasë publike dhe sektorin informal, si dhe lënien anash të sektorit privat.

Kosova ka deklaruar orientimin e saj për adoptimin e ekonomisë së lirë të tregut dhe për ballafaqim me konkurrencën. Në kushtet e ekonomisë globale në të cilën lëviz lirshëm kapitali, mallrat, puna dhe dija, vendi ynë i shtrënguar nga izolimi me regjim të fortë të vizave që kufizojnë drastikisht lëvizjen për bizneset, por edhe për dijen dhe kapitalin, mbetet vendi i cili ekonominë e tregut mund ta paramendojë vetëm si ekonomi për të importuar produkte, dije dhe kapital të tjerëve. Në fakt, ekonomia kosovare kështu si është e izoluar, është një iluzion i ekonomisë së tregut. Në anën tjetër, zhvillimi demokratik i Kosovës është ngushtë i lidhur me zhvillimin ekonomik, me konkurrencën e lirë, me zvogëlimin e presionit të sektorit publik, me zgjerimin e investimeve në sektorin privat, me rritjen e punësimit dhe zvogëlimin e varfësisë sociale të popullatës nga asistenca qeveritare.

Drejtimi i sektorit ekonomik, i cili gjatë dhjetëvjetëshit të fundit kryesisht ka qenë përgjegjësi ndërkombëtare, nuk është veçuar me një koncept të qartë të zhvillimit demokratik ekonomik. Vendi është drejtuar pa strategji ekonomike me parametra ekonomike shpesh joreal dhe të konstruktuar sipas nevojës së institucioneve ndërkombëtare. Shpesh nga institucionet ndërkombëtare kanë ndryshuar format dhe janë futur elementë specifikë në përlllogaritjen e brutoproduktit vendor (GDP-së), nuk kanë qenë konsistente të dhënat për shkallën e punësimit dhe papunësisë e inflacionit (deflacionit); kanë vazhduar të jenë shumë të mëdha dallimet në vlerësimet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për këta tregues. Përpyekjet që deri tani i ka bërë Banka Qendrore, Instituti i Statistikave, MEF, asociacionet e bizneseve dhe institucionet tjera hulumtuese e shkencore nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar një bazë të qartë të treguesve ekonomikë mbi të cilët do të ndërtohej një strategji zhvillimore me objektiva të qarta, reale dhe të qëndrueshme.

Në anën tjetër, vlerësimet e bëra para shpalljes së pavarësisë lidhur me efektet negative në ecuritë ekonomike të vendit, të cilat do të vijnë si pasojë e zvogëlimit të prezencës së UNMIK-ut, pastaj efektet në punësim dhe në investime nuk u vërejtën dhe nuk u ndien

në mënyrë të veçantë. Ato nuk u shprehën në rënien e GDP-së, qoftë nga rënia e eksportit të brendshëm ose e punësimit në këto institucione. Kjo qet në pah se efektet zhvillimore nga prezenca ndërkombëtare në Kosovë ishin dhe janë mjaft simbolike. Mbeten shumë të rëndësishme remitencat nga bashkëvendësit tanë që punojnë jashtë Kosovës, si element i rëndësishëm i GNP-së dhe burim i investimeve reale.

Ajo çfarë Kosova vazhdon të ndajë me të tjerët sot është varfëria e lartë, si ajo ekstreme ashtu edhe e përgjithshme. Edhe pohimet nganjëherë profesionale dhe shkencore për botën e pasur dhe botën e varfër në esencë dalin të relativizuara. Në fakt bota në këtë aspekt na del të jetë vetëm një. Një botë ku të gjitha vendet janë të lidhura me shumë mënyra: jo vetëm përmes tregtisë dhe financave, por edhe përmes migrimit, ambientit, krimit, drogës, konfliktit, luftës. Kjo flet se ekzistenca e varfërisë diku nënkupton ekzistencën e saj gjithkund. Sipas të dhënave statistikore, në botën aktuale me mbi 6 miliard njerze, vetëm 1/6 e tyre posedon me 80% të BPV global, pjesa tjetër jetojnë me më pak se një dollar në ditë. Pjesë e kësaj vazhdon të jetë edhe një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve tanë.

Stabilizimi i furnizimit me energji elektrike përbën bazën elementare për zhvillim të biznesit dhe redukton koston e tij. Projektionet për rritje ekonomike deri më tani nuk janë përcjellur me rritjen e gjenerimit të energjisë elektrike, e cila është parakusht themelor i këtij zhvillimi. Nëse sot do të fillonte ndërimi i gjeneratorëve për prodhim të energjisë elektrike, nevojiten së paku 3 apo 4 vjet për t'i futur në prodhim këto kapacitete. Ky fakt do të jetë frenues i rëndësishëm i investimeve, qofshin ato vendore apo të jashtme direkte.

Në shumë vende të botës bizneset ballafaqohen me mjaft shumë probleme. Ato, para së gjithash, janë shumë të vogla për t'u ballafaquar me rregulla të pakufi, ose pse ato u përmbahen standardeve të cilat i shkel konkurrenca, ose pse ato paguajnë tatime dhe të tjerët jo. Problemet e tilla janë edhe në Kosovë, ato nuk janë morale, por e dëmtojnë rritjen ekonomike.

Transaksionet financiare të bazuara në euro gjatë kësaj periudhe kanë dhënë një kontribut specifik në stabilitetin makroekonomik. Inflacioni deri në vitin e fundit ishte i ulët. Buxheti një periudhë të gjatë kohore u mbajt në nivel prej rreth 26% të BPV sa u përket të hyrave dhe me rreth 28% me shpenzime buxhetore. Mirëpo

rritja e pakontrolluar e pagave në vitin e fundit nxiti rritjen e çmimeve dhe të inflacionit. Në anën tjetër, stabiliteti makroekonomik vazhdon të sfidohet edhe më tutje nga debalancet ndërmjet:

- konsumit të lartë dhe BPV të ulët;
- deficitit shumë të lartë tregtar;
- çekuilibrit në tregun e punës;
- lartësisë së buxhetit dhe nevojave për investime kapitale.

Nëse nisemi nga përvojat e vendeve të tjera, atëherë shumë studime lidhur me burimet e zhvillimit ekonomik orientojnë në politikat themelore për tejkalimin e këtyre sfidave. Ato janë:

- arsimimi i mirëi resurseve humane për të absorbuar dijet teknologjike;
- zhvillimi i tregut financiar, duke përmirësuar pjesëmarrjen e kredive private vendore në BPV;
- hapja e tregut ndërkombëtar, që do të ndikojë në konkurrencën, dijen dhe inovacionet teknologjike të shprehur me pjesëmarrjen e vëllimit të tregtisë në BPV;
- mbajtja e bilancit ndërmjet të ardhurave qeveritare, si pjesëmarrja e buxhetit në BPV;
- përmirësimi i shërbimeve publike dhe i infrastrukturës, si dhe
- rritja e kapaciteteve dhe e cilësisë së institucioneve dhe funksionimi i shtetit ligjor.

Politikat stabilizuese, siç janë politikat fiskale, monetare dhe financiare, kanë influencë pozitive në stabilitet makroekonomik dhe në investime. Është konstatuar roli shumë i rëndësishëm i sektorit financiar në sfidimin e kursimeve për investime.

Studimet e Bankës Botërore në vendet në zhvillim, konsolidojnë modelin e ri të biznesit sipas të cilit “Njeriu është në epiqendër të ofertës për zhvillim”. Ky parim zhvillohet përmes dy strategjive të adoptuara: investimi në njerëz dhe investimi në rritje. Strategjia e dijes po zhvillohet si një aset i rëndësishëm për zhvillim dhe zvogëlim të varfërisë. Me zgjerimin e revolucionit të teknologjisë informatike, dija po bëhet bartëse parësore dhe kyçe e zhvillimit. Kosova ka perspektivë për të investuar në dije, duke marrë parasysh moshën shumë të re të popullsisë dhe rritjen gjithnjë e më të madhe të pjesëmarrjes së gjeneratës në arsimimin e lartë. Politikat arsimore do të drejtoheshin më tepër në shtimin e cilësisë, rritjen e konkurrencës

ndërmjet sektorit publik dhe privat të arsimit të lartë, partneritetin me universitetet europiane dhe botërore në mënyrë që të rinjtë të përgatiten për t'u ballafaquar me teknologjinë e re, kurse investitorët të mos kenë kosto shtesë për arsimimin e kuadrove nga investitorët. Zhvillimi i qëndrueshëm inkorporon vizionin afatgjatë, i cili ndërlidhë së bashku aspektet strukturore, institucionale, humane dhe makroekonomike.

Në Kosovë deri më tani është folur për strategji të ndryshme dhe skenare të ndryshme që synojnë një rritje dinamike. Për dallim nga vendet e tjera, të cilat kanë kapërcyer një fazë të rëndësishme të tranzicionit, vendi ynë konsolidimin ekonomik e ka të lidhur edhe me ballafaqimet e para të shtetndërtimit. Kemi të bëjmë me nevojën e mëkëmbjes së shtetit ligjor dhe politikave të qarta ekonomike, me procesin e integritit në Bashkimin Europian dhe qasjen në fondet strukturore, partneritetin me organizatat ndërkombëtare, përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, krijimin e një ambienti miqësor për investitorët e jashtëm dhe ata vendorë, por edhe sigurimin e një ambienti të qëndrueshëm makroekonomik për zhvillimin e sektorit privat.

Arritja e këtyre synimeve mund të ketë si konsekuencë zvogëlimin e papunësisë prej 6-8%, ose mesatarisht krijimin e 25 mijë vendeve të punës në vit, stabilitetin buxhetor, zvogëlimin e migrimit, stabilitetin social dhe politik dhe zvogëlimin e diferencave në zhvillim me vendet e tjera europiane.

Në këtë fazë është e nevojshme të rritet mbështetja e sektorit të bujqësisë përmes subvencionimit të prodhimitarisë primare bujqësore nga buxheti, për të rritur prodhimtarinë vendore, eksportet dhe për të përmirësuar bilancin tregtar.

Vizioni i zhvillimit ekonomik i aprovuar nga Qeveria e Kosovës në prill të vitit 2011 parasheh një trend të rritjes nga ai bazik prej 5.4% në 7.8% në vitin 2013, përkatësisht 7.4% në vitin 2014. Vizioni nuk është i qartë, sepse ai nisët nga presupozimi i rënies së ndikimit të konsumit, që tani ka peshë të madhe dhe zëvendësimit të tij me investime dhe eksporte. Ky model ekonomik nisët nga fakti se 33% e konsumit të përgjithshëm, investimeve totale dhe eksportit importohen. Në fakt në konsumin e përgjithshëm prej mbi 5 miliard euro, importi i mallrave dhe i shërbimeve merr pjesë me 49.4%. Konsumi e kalon BPV përreth 500 milion euro, ose afërsisht sa janë të remitencat nga bashkatdhetarët tanë që punojnë jashtë.

Prandaj rritja e secilit komponent të BPV-së rezulton me rritjen e importit, i cili kontribuon negativisht në rritjen e ekonomisë. Zëvendësimi i mallrave konsumuese, duke supozuar rritjen e prodhimit vendor dhe rritja e mallrave kapitale si orientim është i mirë, por ai nuk mund të bëhet pa prodhimin e mallrave konsumuese brenda vendit, sidomos atyre ushqimore. Ndërkaq, sa u përket investimeve, ato duhet të zhvendosen nga ato publike në investime private përmes zvogëlimit të vazhdueshëm të konsumit dhe stimulimit të kursimeve, të cilët do të orientohen në investime.

Boshti themelor i ekonomisë është nxitja dhe zhvillimi i sektorit privat si fuqi bazike e zhvillimit afatgjatë të vendit dhe e ndryshimit të raporteve ndërmjet investimeve, konsumit, importit dhe eksportit. Me një zhvillim më dinamik të sektorit privat, të përcjellë me burime cilësore të financimit nga tregu bankar ose përmes tregut të kapitalit mund të ndërlihen investimet me peshë më të madhe për vendin, zëvendësimi i importeve me eksport dhe rritje të konsumit të mallrave vendore në vend të atyre të importuara.

Vizionin ekonomik të qeverisë e dëmton çdo praktikë e mospërmbushjes së detyrimeve nga marrëveshjet me institucionet financiare dhe institucionet e tjera ndërkombëtare, siç ishte rasti këtë vit me mospërmbushjen e marrëveshjes me FMN-në. Dhe atë jo vetëm për shkak të fondeve të humbura nga FMN-ja, por edhe të burimeve nga institucionet e tjera që i adresohen këtij Fondi. Deficiti buxhetor, si pasojë e kësaj mosmarrëveshjeje mund të rrezikojë rezervën e Bankës Qendrore dhe të krijojë krizë të sistemit bankar në Kosovë.

Rritja ekonomike nuk kërkon vetëm infrastrukturë të butë, infrastrukturë të rregullimit eficient dhe rendin dhe ligjin, por edhe infrastrukturë të fortë, infrastrukturë të rrugëve, energji, telekomunikacioni dhe ujë të sigurt. Aktualisht problemi ekziston edhe në faktin se njerëzit janë të vullnetshëm të paguajnë mjaftë shumë për makina, për karburante, për telefona mobil, por problemi është që një pjesë e tyre nuk tregojnë vullnet të paguajnë për ujin, pastrimin, ngrohjen, energjinë. Sfidat me arkëtimin e detyrimeve për këto shërbime janë mjaft të mëdha sa që në disa sektorë rrezikojnë ofrimin e ardhshëm të tyre. Përvojat e deritanishme nga vendet tjera kanë treguar se këto probleme tejkalohen më lehtë përmes krijimit e partneriteteve publike-private.

Qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës mund të sigurohet përmes rritjes afatgjate ekonomike e cila gjeneron nga përmirësimet në arsim, financimin cilësor, hapjen e tregut dhe në infrastrukturën e qëndrueshme publike. Krahas kësaj duhet të ulen ngarkesat fiskale, inflacioni dhe të evitohet kriza bankare nga deficiti buxhetor.

---

 Prof. dr. Riza Smaka

## SHKAQET DHE DIMENSIONET PËR MODIFIKIME DHE NOVELIME KUSHTETUTARE

### Rendi juridik i Kosovës

Rendi juridik (*Legal order*) i çdo shteti konsiston nga aktet dhe në aktet juridike të përgjithshme ç'prej kushtetutës, akteve juridike ligjore, akteve juridike nënligjore si dhe akteve juridike individuale.

Kushtetuta si ligj suprem i shtetit duhet të jetë bazë e akteve juridike ligjore të shumta dhe të ndryshme dhe, rrjedhimisht, aktet juridike ligjore duhet të jenë burim i akteve juridike nënligjore – statuteve, rregulloreve, udhëzimeve administrative si dhe i akteve juridike individuale – vendimeve, aktvendimeve dhe aktgjykimeve.

Rendi juridik i secilit shtet e veçanërisht i shteteve bashkëkohore fillimisht synon për ta rregulluar juridikisht rendin shoqëror, jetën shoqërore në përgjithësi dhe, rrjedhimisht, këtë të fundit, për ta jetësuar krejtësisht në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar me të, me rendin juridik.

Përderisa rendi shoqëror si sistem i vlerave të jetës shoqërore për nga natyra është i karakterit dinamik, ndodhet dhe rrjedhë në zhvillim të pandalshëm dhe, virtualisht të paparashikueshëm, rendi juridik, në një anë, është statik, faktikisht, i fiksuar dhe gjithnjë pas formave dhe përmbajtjeve të reja të qasura në jetën shoqërore, në anën tjetër.

Në vazhden e tillë ndërmjet rendit shoqëror që e rregullon jetën shoqërore dhe rendit juridik që e normon dhe e sanksionon juridikisht rendin shoqëror, pashmangshëm paraqiten shpërputhje në disfavor të rendit juridik. Ndryshe, në asnjë shtet, sado i zhvilluar dhe i përparuar të jetë, me rendin juridik, nuk mund të normohet dhe sanksionohet tërësisht dhe plotësisht jeta shoqërore – rendi shoqëror.

Po ashtu me normat juridike të rendit juridik, në raste jo të rralla, çështje shoqërore-ekonomike, politike, arsimore, kulturore..., rregullohen jo sa dhe si duhet saktë, plotësisht, qartë dhe përshtatshëm.

Ndaj pashmangshëm, herëpasherë paraqitet nevoja imediate e rishikimit analitik-kritik dhe e modifikimit, novelimit dhe amendimit të rendit juridik në segmente të caktuara të tij.

Së andejmi, përderisa jeta shoqërore e rregulluar me rendin shoqëror është në zhvillim dhe ndryshim të rregullt, në proces dinamik zhvillimor në një anë, rendi juridik është i karakterit statik, në anën tjetër, për ç'shkak, në ecje, kërkohet përshtatje adapte dhe adekuate e rendit juridik me rendin shoqëror. Harmonizimi i rendit juridik me rendin shoqëror në asnjë shtet bashkëkohor nuk praktikohet mekanikisht, por pas dhe në saje të analizës kritike paraprake të shpërputhjeve të ndërsjella të konstatuara pos normimit juridik të postulateve dhe të premisave të aspiruara të forcave politike kompetente për krijimin e të drejtës (burimi juridik material apo fakt i së drejtës).

Në raste jo të pakta për ta bërë ndonjë ndryshim ligjor kërkohet fillimisht të bëhet amendim kushtetutar për të krijuar bazë kushtetutare për modifikim, novelim dhe amendim të aktit juridik ligjor të caktuar.

Konkretisht, për ta modifikuar sistemin zgjedhor në Kosovë (n. 139 i Kushtetutës) apo statusin kushtetutar të Presidentit të RK-së (n. 83–91 i Kushtetutës) fillimisht kërkohet amendim kushtetutar respektiv për të krijuar bazë kushtetutare për miratim të akteve ligjore respektive në harmoni me bazat kushtetutare respektive.

Në shtete të Sistemit Juridik European Kontinental, çfarë është edhe vendi ynë, kushtetuta është akti juridik i përgjithshëm në kreun e piramidës së rendit juridik dhe, mesazhet, përmbajtja, kuptimi dhe fryma e saj *nolens volens* medoemos duhet të reflektohet përshtatshëm në secilin akt juridik të përgjithshëm të shtetit respektiv.

## **Kushtetuta dhe sistemi juridik**

Kushtetuta, pos nocioneve dhe definicioneve të shumta dhe të ndryshme, me të drejtë definohet ligj suprem i shtetit (“The Constitution as Supreme Law” & “The Constitution as Supreme Law of the Land”..).

Kushtetuta vertet është ligj fundamental, bazik, i parë dhe parësor, në shtet dhe, si i tillë, pashmangshëm më i rëndësishëm në secilin rend juridik (jo: në sistem juridik, siç thekson një numër jo i vogël, nder ta edhe i juristëve, ngase asnjë shtet nuk ka sistem juridik, por ka rend juridik...ndryshe, në Europë ekzistojnë krejtësisht vetëm dy sisteme juridike: Sistemi Juridik European Kontinental, në kuadrin e të cilit ndodhet edhe Kosova dhe Sistemi Juridik Anglosakson.

Varësisht nga qasja doktrinare dhe kriteret e përcaktuara më parë, kushtetutat mund të klasifikohen në të shkurtëra, të mesme, të gjata, përkatësisht vëllimore, të shkruara - formale apo të pashkruara - materiale, të miratuara në referendum apo nga legjislativi, të aprovuara në procedurë të rendomtë apo ca më të ndërlikuar e, së andejmi, për modifikim dhe novelim, të kushtëzuara me procedurë të njëjtë të miratimit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Kushtetuta) është miratuar më 9 prill 2008, ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, i ka XIV kapituj me 162 nene.

Kushtetuta e vendit tone është dokument politik-juridik me vëllim dhe përmbajtje mesatare, i shkruar - formal, i miratuar dhe, me mundësi të amendimit (jo të amendamentimit) në procedurë relativisht të implikuar me postulate preliminare rigjide, veçanërisht referuar jo pak neneve nga Propozimi (jo "Pako") Përmbledhës (jo "gjithpërfshirës") për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26. 3. 2007 (PPZSK).

## **Rrethanat shoqërore–politike në të cilat është miratuar Kushtetuta**

Momenti shoqëror–politik kur është miratuar Kushtetuta,<sup>1</sup> në masë të konsiderueshme e ka imponuar aprovimin praktikisht të përshpejtuar të saj, edhe pse *ab inito* jo pak zgjidhje të saj ishin të diskutueshme.<sup>2</sup> Komisioni Kushtetutar i Kuvendit të Republikës së Kosovës<sup>3</sup>, *Nolens volens* është dashtë t’u përmbahej zgjidhjeve politike ndërkombëtare të përcaktuara në PPZSK e, rrjedhimisht, edhe Kuvendi është insistuar të adoptonte Kushtetutën e propozuar dhe të bazuar në atë dokument - konform premisë “Take It Or Leave It”, përkatësisht “Merre ose lëre” (sic.).

Konformiteti i lartë i institucioneve të vendit tonë ishte i kondicionuar me dhe nga raportet e forcave politike, sikundër të Kosovës në radhë të parë, por edhe në relacion me Sërbinë hegjemone

---

<sup>1</sup> Komisioni Kushtetutar i Republikës së Kosovës, më 7. 4. 2008 e ka nënshkruar Propozimin e Kushtetutës së përgatitur dhe ia ka adresuar Presidentit të Republikës së Kosovës; Komisioni ishte në këtë përbërje:

Hajredin Kuçi,  
 Jakup Krasniqi,  
 Nekibe Kelmendi,  
 Ramë Manaj,  
 Arsim Bajrami,  
 Eqrem Kryeziu,  
 Kadri Kryeziu,  
 Skender Hyseni,  
 Ilaz Ramajli,  
 Gjyljeta Mushkolaj,  
 Mahir Yagcilar,  
 Ramadan Kelmendi,  
 Blerim Shala,  
 Riza Smaka,  
 Fatmir Fehmiu,  
 Lirije Osmani dhe  
 Bajram Latifi.

Kushtetuta ka hyrë në fuqi më 15. 5. 2008.

<sup>2</sup> Propozimi i ish-Presidentit Marti Ahtisarit, emisarit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (të cilin shumëkush gabimisht e quan “Pako-ja...”, ngase në original emërtohet “COMPREHENSIVE PROPOSAL FOR THE KOSOVO STATUS SETTLEMENT” = Propozimi Përmbledhës (jo gjithëpërfshirës...) për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

e veçanërisht me dhe nga konstelacioni i relacioneve të forcave dhe të interesave gjeopolitike e strategjike të fuqive të mëdha të kohës<sup>4</sup>

Ndryshe, gjatë përgatitjes dhe aprovimit të Kushtetutës, pos jo pak zgjidhjeve tepër të debatueshme, janë treguar dhe apostrofuat formulime përmbajtësore problematike, pashmangshëm të papërshtatshme për praktikën politike dhe juridike.<sup>5</sup>

Së andejmi, teksti i Kushtetutës, i përgatitur dhe i aprovuar virtuelisht në procedurë të përshpejtuar, *Ab initio* përmban(te) edhe formulime të paqëlluara, të mëngëta dhe aq problematike; definimet e tilla madje pa e cenuar përmbajtjen e PPZSK-së, po të ishte destinuar përkujdes institucional i nevojshëm do të ishin mënjanuar.

<sup>4</sup> Vendin tonë në vitin 1999, nga forcat ushtarake–policore të Sërbisë hegjemoniste e çliruan forcat e NATO-së, të lideruara jo me pak probleme e obstrukcione serioze, në radhë të parë nga Rusia, Kina dhe të një numri të konsiderueshëm të shteteve të tjera ...Rol jashtëzakonisht të çmuar për çlirimin e vendit tonë nga Sërbia hegjemoniste antishqiptare ka dhënë Ushtria Çlirimtare e Kosovës e mbështetur nga populli shumicë në Kosovë... Në konstelacionin e relacioneve të SHBA-së me aleatë, në radhë të parë, me Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Spanjen, Italinë dhe për here të parë gjatë historisë politike të kohës së re edhe të Francës, si dhe të shteteve antare të NATO-s, në një anë, dhe të shteteve prosllave - serbe, kryesisht të Rusisë tok me jo pak aleatë të saj, pas shumë koncesioneve është definuar Propozimi Përmbledhës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (PPZSK), i cili si i tillë është pranuar edhe nga përfaqësuesit e Kosovës dhe paraqet hiq më pak se burim juridik-formal për kushtetutën e vendit tonë...PPZSK-ja përmbanë dispozita problematike jashtë standardeve juridike–ndërkombëtare referuar statusit të pakicave kombëtare, në radhë të parë në favorin e komunitetit serb kosovar, të cilit me të i janë stipuluar privilegjime shumë më të larta nga ato të cilat Unioni Evropian ju njuh dhe u siguron minoriteteve të veta...shkalla e lartë e privilegjimeve, favorizimeve dhe autorizimeve padrejtësisht të avansuara pro komunitetit serb kosovar mund të shkaktojë vështirësi të konsiderueshme gjatë realizimit të rendit juridik të Republikës së Kosovës!

Propozimi nga fusnota 2, pos përdorimit të gabuar si “Pako” rrjedhimisht fjala:”comprehensive” po ashtu zyrtarisht është përkthyer gabimisht = “...gjithpërfshirës”, ngase në kontekstin e funksionit të tij, ai dokument do të duhej të përkthehej “...përmbledhës”; Termi “comprehensive” në kontekste të ndryshme duhet të përkthehej dhe të përdoret si:

- përmbledhës,
- i plotë,
- i kuptueshëm (Ilo Stefanllari, Fjalori anglisht–shqip, Botime enciklopedike, Tiranë, 2002, f. 75.

Rrjedhimisht, gjatë aplikimit të Kushtetutës defektet e tilla pashmangshëm nuk mund të mos prodhojnë efekte juridike negative!

Në saje të analizimit kritik të Kushtetutës, defektet e saj përgjithsisht mund të grupohen në:

- formale, gjuhësore, terminologjike dhe në
- materiale apo esenciale.

### **Burimi juridik i kushtetutës**

E drejta kryesisht rezulton nga:

- burimet materiale – faktet dhe nga
- burimet formale – aktet.

Kushtetuta - akti ligjor më i lartë, në parim duhet të rezultojë nga burimet materiale - faktet, përkatësisht duhet të shprehë vullnetin politik të popullit të shtetit përkatës. Populli i çdo shteti demokratik vullnetin politik, varësisht nga rregullimi shtetëror, në procedurë të caktuar e shpreh drejtpërdrejt në referendum, përkatësisht nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në institucionin e legjislativit, në kuvend, parlament, kongres, asamble apo siç mund të quhet edhe ndryshe.

Populli drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesëve të zgjedhur – deputetëve, kuvendarëve, parlamentarëve të vet, duke e shpreh vullnetin politik, të njëjtin e reflekton në formën dhe përmbajtjen e ligjit suprem – kushtetutës së vet.

Populli si tërësi asnjëherë dhe askund nuk ishte, nuk është dhe nuk mund të jetë krejtësisht unik referuar zgjidhjeve kushtetutare të caktuara; ndërkaq opcionet diferente përkitazi me zgjidhjet kushtetutare, se shteti do të jetë republikan apo monarkik, republikan presidencial apo parlamentar vlerësohen të pranuar kur mbështeten nga shumica e nevojshme.

Pikërisht shumica e kërkuar dhe e konsideruar e nevojshme për miratim, ndryshim apo plotësim të kushtetutës paraqet forcën politike relevante të momentit kur ai akt aprovohet. Shumica e nevojshme dhe e kërkuar për miratimin, ndryshimin apo plotësimin e kushtetutës reflekton forcën politike të momentit për bërjen, krijimin përkatësisht konstitutimin e saj – kushtetutës. Së andejmi, burimi juridik material - fakt konsiston në forcat politike të kohës për të miratuar, modifikuar, noveluar apo për ta shfuqizuar kushtetutën.

Në shtetet bashkëkohore e demokratike, ligji suprem i shtetit rezulton dhe mbeshetet në burimin material – faktik, në vullnetin politik të popullit respektiv të momentit historik të caktuar.

Rrjedhimisht, kushtetuta e miratuar në referendum apo në legjislativ paraqet bazë dhe burim formal për aktet ligjore, të cilat *nolens volens* medoemos duhet të jenë koherentë e konsistentë me të - kushtetutën.

Së andejmi, burimi juridik formal – akti manifestohet në trajtë të aktit juridik të përgjithshëm, fillimisht kushtetuta për aktin ligjor e rrjedhimisht akti ligjor për aktin nënligjor dhe akti nënligjor për aktin juridik individual.

Përderisa kushtetutat e shteteve bashkëkohore demokratike rezultojnë nga burimet materiale - faktet dhe shprehin vullnetin politik të popujve respektivë, Kushtetuta e vendit tonë vërtet *sui generis*, në vend nga vullneti politik i popullit të Kosovës del nga PPZSK-ja, burim formal – akt!

Pikërisht me artikullin (nenin) 1, par. 1 të Aneksit të PPZSK-së është stipuluar se Kushtetuta (e Republikës së Kosovës – RS) do të jetë konsistente me PPZSK-në dhe do të interpretohet konform me PPZSK-në dhe nese do të qasej konflikti ndërmjet Kushtetutës dhe PPZSK-së, provisionet (dispozitat) e PPZSK-së do të kishin prioritet!<sup>6</sup> (*...” in the event of a conflict between the provisions of the Constitution and the provisions of this Settlement, the later shall prevail”*).

## **Diskurs kritik i disa nga formulimet e Kushtetutës**

Teksti i Kushtetutës në raste jo të pakta përshkohet me terma juridike të përdorura pa vazhdimësi konsistente dhe konsekuente.

Kushtetuta *ab initio* nga pjesa hyrëse përmban terma në shqip, serbisht dhe anglisht, reciprokisht inkonsistente.

Konkretisht, preambula e Kushtetutës ndër shprehjet tjera përmban:

---

<sup>6</sup> The Constitution of (Republic – RS) of Kosovo (Kosova – RS) shall be consistent in all its provisions with this Settlement and be interpreted in accordance with this Settlement in the event of a conflict between the provisions of the Constitution and the provisions of this Settlement the latter shall prevail!

- në shqip “*Ne populli i Kosovës*”,
- në serbisht “*Mi gradjani Kosova*”, ndërsa
- në anglisht “*We People of Kosovo!*”

Termet në shqip “Ne populli...”, në serbisht “gradjani...” dhe në anglisht “We People...” nuk korrespondojnë reciprokisht, madje reflektojnë kuptime të ndryshme. Pos shkaqeve praktike ato terma dhe jo pak të tjera të tilla do të duhej të ishin plotësisht korrespondente, aq më parë kur gjuha shqipe e serbishte sipas nenit 5 të Kushtetutës në vendin tonë trajtohen gjuhë zyrtare!

Ndaj, veçanërisht tekstet e akteve juridike të përgjithshme, nga Kushtetuta, aktet ligjore e nënligjore, *Conditio sine qua non* kurdoherë do të duhej të ishin adekuate, të njëjta, korrespondente konceptualisht dhe terminologjikisht, sepse përndryshe gjatë aplikimit pashmangshëm do të paraqiteshin probleme praktike serioze. Madje nëse tekstet në dy gjuhë zyrtare do të dalloheshin virtualisht, do të rezultonte se vendi ynë në vend të një kushtetute do t’i kishte dy kushtetuta, një në shqip e një tjetër në serbisht! (sic.).

Përderisa termi “p o p u l l i”<sup>7</sup> konsiston në tërësinë e njerëzëve që jetojnë në një bashkësi shoqërore e politike në një vend të identifikuar, termi “k o m b” pos atyre attributeve përmban edhe komponentën referuar identitetit unik etnopsikologjik dhe etnosociologjik tok me sensin e konsoliduar të përkatësisë së të njëjtit trung historik, kulturor e gjuhësor. Kombi, për dallin nga populli, është bashkësi e qëndrueshme e njerëzve e formësuar historikisht në bazë të unitetit historik, gjuhësor, kulturor, territorial, socioekonomik dhe etnopsikologjik që manifestohet në bashkësinë e gjuhës, kulturës dhe traditës së përbashkët<sup>8</sup>.

Ndryshe, në anglisht termi “p e o p l e” reflekton disa konceptione terminologjike esencialisht sinonime, por në kontekste të caktuara gjithnjë me kuptime të ndryshme: ”People, Nation Folk, Populace”!

Së andejmi, këto si të gjitha termet esenciale të Kushtetutës, në funksion të interpretimeve adekuate të tyre, do të duhej të

<sup>7</sup> Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, N-ZH, “Rilindja”, Prishtinë, 1981, f. 1516.

<sup>8</sup> Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, A-M, Prishtinë, “Rilindja”, 1981 (1193), f. 852

definoheshin dhe të specifikoheshin në<sup>9</sup> Glosarin Kushtetutar,<sup>10</sup> të adoptuar dhe të përcaktuar si pjesë të saj (sic.).<sup>11</sup>

Më pastaj në preambulën, paragrafin e dytë të Kushtetutës, duke iu referuar popullit të Kosovës, është përcaktuar: ” Populli i Kosovës ... i përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë...por vijimisht jo më larg se në nenin 1, paragrafin 2 të Kushtetutës për statusin e subjektit të po atij paragrafi është aplikuar termi “...shtetas“, konkretisht: “ Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet”.

Ndaj aplikimet i termave të funksioneve të njëjta por me emertime diferente herë “qytetar” e herë “shtetas”, përkatësisht përdorimi *ad hoc* i termit dikund “ popull ” e gjetiu “qytetar”,

---

<sup>9</sup> Key Terms.

<sup>10</sup> Kushtetutat e shteteve bashkëkohore e përmbajnë glosarin kushtetutar të adoptuar më parë nga institucioni kompetent referuar tematikës kushtetutare dhe në përgjithësi legjislativit.

Një nga dokumentet e tilla më të preferuara (nga unë, e besoj se jo vetëm nga unë) është: “The U.S.A., CONSTITUTION GLOSSARY”, në të cilin definohen sipas standardeve të jurisprudencës termat kyçe (The Key Words) të Kushtetutës, nder tjera:

- amendment (jo “amandament siç aplikohet gabimisht në literaturën juridike tonë);
- Double Jeopardy;
- Electors;
- Ex Post Facto Law;
- Extradiction;
- Habeas Corpus;
- Indictment;
- President Pro Tempore;
- Preamble etc...

<sup>11</sup> Pavli QESKU, Fjalor shqip – anglisht, EDFA, Tiranë, 2000 (1062), në faqen 682 e shpjegon fare qartë se termi “ People” ka kuptim sinonimik të termit “ Nation “ dhe “Folk”, “Rable”, “Populace”!

Në fjalorët, leksikonet dhe glosarët në anglisht fjala “People “ shpjegohet në shumë sinonime të cilat do të duhej të përdreshin drejt në situatën adekuate të tyre!

Reader’s Digest, FAMILY WORD FINDER” New York, 1978, (896),”People: HUMAN, HUMANS, MEN & WOMEN, INDIVIDUALS, HUMAN KIND, HOMOSAPIENS, HUMANITY, CITIZENS, INHABITANTS, POPULATION, POPULACE, KINFOLK, COMMON PEOPLE

pashmangshëm do të rezultonin në dilema aplikative, madje edhe në implementime paralele, por në konotacione dalluese.

Gjithsesi sentenca "Ne populli i Kosovës... " në shqip kurdoherë do të duhej t'i aludohej nocionit të popullit e kurrsesi të kombit të saj; ndryshe, nëpërmjet nocionit kombëtar, në atë kontekst, nder tjera, shumicës shqiptare të popullit të Kosovës implicite do t'i kontestohet përkatësia kombëtare. Në anën tjetër, me aso farë zgjidhjeje kushtetutare, implicite, do të krijohet bazë juridike për krijimin e " Kombit të Kosovës", i cili ishte dhe është populli i Kosovës i përberë nga shumica shqiptare e pjesës së ndarë të kombit shqiptar tok me komunitete nacionale e etnike të caktuara, si qytetarë të barabartë të saj - Kosovës (sic.)!

### **Disa zgjidhje kushtetutare diskutabile - Kuvendi i RK-së me pesë nënkryetarë**

Me nenin 67, par. 1 dhe 2 të Kushtetutës, në vend të më së shumti dy, panevojshëm është përcaktuar numër enorm prej pesë nënkryetarëve të Kuvendit, të cilët pos që janë të papërdorshëm, në një anë për buxhetin e vendit janë jo pak të kushtueshëm, nga ana tjetër sepse gëzojnë plot benefite siç janë autoveturat e shtrenjta, shoferët, asistentët në zyrë, kabinetet, pagat e larta, reprezentacionet si dhe shpenzimet e larta e për udhëtime zyrtare jo të rralla.

Se sa është kjo dispozitë irracionale dhe me asgjë e justifikuar, ndër tjera tregojnë zgjidhjet kushtetutare të shteteve bashkëkohore me tradita juridike të mira dhe me kapacitete financiare shumëherë më të fuqishme se vendi ynë; konkretisht, sipas nenit 30, par. 1 të Kushtetutës së Austrisë, Kuvendi – Këshilli Kombëtar i Austrisë, nga gjiu i vet zgjedh kryetarin, nënkryetarin e parë dhe nënkryetarin e dytë, pra, gjithsej dy nënkryetarë; ose, sipas nenit 84 të Kushtetutës së Sllovenisë, Kuvendi Shtetëror i Sllovenisë ka një kryetar të zgjedhur nga shumica e delegatëve; nderkaq sipas nenit 35 të Kushtetutës së Italisë, Parlamenti i Italisë që përbëhet nga Dhoma e Deputetëve dhe Senati, konform me n. 63 të po asaj Kushtetute secila dhomë e Parlamentit zgjedh kryetarin me nga një nënkryetar. Gjithsesi, përderisa Kuvendi i R. së Kosovës ka shefa të grupeve kuvendore, të cilët po ashtu kanë komfortete të nevojshme për kryerjen e funksioneve të veta, të njëjtit me efikasitet dhe eficiencë do të mund të zëvendësonin numrin enorm të panevojshëm të së pakut tre nga pesë

nënkryetarëve veçanërisht në punët e përgatitjes së seancave të Kuvendit të Republikës.

## **Politika e jashtme dhe disa çështje rreth saj**

Me dispozitën e nenit 83, par. 1, al. 10 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës, si kreu i shtetit, e përfaqëson Republikën brenda e jashtë dhe e udhëheq politikën e jashtme të vendit. Kjo dispozitë është e plotë dhe e qartë dhe sipas saj vetëm Presidenti i Republikës është i autorizuar për ta prezantuar dhe reprezentuar vendin si brenda ashtu edhe jashtë, si dhe për ta udhëhequr politikën e jashtme të vendit. Ndërkaq, në praktikë këto funksione aktualisht i ushtron *de facto* Kryeministri, përkatësisht *alter ego* Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila, sipas nenit 93, par. 1 i Kushtetutës është e autorizuar të propozojë (kujt?...) dhe zbatojë politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit; nderkaq Kryeministri, sipas nenit 94, par. 9 i Kushtetutës këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit. Dispozita e nenit 93, par. 1, al. 1 e Kushtetutës: "Qeveria propozon (.....) dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit" nuk është e plotë, ngase nuk precizon se Qeveria, konkretisht të cilit institucion i propozon politikën e brendshme dhe të jashtme, Presidentit që është kompetent konform me n. 83 të Kushtetutës për udhëheqje të politikës së jashtme dhe të brendshme apo eventualisht Kuvendit në bazë të n. 65, par. 1, al. 8 e Kushtetutës zgjedh dhe shpreh mosbesimin e saj, pra institucionit të cilit drejtpërdrejt i përgjegjet. Po ashtu jurisdiksioni i Presidentit, i Qeverisë dhe i Kuvendit referuar përcaktimit dhe zbatimit të politikës së brendshme dhe të jashtme të vendit, me dispozitat kushtetutare të thëna nuk janë specifikuar as stipuluar qartë, në mënyrë të plotë dhe pa ekuivoqe, për ç'shkak gjatë amendimeve të saj do të duhej të precizoheshin dhe të plotësoheshin.

## **Statusi kushtetutar i Presidentit aktual**

Përderisa është në aplikim dispozita e nenit 86 e Kushtetutës<sup>12</sup>, vlen për të theksuar se në praktikë e njëjta është problematizuar pothuajse panevojshëm; kjo dispozitë, pos alinesë se fundit të

<sup>12</sup> Pritet nisim për amendimin e kësaj dispozite me synim të aplikimit të zgjedhjes direkte të Presidentit të RK-së.

paragrafit 5, edhe para aktit interpretues të Gjykatës Kushtetutare në muajin mars 2011 ishte, pra, është e qartë dhe e plotë (pos entiteteve injoruese ose kinse injoruese me tendencë të nëpërkëmbjes se saj).

Me par. 4 të nenit 86 të Kushtetutës është stipuluar qartë se Presidenti zgjedhet me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve. Ai formulim gjatë amendimit kushtetutar do të duhej të plotësohej me parafjalën “së pakut” me dy të tretat..., nga se si i tillë do të mund të interpretohej i fiksuar vetëm në 2/3 e deputetëve, por sikundër jo më pak as më shumë se ajo shumicë e kualifikuar! Rrjedhimisht, sikundër në votimin e parë, ashtu edhe në të dytin, në të cilët kërkohet shumica e kualifikuar prej jo së pakut ..., por *explicite* (vetëm) nga dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve, para votimit *Conditio sine qua non* në mënyrë implicite kërkohet, por do të duhej eksplicite të kërkohet prania e së pakut shumicës së kualifikuar të të gjithë deputetëve. Ndryshe, sikundër të mos ishin të pranishëm së pakut 2/3 e të të gjithë deputetëve, as votimi i parë e as i dytë nuk do të mund të zhvillohej, ose, ndryshe *ab inito* do të improvizohet ajo klauzë dhe me të do të shkelej dispozita e theksuar e Kushtetutës, e cila është shkelur konkretisht në Rastin Pacolli (mars 2011)! Ndryshe, edhe Gjykata Kushtetutare në këtë drejtim ka konfirmuar pikëpamjen e theksuar mësipër.

Vijimisht, formulimi i n. 86, par. 4 dhe 5, al.1 e Kushtetutës me të cilin prerazi specifikohet shumica e kualifikuar: ”...zgjedhet me dy të tretat...” pa parafjalën: ”me së pakut dy të tretat...” do të mund të shkaktonte edhe meditime se presidenti mund të zgjidhet ekskluzivisht me 2/3 e të gjithë deputetëve..., por jo edhe me më shumë vota, siç do të mund të manifestohej votimi më i fuqishëm dhe për aq më i dëshiruar, mbi 80 vota!; zatën stipulimi i mëngët i asaj dispozite kushtetutare, pa parafjalën “së pakut” do të mund të interpretohej logjikisht konform me *Argumentum ad maiori ad maius*, prapëseprapë, si i tillë, i pa plotësuar, do të mund të shkaktonte paqartësi të panevojshme!

Në anën tjetër, pas votimit të dytë të pasuksesshëm për zgjedhjen e presidentit, përkatësisht, kur asnjëri kandidat nuk do të merrte shumicën prej dy të tretave në dy votimet e para, sipas n. 86 / 5 / 2 të Kushtetutës organizohet votimi i tretë ndërmjet dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati në votimin e tretë nga ata të dy qe merr sëpakut shumicën e

votave të të gjithë kandidatëve shumicën absolute prej 61 votash zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.

Në këtë dispozitë rezultojnë dy çështje të nevojshme për sqarim dhe komentim interpretues, një,

- referuar numrit më të madh të kandidatëve se dy gjatë votimit të parë dhe të dytë, si dhe
- gjatë votimit të tretë kërkohet apo nuk kërkohet të jetë e pranishme shumica e kualifikuar sikundër gjatë votimit të parë dhe të dytë, apo në të do të mjaftonte prania e sëpaku shumicës absolute të nevojshme për zgjedhjen e Presidentit në rundin e fundit, të tretë?

Numri i kandidatëve për President gjatë votimit të parë dhe të dytë, sipas n. 86 / 5 / 1 të Kushtetutës në mënyrë implicite do të duhej të ishte mbi tre - nga formulimi më se i qartë i shprehur në formë implicite në po atë dispozitë: "...nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave në dy votimet e para *organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe...*" rrjedhimisht në votimin e tretë do të hynin dy nga më shumë kandidatë nga votimi i dytë, e ai numër sëpaku nëse jo katër, *nolens volens* do të duhej të ishte tre e kurrsesi vetëm dy sish!

Gjithsesi pritet që në procedurën e amendimeve të Kushtetutës, zgjedhja e Presidentit nga Kuvendi të zëvendësohej me zgjedhjen e tij të drejtpërdrejt nga populli. Ekziston një varg i përparësive për zgjedhjen e Presidentit në vend nga Kuvendi drejtpërdrejt nga populli, sepse, ndër të tjera, Presidenti nga vota e popullit,

- do të ishte (më) jashtë ndikesave, të mos themi të diktateve të lidërshipeve të partive politike veçanërisht të atyre në pozitë pushtetare;
- do të kishte autoritet më të theksuar;
- do të fitonte pozitë funksionale më stabile;
- do të kishte legjitimitet më solid si dhe
- përfundimisht Presidenti/ja i/e zgjedhur drejtpërdrejt do të mund të delte edhe personi me reputacion shoqëror pa qenë fillimisht i involvuar në subjekt politik të caktuar.

## **Shpallja e zgjedhjeve të reja, pastaj shpërberja e Kuvendit e jo anasjelltas!**

Edhe renditja e dy veprimeve kuvendore, të nevojshme pas dështimit të votimit të tretë për zgjedhjen e Presidentit: *"Nëse në votimin e tretë nuk zgjedhej Presidenti, shpërndahej Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja ..."* është radhitur logjikisht mbrapsht, ngase sikur të përfillej kjo dispozitë nën një, do të shpërdahej Kuvendi, kurse, nën dy, nuk do të mbetej Kuvendi - institucioni i vetëm i autorizuar për shpalljen e zgjedhjeve të reja. Ndaj, renditja e atyre veprimeve kuvendore *nolens volens* do të duhej të radhitej sipas specifikimit logjik, fillimisht Kuvendi do t'i shpallte zgjedhjet, e rrjedhimisht po ai institucion do të miratonte vendimin për vetëshpërbërjen e tij.

Gjatë amendimit të Kushtetutës do të duhej të rishikohej komparativisht edhe n. 91, par.3 dhe n. 116, par. 1 të Kushtetutës dhe të definoreshin pakundërshtueshëm në harmoni të ndërsjellë.

## **Një kontraverzë referuar finalitetit të vendimeve të Gjykatës Kushtetutare**

Me dispozitën e nenit 116, par. 1 të Kushtetutës është specifikuar se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për Gjyqësorin, të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës, pra, edhe për legjislativin, përkatësisht Kuvendin e RK-së.

Mirëpo, sipas dispozitës së nenit 91, par. 3 të Kushtetutës, edhe atëherë kur Gjykata Kushtetuese do të vendoste se Presidenti ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi m u n d (*pra, fakultativisht e jo obligimisht*) ta shkarkonte Presidentin, edhe atë me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve të tij!

Së andejmi rezulton se Kuvendi pavarësisht nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese me të cilin, do të konkludohej se Presidenti e ka shkelë rëndë Kushtetutën, sipas diksionit të dispozitës së nenit 91, par. 3 të Kushtetutës Kuvendin nuk e obligon vendimi i asaj Gjykate, sepse ai, Kuvendi, fakultativisht në dy etapa të procedurës do të mund të shkarkonte Presidentin, pra nuk do t'i kërkohej ta shkarkonte dhe, shkarkimin e tij/saj do të mund ta bënte vetëm me shumicën e kualifikuar të votave të të gjithë deputetëve, e cila virtuelisht vështirë do të mundë të sigurohej. Në këtë kontekst, aq më parë në kontekstin e

faktit juridik të shkeljes së rëndë të Kushtetutës vlen të meditohet që Presidenti, në rastin juridik të tillë, do të mund të shkarkohej jo së pakut me shumicën e kualifikuar, por së pakut me numrin e votave të fituara në rastin e zgjedhjes!

### **Formimi i Qeverisë edhe nga subjektet politike në koalicion pa subjektin politik me më shumë vota**

Sipas dispozitës së nenit 95, par. 1 të Kushtetutës, pas zgjedhjeve Presidenti i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeminister, në konsultim me partite politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë. Pra, sipas kësaj dispozite, pas zgjedhjeve kuvendore (parlamentare), Presidenti, në konsultim me partitë politike apo koalicionin që ka shumicën e nevojshme për ta formuar Qeverinë, propozon kandidatin për Kryeminister! Konkretisht dispozita e theksuar krijon bazë kushtetutare që edhe subjektet politike në koalicion që fitojnë shumicën e nevojshme për të formuar Qeverinë, pra pa subjektin politik me më shumë vota, por jo të mjafta për të formuar Qeverinë që Presidenti në procedure të caktuar të konsultimeve politike ta propozonte Kryeministrin! Zgjidhja e tillë, veçanërisht në rrethanat kosovare, në praktikë nuk do mund të mos shkaktonte probleme serioze politike. Ndaj, ajo dispozitë do të duhej të rishikohej, përkatësisht të riformulohej (amendohej) me theksin se subjekti politik me më shumë vota, fillimisht në rundin e parë eksklusivisht do të ishte i autorizuar që në kushtet e caktuara me Kushtetutë, përkatësisht me ligj të paraqitej e para për konstitutimin e Qeverisë.

### **Zgjedhja e Presidentit të Republikës**

Statusi i Presidentit të Republikës me dispozitat e neneve 86-91 të Kushtetutës është përcaktuar në kolizion me sistemin politik të republikës parlamantare, çfarë është Kosova në një anë dhe përmban mangësi, vakume juridike të caktuara, veçanërisht referuar shkarkimit nga pozicioni i tij, në anën tjetër. Në vend të zgjedhjes së Presidentit nga Kuvendi, madje edhe me shumicën relative të votave, do të duhej të normohej zgjedhja e drejtpërdrejtë; po ashtu do të duhej të normohej edhe institucioni i vicepresidentit të Republikës si dhe shkarkimi i tyre, pos bazave kushtetutare ekzistuese në Kushtetutë, edhe nëpërmjet dorëheqjes madje edhe procedurën për dorëheqje. Po

qe se nuk do të stipulohej klauza për zgjedhjen e Presidentit drejtpërdrejt nga populli, emertimi i tij do të duhej të zëvendësohej me termini Kryetari i Republikës dhe, shkarkimi i tij/saj do të duhej të specifikohet me së pakut numrin pro shkarkimit të njëjtë me atë në saje të të cilit është zgjedhur. Konkretisht, nëse Presidenti i zgjedhur me 61 vota në Kuvend do të bënte krim të rëndë, shkelje të rëndë të Kushtetutës ose kur ai të bëhej invalid i kategorisë së parë, Kuvendi do të duhej të kishte autorizim për ta shkarkuar jo ekskluzivisht me shumicën e kualifikuar me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve, por me së pakut numrin e votave në bazë të të cilave ka qenë zgjedhur president.

### **Riformulimi i raporteve të ndërsjella të ekzekutivit dhe gjyqësorit në harmoni me Checks and Balances**

Pos riformulimit të sistemit zgjedhor dhe të statusit kushtetutar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga neni 108, par. 8 i Kushtetutës, konform me parimin Checks and Balances do të duhej përcaktuar në një riformulim cilësor relacionet reciproke të atyre dy branshave fundamentale të pushteteve shtetërore e ndër tjera obligimi i gjyqësorit që t'i referonte dhe raportonte Kuvendit të Republikës një herë në vit për punët e (pa)kryera dhe për funksionimin tok me problemet aktuale e akute të tij. Po ashtu edhe ekzekutivi, në radhë të parë nëpërmjet ministrisë së drejtësisë do të duhej të riformulohej në funksion të krijimit të relacioneve reciproke të informative dhe të masave në funksion të ligjëshmërisë veçanërisht në favor të ekzekutiveve të akteve gjyqësore përfundimtare. Nuk duhet neglizhuar faktin se sipas premisë fundamentale "Checks and Balances", në shtetin e së drejtës tri format fundamentale të pushteteve absolutisht as nuk janë të pavarura as nuk janë të varura reciprokisht, por janë dhe duhet të jenë në pavarësi të kushtëzuar dhe reciprokisht të kontrolluar.

### **Riformulimi i statusit të Advokatit të popullit, Auditorit të Përgjithshëm, Këshilli Qendror Zgjedhor ...**

Nëpërmjet amendimeve kushtetutare ndër të tjera do të duhej që Advokati (nga Lat. Ad&Vocere=avokati e joavokati) i Popullit nga neni 133 i Kushtetutës, pos injerencave apelative të tipit moralizator të autorizohet që në raste të caktuara të kishte edhe prerogativa efikase të nevojshme për ushtrimin efikas dhe eficient të funksioneve të veta!

Ngjajshëm do të duhej vepruar edhe përkitazi me dispozitën e nenit 137 të Kushtetutës referuar statusit dhe prerogativave të auditorit të përgjithshëm. Në këtë vazhde pashmangshëm do të duhej riformuluar materialisht e formalisht statusi i këshillit qendror zgjedhor, duke i definuar qartë e në mënyrë të plotë autorizimet dhe përgjegjësitë konkrete të ndersjella të tij me panelin e ankesave. Referuar sistemit zgjedhor, me amendime kushtetutare do të duhej të krijojeshin baza të nevojshme për një reformim cilësor të tij.

## **Konkluzione**

Rrjedhimisht rezulton se Kushtetuta veçanërisht do të duhej të modifikohet nëpërmjet amendimeve referuar:

- Parimeve themelore të cilat do të duhej të riformuloheshin dhe të plotësoheshin siç mund të ishte krijimi i bazës ligjore për mbikëqyrjen gjyqësore të administratës publike;
- Dispozitave të Kushtetutës; dispozitat e Kushtetutës do të duhej të ishin në harmoni të plotë me parimet themelore të saj;
- Dispozitave të caktuara; dispozitat e caktuara të Kushtetutës do të duhej të riformuloheshin e disa të tjera të plotësoheshin;
- Tekstit të Kushtetutës, i cili do të duhej në pjesë të konsiderueshme të riformulohet konform me terminologjinë kushtetutare më parë të standardizuar dhe Kushtetuta ta përmbante glosarin e vet;
- Ofrimit të zgjidhjeve kushtetutare me të cilat do të sigurohej kontinuiteti i institucioneve edhe në situata politike të jashtëzakonshme (pos Presidentit të Kosovës të zgjedhur edhe vicepresidenti apo, gjatë mungesës së Kuvendit, që disa funksione themelore kuvendore urgjente përkohësisht t'i ushtronte Presidenti si dhe për krijimin e Qeverisë Profesionale (jo teknike) Kalimtare deri në konstitutumimin e ekzekutivit legal...);
- Parimit kushtetutar të afirmuar në shtetet e së drejtës me tradita demokrate Checks and Balances të riformulohet qartë dhe në

---

mënyrë të plotë në favorin e ndarjes parimore dhe të nderkontrollimeve reciproke të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit të Kosovës;

- Gjyqësorit, i cili sikundër dy branshat pushtetore të tjera të autorizohej për nisma legjislative (n. 79 i Kushtetutës) në favor të zgjidhjeve juridike të përshtatshme me konstitucionalizmin dhe legalitetin;
- Presidentit dhe vicepresidentit që të normohen dhe të zgjedhen drejtpërdrejt nga populli me atë që të definohej në mënyrë të plotë e qartë secila bazë juridike për shkarkimin eventual të tij, përkatësisht të tyre; rrjedhimisht do të duhej të normohej instituti kushtetutar i njohur “*Presidenti Pro Tempore*”, “*Kryeministri & Qeveria Pro Tempore*”;
- Kushtetutës, e cila do të duhej të plotësohej edhe me institutin “Impeachment”, natyralizimi dhe përgjegjësia politike e bartësve të funksioneve publike dhe
- Përfundimisht, gjatë hartimit të propozim–ndryshimeve dhe plotësimeve kushtetutare do të duhej konsideruar nivelin gjuhësor e terminologjik si dhe definimet e plota e të qarta të instituteve kushtetutare jo nergut akademik, por atij legjislativ.

---

Ramadan Qehaja

## **VLERËSIM KRITIK I SFIDAVE TË SIGURISË DHE TË ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

### **Hyrje**

Ky vlerësim ka për qëllim që të elaborojë dy dimensione të sigurisë në Kosovë; e para ka të bëjë me shtjellimin e sfidave, kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj sigurisë kombëtare në vend, duke u bazuar në disa sektorë të ndarë shkencëtarisht dhe pjesa e dytë ka për qëllim të analizojë zhvillimin e institucioneve të sigurisë pas pavarësisë së vendit.

Ashtu siç do të elaborohet më poshtë, vendi ynë rrezikohet nga faktorë të ndryshëm të jashtëm e të brendshëm, të cilët janë shumë kompleks dhe si të tilla kërkojnë një përgjigje të duhur, ndonëse gatishmëria vepruese ndaj këtyre rreziqeve varet shumë nga konsolidimi i sektorit të sigurisë. Me fjalë të tjera, dobësitë në ngritjen e institucioneve vendore të sigurisë ngrisin shqetësimet për luftimin e dukurive negative në vend. Për më shumë, një rol i vazhdueshëm (dhe i fuqishëm) i pranisë ndërkombëtare jodomosdoshmërisht do të garantonte konsistencë në krijimin e një sektori të qëndrueshëm vendor dhe se rrjedhimisht varësia ndaj pranisë ndërkombëtare do të mund të rritej.

Për formësimin e këtij punimi nuk është përdorur ndonjë metodologji e veçantë, ndonëse hulumtimi në fjalë ngërthen në vete disa metoda të shkencave shoqërore (përfshirë këtu studimet e sigurisë) që aplikohen rregullisht në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë, institut ky i specializuar në studime të sektorit të sigurisë. Këto metoda kryesisht përfshijnë analizimin e burimeve të hapura, intervistimin e personave relevantë, observimin nëpërmjet pjesëmarrjes, analizimin e diskursit e ndonjëherë edhe matjen e perceptimit të qytetarëve lidhur me sigurinë në Kosovë.

Gjithashtu, duke pasur parasysh përvojën e gjatë dhe eksperiencën e autorit në lidhje me sektorin e sigurisë, punimi ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së opinionit në lidhje me kërcënimet dhe rreziqet potenciale që i drejtohen Republikës së Kosovës në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Një gjë e tillë do t'u ndihmonte

institucioneve të sigurisë, akterëve qeveritarë dhe opinionit të gjithmbarshëm për të qenë më vigjilentë në sfidat që janë para nesh. Vlerësimi mund t'i shërbejë një rangu të gjerë të audiencës, si asaj vendore po ashtu edhe asaj ndërkombëtare.

### **Sfidat e sigurisë në Kosovë**

Sfidat, kërcënimet dhe rreziqet ndaj Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj janë të shumëllojshme, komplekse, të papritura dhe shpeshherë asimetrike. Për ta bërë një vlerësim të strukturuar të kërcënimeve dhe rreziqeve preferoj që të merret për bazë Shkolla e Mendimit të Kopenhagës, e pasuruar nga autorët Buzan e tjerë. Edhe pse shkollat tjera të mendimit në një mënyrë komplementojnë përpjekjet e këtyre autorëve, megjithatë ndarja e mëposhtme, siç thuhet në sektorë të kërcënimeve dhe rreziqeve, është më bashkëkohorja dhe si e tillë reflekton sfidat më të fundit në nivel lokal, rajonal e global. Në këtë mënyrë fjala është për sfidat, kërcënimet dhe rreziqet e karakterit ushtarak, politik, ekonomik, ambiental etj.

### **Sfidat e karakterit ushtarak**

Kur flasim për sfida të *karakterit ushtarak*, atëherë vlen të theksohet se Kosova nuk mund të pret ndonjë rrezikshmëri që ka të bëjë me ndërhyrje klasike ushtarake e cila do të nënkuptonte agresion ushtarak ndaj territorit të saj për shumë arsye. Pikë së pari vlen të theksohet se rajoni në përgjithësi është deklaruar se do të përmbahet nga përdorimi i forcës për shkak të aspiratave për integritet euro-atlantike, si dhe duke pasur parasysh tendencat për ripajtimin e kombeve. Një argument shtesë në këtë drejtim është edhe nënshkrimi i programit të NATO-së “Partneritet për paqe” nga të gjitha shtetet e rajonit, përfshirë edhe Serbinë, e që shprehimisht afirmon vullnetin e vendeve për stabilitet dhe paqe. Megjithatë, nga aspekti ushtarak bashkëkohor, përjashtimi i mundësisë së një sulmi klasik ndaj Kosovës nuk e nënvlerëson domosdoshmërisht mundësinë e detashimit eventual të trupave ushtarake apo policore në momentin e caktuar, sidomos nga fqinji ynë verior (Serbia) në ndonjë pjesë të territorit të Kosovës. Ky probabilitet si i tillë duhet të merret në konsideratë, duke pasur parasysh problemet që kemi me Serbinë në konsolidimin e shtetësisë si dhe pretendimet e hapura territoriale që ajo i ka ndaj vendit tonë edhe prania e madhe e forcave ushtarake e të

xhandarmërisë së Serbisë në afërsi të brezit kufitar me Kosovën. Kjo reflekton, nëse asgjë, një ndjenjë të pasigurisë me potenciale të kultivimit të saj në rast se kjo prani mbetet numerikisht e madhe edhe në të ardhmen.

## Sfidat e karakterit politik dhe të sundimit të ligjit

Sfidat e karakterit politik në Kosovë janë të shumta, mirëpo unë do t'i përmendi vetëm disa. Pjesa veriore e vendit është një zonë ku operojnë struktura ilegale të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë si dhe zyrtarë të inteligjencës civile dhe ushtarake serbe, që vazhdimisht destabilizojnë atë pjesë të territorit. Fjala është për një prani goxha të madhe të forcave dhe mjeteve sipas modelit të ish-Mbrojtjes Territoriale (e që ende ekziston në Serbi), ku persona të caktuar do të mund të ftoheshin për mobilizim në rast se një gjë e tillë u kërkohet.

Kjo pjesë e territorit tonë në fakt po vepron si e ndarë dhe nën ndikimin e plotë politik të Beogradit zyrtar. Tendencat për ndarjen definitive të veriut të Kosovës nuk kanë si të quhen ndryshe, përveç rrezikshmëri me implikime rajonale.

Në këtë kontekst, aksionet e fundit të njësitit special të Policisë së Kosovës kanë qenë një hap para për vendosjen e sundimit të ligjit në atë pjesë, pavarësisht dobësive operative.<sup>1</sup> Në aksion ishte përfshirë edhe prania ushtarake ndërkombëtare, e cila luajti një rol në ruajtjen e paqes në atë pjesë, ndonëse në aspektin e sigurisë mund të thuhet se është bërë një avancim. Si do që të jetë, vendosshmëria nga PK dhe me mbështetje prej KFOR është mënyra e vetme për zgjidhjen e kësaj sfide e cila është e lidhur direkt me sundimin e rendit dhe ligjit në tërë territorin e Kosovës.

Përveç problemeve të ndërlidhura me sundimin e rendit dhe ligjit, problemet ekzistuese politike janë duke u dhënë shkas, hezitim dhe konfuzitet qeverive të shumë vende të botës për njohjen e vendit tonë. Një gjë e tillë po i shkakton Kosovës shumë probleme në integrimin e saj në mekanizma rajonale e botërorë, prandaj vendosja e rendit dhe ligjit në tërë territorin e vendit do t'i hapte rrugë edhe avancimit të pozicionit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Vazhdimi i mëtuqjeshëm i problemit të mossundimit të rendit dhe ligjit

<sup>1</sup> Dobësi këto të cilat nuk është qëllimi i këtij punimi që të adresohen .

do t'i kushtojë Kosovës në ngadalësim dhe në marrje të njohjeve ndërkombëtare, vështirësi për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare e po ashtu si rezultat do të ketë vazhdimin e gjysmizolimit ekzistues dhe rrezikimin serioz të mirëqenies së shtetit dhe qytetarëve të Kosovës, gjë që në një mënyrë ndikon në përkeqësimin e situatës së sigurisë në vend.

### **Sfidat e karakterit ekonomik**

Sfidat e *karakterit ekonomik* janë gjithnjë e në rritje, aq më parë kur të merret parasysh një zhvillim shumë i ngadalshëm ekonomik dhe varfërimi i skajshëm i një pjese të popullatës. Në Kosovë ekziston një përqindje shqetësuese e papunësisë. Një numër i madh i bizneseve në Kosovë u shmangen tatimeve. Përqindje e madhe e të punësuarve në sektorin privat i takojnë tregut të zi të punës dhe nuk janë të regjistruar e nuk paguhen fare kontributet pensionale për ta. Futja e mallrave të kontrabanduara nga zonat të cilat për një kohë që gjatë kanë funksionuar larg kontrollit të autoriteteve të Kosovës ka dëmtuar ashpër arkën shtetërore të Kosovës.

Të gjithë këta indikatorë shpijnë në konkludimin se vazhdimësia e një gjendjeje të tillë ekonomike nuk ka si të quhet ndryshe përveç se si një potencial për rrëmujë i shprehjes së pakënaqësive në forma të ndryshme, përfshirë këtu edhe përdorimin e dhunës, e që e bën këtë rrezikshmëri të një niveli të lartë të destabilizimit të mundshëm në aspektin e sigurisë.

### **Sfidat e karakterit ambiental**

Si segment i fundit i kërcënimeve dhe i rreziqeve janë ato të *karakterit ambiental*. Këto ma shumë i atribuohen fatkeqësive natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri, e që janë të shumta në vendin tonë. Kosova kërcënohet nga tërmetet, sidomos në një pjesë të territorit të saj, zjarret, vërshimet, epidemitë, rrëshqitjet e dheut e shumë e shumë kërcënime të tjera.<sup>2</sup> Këtu vlen të përmendet edhe ndotja e ajrit, ujit dhe tokës e cila tejkalon çdo standard të mundshëm ndërkombëtar. Termocentralet momentale të cilat furnizojnë Kosovën me energji elektrike funksionojnë në kundërshtim me të gjitha parametrat ekologjike, duke rrezikuar ambientin përreth. Po ashtu

<sup>2</sup> QKSS, Vlerësimi i sektorit të sigurisë në Republikën e Kosovës, 2009.

edhe minierat e ndryshme, duke përfshirë këtu edhe ndërmarrjen Trepça, Feronikelin, etj., transmetojnë CO2 dhe gazra të tjera të dëmshme në sasi të cilat tejkalojnë standardet dhe parametrat e parapara ndërkombëtare madje edhe me dhjetëra herë. Ajo që vlen të theksohet është se duke pasur parasysh prioritetet e kërcënimeve dhe rreziqeve të cilat kanosin shoqërinë tonë, sfidat me karakter ambiental mbeten ndër më të neglizhuarat.

### **Zhvillimi institucional i sektorit të sigurisë në Kosovë**

Rritja e sfidave, kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj sigurisë së qytetarëve tanë kërkon zhvillimin e shpejtë të institucioneve të sigurisë. Në fakt Republika e Kosovës mori përgjegjësitë (dhe atë jo në tërësi) për sektorin e sigurisë vetëm pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në vitin 2008. Arkitektura e re e sigurisë ishte gjithpërfshirëse, mirëpo relativisht e “rregulluar” konform konstelacionit politik në rajon.<sup>3</sup> Këtu para së gjithash mendohet në konceptimin dhe zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës e cila i dedikohet vetëm Kosovës, e që vendet e rajonit nuk patën një imponim të tillë. Në fakt ato iu qasën formësimit të ushtrive të tyre sipas mundësive dhe parametrave të NATO-s.

Sidoqoftë, në zhvillimin e forcave dhe mjeteve të mbrojtjes dhe sigurisë ndikoi pozitivisht korniza ligjore, e cila në mënyrë të përsheptuar u aprovua në Kuvend. S’do mend se në zhvillimin institucional të këtyre forcave pati edhe rezultate, mirëpo duhet theksuar se me të arriturat e deritanishme në sferën e sigurisë për këto tre vite e gjysmë pas pavarësisë nuk mund të jemi të kënaqur. Këtu para se gjithash mendohet në faktin se pronësia vendore në institucionet e sigurisë, e cila me vite të tëra na mungoi, edhe në momentin e pikërisht nuk mund të themi se ajo është e plotë. Kur kemi të bëjmë me FSK-në, atëherë duhet theksuar se ajo edhe pse numerikisht mjaft e limituar, edhe për tri vite të fillimit të formësimit të saj ende nuk është operacionale.<sup>4</sup> Për këtë vonesë në ngritjen e gatishmërisë vepruese të saj nuk mund të ketë justifikim para së gjithash nga faktori vendor, por edhe nga prania e NATO-s në Kosovë. Serioziteti i këtij problemi gjithnjë është më i madh kur

<sup>3</sup> QKSS, Analiza e kontekstit për reformën e sektorit të sigurisë në Kosovë (1999-2009), DCAF&BCSP, 2011.

<sup>4</sup> Forumi i Sigurisë, FSK mes sfidave aktuale dhe vizionit për të ardhmen, 2011.

merret parasysh zvogëlimi drastik i forcave të NATO-s në Kosovë, në njërën anë dhe mosoperacionalizimi apo mosfillimi i marrjes së disa kompetencave nga KFOR në largim, në anën tjetër.

Ka nevojë për një analizë të mirëfilltë të gjendjes së tërësishme në Policinë e Kosovës në shumë aspekte, përkundër rezultateve të deritanishme. Në fakt aspekti kadrovik, përkatësisht ai menaxherial në polici është më se i rëndësishëm. Politika e “status quos” deri më tani në Polici, përkundër dukurive të nepotizmit, grupimeve, animeve përjashtoi ndryshimet thelbësore në aspektin kadrovik nga lart poshtë; kjo ndikoi që përveç anës kuantitative mos të përmbushet as ana kualitative, e që në mënyrë të drejtpërdrejtë kjo situatë po ndikon në ngritjen e gatishmërisë vepruese të policisë sonë si forcë e vetme e rendit. Nuk mund të lihet anash edhe nevoja e një riorganizimi më efektiv konform rrezikshmërisë me të cilat po ballafaqohet shoqëria kosovare. Për më shumë, nuk ka vend edhe për vetëkënaqësi as për çështjet materiale-teknike, pajisjeve dhe armatimit në PK.

Me një vonesë njëvjeçare nga pavarësia e Kosovës filloi së formuari Agjencia e Kosovës për Inteligjencë. Për këto dy vite kjo agjenci nuk arriti të operacionalizohet plotësisht. Organizimi i aktivitetit të zbulimit, kundërzbulimit, kërcënimeve nga brenda dhe jashtë, veprimet eventuale terroriste, sabotazhet etj, për shkak të kësaj ngecjeje vështirë se mund të përcillen dhe analizohen për nevoja të lidershit tonë. Megjithatë, duke e pasur parasysh një institucion kompleks dhe të ndërtuar nga zeroja, atëherë fillimi i vlerësimit të performancës së saj do të ishte më objektiv në vitet e ardhshme, atëherë kur mendohet se ky institucion është i formësuar.

Kur flasim për institucionet e gatishmërisë dhe reagimit emergjent, vlen të theksohet se ky segment është dukshëm i zhvilluar dhe i përgjigjet nevoja të Kosovës, duke pasur parasysh një shtrirje të brigadave të zjarrfikësve dhe mekanizmave të tjerë në nivel lokal. Mirëpo kapacitetet e limituara teknologjike dhe mungesa e mjeteve do ta pamundësonte reagimin e këtyre mekanizmave në rast të fatkeqësive me pasoja të mëdha katastrofale.<sup>5</sup>

<sup>5</sup> QKSS, Vlerësimi i sektorit të sigurisë në Republikën e Kosovës, 2009.

## Konkluzion

Në përgjithësi pozita gjeografike, konstelacioni politik dhe problemet e brendshme e bëjnë Kosovën një vend i prekur nga të gjitha sfidat dhe rreziqet që janë të ngjajshme dhe me shtetet e tjera të rajonit. Përderisa kemi një zvogëlim të mundësisë të konfrontimeve ushtarake në rajon, sfidat e karakterit politik dhe ato të shtrirjes së sundimit të ligjit janë mëse shqetësuese dhe vështirë të menaxhueshme. Problemet në veri përbëjnë një ndër kërcënimet serioze të sigurisë së Kosovës dhe që është bërë pak në zvogëlimin e tyre. Po ashtu pozita e vështirë e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe frenimi i proceseve të integritimeve në organizatat ndërkombëtare rrjedhimisht ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve.

Në anën tjetër sfidat e karakterit ekonomik janë mëse të theksuara dhe kjo vjen si rezultat i një zhvillimi të ulët ekonomik, papunësisë dhe rritjes së varfërisë. Për më shumë, niveli i lartë i krimit të organizuar dhe ekonomia joformale janë faktorë ndikues në përkeqësimin e mundshëm të situatës së sigurisë. Sfidat e karakterit ambiental janë më se të pranishme dhe ato reflektohen nëpërmjet problemeve që shkaktohen si rezultat i fatkeqësive natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri.

Si përfundim, zhvillimi i sektorit të sigurisë është një ndër prioritetet e Republikës së Kosovës në mënyrë që të mund të ballafaqohemi me sfidat e llojeve të përmendura më lart. Dobësitë në konsolidimin e FSK-së, problemet subjektive në polici, si dhe mosoperacionalizimi i Agjencisë së Inteligjencës reflektojnë një sektor të sigurisë të brishtë dhe larg nga niveli i dëshiruar. Kjo kërkon një trysni më të madhe tek elita politike që këto probleme dhe dobësi të evitohen, ngase fjala është për një sektor shumë të rëndësishëm, madje ndër më të rëndësishmit të shtetit të Kosovës.

## Bibliografia

Forumi i Sigurisë, *FSK mes sfidave aktuale dhe vizionit për të ardhmen*, 2011.

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, *Analiza e kontekstit për reformën e sektorit të sigurisë në Kosovë (1999-2009)*, DCAF&BCSP, 2011.

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, *Vlerësimi i sektorit të sigurisë në Republikën e Kosovës*, "Koha Print", 2009.



Dr. Mazllum Baraliu

## **GJENDJA DHE PROBLEMET E LEGJISLACIONIT ELEKTORAL DHE KODIFIKIMI I TIJ SI IMPERATIV**

*MOTO: "DEMOKRACIA ËSHTË QEVERISJE E POPULLIT, NGA  
POPULLI, PËR POPULLIN - ME THEKS TË VEÇANTË TE QEVERISJA"*

HAROLD WILSON

### **Shqyrtime preliminare**

Që moti është e njohur, rrjedhimisht e sprovuar shumëherë se, gjatë proceseve zhvillimore, demokracia, liria dhe vlerat e tjera më sublime të një vendi, populli a shoqërie nuk pranojnë, nuk gëlltisin klishe, dozime as abuzime flagrante e të përhershme. Kjo për arsye se as shumica dërmuese apo thënë pa pezhorativizëm, as masat e gjëra popullore, të paktën në momentet kritike historike nuk lejojnë, nuk durojnë dhe as që pranojnë dominimin bezdisës, çorientues ose imponimin e vullnetit të qarqeve të caktuara politike mbi vullnetin e tyre. Pra, nuk lejojnë nëpërkëmbjen e vullnetit të shumicës dërmuese; përpjekja, opcioni, vizioni dhe orientimi i së cilës shumicë, mbase në kushte dhe rrethana të shëndosha shoqërore ekonomike e politike, do të duhej të ishte edhe demokratik, edhe progresiv, edhe perspektiv.

### **Disa fjalë përkitazi me korrelacionet e shumicës dhe pakicës demokratike**

Edhe në sistemet demokratike, rrjedhimisht në vetë brendinë e demokracisë ekziston dallim i theksuar ndërmjet asaj se çka e si duhet të jetë demokracia dhe asaj se çka në të vertetë – faktikisht dhe realisht – ajo është. Dallime të konsiderueshme ekzistojnë edhe në vlerësimet, se cili kontekst shoqëror(socioekonomik, politik-juridik, formal-institucional) duhet të jetë i karakterit përfaqësues. (**John Stuart Mill: Consideration on Representative Government, Indianapolis, 1958, fq. 55.** )

Mirëpo për esencën dhe karakterin e tillë të demokracisë, Gjovani Sartori thotë se nuk është aspak me rëndësi bamuria e ecurisë historike të rrugës që ka bërë qytetari-individ drejtë lirisë dhe demokracisë. Kështu, p.sh. qytetari i antikës greke, lirinë dhe

demokracinë e tij e ka realizuar duke lëvizur nga **polisi** (shteti; qytet-shteti) drejt **politesit** (shoqërisë), ndërsa qytetari i sotëm-bashkëkohor, këtë rrugë e përshkon në mënyrë të kundërt - nga shoqëria drejt shtetit (J. S. Mill, op. cit. , fq. 187). Pra, këtu kemi të bëjmë me një ligjshmeri të demokracisë, si një sistem të "sundimit elektoral", ku rregulla e shumicës " prodhon" pakicën ose pakicat, të cilat drejtojnë me të. Në mënyrë figurative kjo i bie si vijon: qytetarët-votues i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvend, i cili është pakicë në krahasim me trupin elektoral. Kuvendi pastaj e zgjedh qeverinë, e cila në relacion me të, pra me Kuvendin, është pakicë. Rregulla e shumicës në këtë mënyrë "e shndërron shumicën nominale në numër më të vogël" (J. S. Mill, op. cit. fq. 146).

Së këndejmi Rregulla e shumicës në demokracitë e ashtuquajtura përfaqësuese synimin suprem dhe të fundit e ka që ta realizojë të drejtën e saj të shumicës, që ta zgjedhë pakicën e cila në emer të saj do të qeverisë - sundojë. Kështu, në marrëdhënien e shumicës dhe pakicës vëhet shumëçka që tejkalon një marrëdhënie aritmetikore të madhësive. Në fakt paraqitet problem i ndërlikohjes optimale të sasisë dhe cilësisë, pasqyrohet fakti notor se të "votosh-të zgjedhësh është një gjë, ndërsa të vendosësh është diç tjetër". Kjo premisë rrjedhimisht do të thotë që" hapësira e vendosjes...në masë të konsiderueshme është më e madhe se sa hapësira e zgjedhjes" (Gjovani Sartori, *Demokracia ç'është kjo?*, fq. 96, në Prof. dr. Radovan Radonjiq, *Demokratija, Podgoricë, 2004.* , fq. 69. ). Në këtë kontekst duhet venë në spikamë çështjen e marrëdhënieve ndërmjet shumicës dhe pakicës; çështjen e sasisë dhe të cilësisë së të drejtave ndërmjet shumicës dhe pakicës dhe mbrojtjes së kësaj pakice nga padrejtësitë deri në sjellje dhe veprime tiranike të saj; por edhe anasjelltas - mbrojtja e shumicës nga pakica. Në realitet ndërlikohja optimale e sasisë dhe cilësisë në procesin e vendimmarrjes kolektive paraqitet shpesh edhe si sprovë edhe si vështërsi serioze në korrelacionet ndërmjet shumicës dhe pakicës.

Në parim dhe në esencë shumica demokratike, gjykuar sipas standardeve dhe postulateve të mirënjohura e të gjithëpranuara ndërkombëtare ngërthen në vetëvete kuptimin e demokracisë si sistemi më i pranueshëm në botë sot. Si e tillë, pra si e gjithëpranueshme, shumica demokratike, pas fitores zgjedhore fiton dhe ka legjitimitet të plotë për qeverisje, përkatësisht udhëheqje të institucioneve të një vendi.

Mirëpo athua ndonjëherë në praktikë nuk ndodh që pikërisht kjo shumicë demokratike, veçmas” **shumica elektorale**” si emancipuese; qoftë madje edhe si përfaqësuese e vullnetit ”burimor” e ”sovran” të masës kritike, të patrajtësuar sa e si duhet, por të kuazimozakizuar deri në stërkeqje partikulariste të abuzojë momentin, trendin, procesin apo edhe pozitën e saj shoqërore në dëm të të tjerëve, madje edhe në dëm të vetvetes?

Kjo gjendje apo sjellje antishoqërore e antihistorike mund të ndodhë herëpashërë; madje edhe të prodhojë efekte negative shumëdimensionale e me pasoja të pariparueshme për demokracinë dhe ardhmërinë shoqërore të një vendi, respektivisht perspektivën e proceseve socioekonomike e politike. Këto lloje sjelljesh, përkimisht fenomene mund të ndodhin edhe pas proceseve elektorale në vende të ndryshme të rruzullit tokësor.

Njëri nga teoricienët e njohur të filozofisë politike, Alexis De Toquille, këtë gjendje trazuese dhe dominuese e quan” **tirani të shumicës**”. Sipas tij, kjo tirani, madje herë-herë vjen e manifestohet (edhe si dominim absolut) për një periudhë të caktuar shoqërore. Mirëpo e tërë çështja varet kryesisht nga faktorët, kushtet dhe rrethanat e caktuara e specifike shoqërore të një vendi, rrjedhimisht të një shoqërie të caktuar.

Duke e studiuar domethënien apo brendinë politike të tiranisë së shumicës, sidomos kur në situatat elektorale, përkatësisht pas proceseve elektorale ajo e fiton pushtetin, jo vetëm që të tjerëve, sidomos” **pakicës humbëse**” në zgjedhje ia imponon vullnetin e saj, por edhe po të njëjtës pakicë mund edhe t’ia kufizojë e vështirësojë seriozisht jo vetëm pasqyrimin e pikëpamjeve të saj politike dhe të tjera përkitazi me çështjet dhe proceset e rëndësishme dhe peshës primare, por edhe ta defaktorizojë atë deri në marginalizim skajor. Kjo formë e epërsisë, për të mos thënë edhe dominimit absolut (gjithnjë sipas Tokvill-it) e lëndon dhe e dëmton deri në rrezikim pozitën vepruese e shoqërore, rolin dhe sidomos ndikimin e anës tjetër (opozitës si pakicë parlamentare) veçmas në procesin legjislativ në kuvendin e vendit të caktuar si organin suprem e sovran: përfaqësues e ligjvënës. Sjelljet tiranizuese të shumicës reflektohen në cenimin e pozitës shoqërore, rrjedhimisht të drejtave të pakicës. Kjo formë e tiranisë konsiderohet nga teoricienët e ndryshëm se ekziston kurdoherë kur aplikohet parimi i shumicës në vendimarrje - qeverisje. Andaj mbase Tokvill-i konkludon se ”mangësia natyrale e

demokracisë është nënshtrimi gradual i të gjitha pushteteve dëshirave edhe më të imta të shumicës” (*Aleksis de Tovil: Mbi demokracinë në Amerikë, fq. 119*). Në kontekstin elektoral, tirania e shumicës ngërthehet, siç do të thoshte Sartori, në tirani të numrave, përkatësisht të sasisë. Ky lloj i tiranisë është inkorporuar në themelet e sistemit elektoral mazhoritar. Mirëpo kjo nuk duhet ngatërruar me tiraninë e cila rezulton nga shfrytëzimi i pozitës së shumicës, të fituar nga mbivotimi gjatë procesit të vendosjes në dëm të pakicës së mbivotuar. Në kontekstin shoqëror-social tirania e shumicës merr përmasa dhe gamështrirje më të gjerë. Ajo është më gjithëpërfshirëse. Pasqyrohet në përpjekjet e shumicës, që jo vetëm individit, por edhe tërë shoqërisë t’ia imponojë vullnetin e saj konformist dhe të gjitha standardet e saj kulturologjike, etike, politike dhe gjithëshoqërore. Disa këtë lloj tiranie të shumicës ndaj pakicës e quajnë edhe tirani të mediokritetit, përkatësisht të opinionit publik, që shpesh pretendon dizajnimin e individit dhe mbarë shoqërisë sipas ndonjë mostre a modeli specifik, por të dëshiruar nga shumica tiranizuese. Kjo tirani vetëkupton mëtutje përpjekjen e vënies së mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi unin dhe sjelljen e secilit dhe të gjithëve në një shoqëri të caktuar.

Sipas disa autorëve të tjerë (sidomos atyre të shkrimeve federaliste), njëra nga mundësitë dhe rreziqet që përmban demokracia (sidomos ajo e pakonsoliduar) është varianti potencial i sundimit me primesa tiranie (edhe monarkike edhe despotike) të përfaqësuesve të zgjedhur (në mënyrë demokratike) ndaj pakicës, duke e shkelur apo shtypur atë. Mirëpo krahas apo përveç tiranisë së shumicës, demokracia si fenomen i gjithëpranueshëm ngërthen në vete edhe rrezikun e tiranisë së” pakicës”, që si fenomen i pranishëm në praktikat qeverisëse shoqërore mund të jetë edhe më i dëmshëm dhe më i rrezikshëm se sa tiranizimi i shumicës, që ndonjëherë në teori quhet edhe” tirani shoqërore”. Ky fenomen në rrjedhat dhe proceset shoqërore mund të reflektohet edhe si anakronik, edhe metastazues, por edhe prodhimtar i pasojave specifiku të dëmshme, jo rrallëherë edhe të pariparueshme.

Së këndejmi, nuk mjafton të ruhet vetëm pakica e elektorale dhe ajo shoqërore nga goditjet tiranizuese të shumicës, por lypset herëherë edhe më shumë të mbrohet shumica nga pakica dezorientuese autarkike, shpërthyesë dhe goditëse. Ndaj, sipas Medisonit, vërtet është e nevojshme që ”të mbrohet një segment apo pjesë e shoqërisë, nga padrejtësia e pjesës tjetër të saj”, unë do të shtoja pa dallim nga madhësia e tyre. Me rëndësi është pozita, roli dhe pesha që kanë këto”

njësi apo fuqi sunduese” të çastit apo fazës së caktuar historike, politike e shoqërore<sup>1</sup>. Ndonëse ende ka teoricienë që tiraninë e pakicës në sistemin e demokracisë e konsiderojnë si logjikisht dhe praktikisht të pamundshme, rrjedhimisht të pazbatueshme, ajo në realitet është e mundshme të ndodhë, të paraqitet dhe ndodh të aplikohet. Përse? Sepse shpërndarja e fuqisë shoqërore, që do të thotë e pushtetit, respektivisht shtrirja funksionale e tij, për shkaqe dhe arsye të shumta, nuk bëhet në praktikë ose ai pushtet nuk dëshmohet sa duhet efektiv dhe efikas dhe sepse kontrolli demokratik i shumicës ndaj pakicës nuk funksionon gjithëherë ose nuk funksionon si dhe sa duhet në jetën e përditshme shtetore të institucioneve demokratike të shumicës në një vend të caktuar. Është për t’u vënë re se bartja dhe fuqizimi i punëve-kompetencave operative dhe administrative në suaza të organizmave dhe organeve të ngushta e të larta ekzekutive zakonisht krijon fuqi më të madhe, mbase jashtproporcionale të pakicës, respektivisht qarqeve a segmenteve të saj.

Megjithatë, vështruar çështjen në parim, shumë më lehtë është që në një rend demokratik të kufizohet pakica, respektivisht ndikimi i saj. Shumica në shoqëritë demokratike këtë veprim e bën më të lehtë e më të realizueshem, kryesisht përmes mekanizmave dhe instrumenteve elektorale që ka në dispozicion.

E bën me fuqinë e votës e të procesit të votimit, përkatësisht nëpërmjet vullnetit sovran të popullit të shprehur me votën e lirë në një proces korrekt, të drejtë e të pakontestueshëm demokratik i cili pastaj përmes përfaqësuesve legjitim artikullohet si” shumicë shoqërore” në institucionet përkatëse legale dhe legjitime të një vendi të caktuar.

Në të vërtetë vetë esenca dhe karakteri përfaqësues i demokracisë në parim e zvogëlon mundësinë dhe gjasat për tjetërsimin apo alienimin e përfaqësuesve nga populli i tyre, respektivisht nga trupi elektoral. Mirëpo serish lypset vënë në pah se problem është se si ta kufizosh shumicën, keqpërdorimin e pushtetit nga ajo, që atë pushtet e ka fituar në mënyrë të padiskutueshme demokratike, por që më vonë, pra pas përfunimit të procesit elektoral dhe fillimit të ushtrimit të pushtetit (shtetëror) demokratik në situata, kushte dhe rrethana specifike fillon seriozisht të abuzojë me të.

---

1. Hamilton, Madison, JAY; The Federalist Papers no. 51; fq. 323.

Kjo është njëra nga çështjet qenësore dhe qendrore, që me shumë përkushtim dhe akribi trajtohet në shënimet – **shkrimet federale** dhe në filozofinë politike të Tokvillit. Medison, në” shkrimet federale” lidhur me këtë shkruante:” **Ta mbrosh të mirën e përgjithshme dhe të drejtat e qytetarëve nga përfaqësuesit e tillë të demokracisë (përkatësisht të popullit) dhe në të njëjtën kohë ta ruash frymën dhe formën e sundimit popullor (të popullit) – është në fakt qëllim madhor drejt të cilit janë orientuar kërkimet tona**”<sup>2</sup>.

Sipas ”shkrimeve federaliste”, tiraninë e shumicës mund ta pengojnë dy gjëra: gërshetueshmëria dhe kompleksiteti i interesave shoqërore, si dhe parimi i ndarjes së pushtetit.

Pra, tirania e shumicës kufizohet në dy domene apo fusha kryesore: në vetë shoqërinë si tërësi dhe në domenin e institucioneve politike.

Gjykuar sipas Tokvillit, autorit të” **Demokracisë në Amerikë**”, ”pushteti i pakufizuar i shumicës është veçori dhe karakteristikë e demokracisë; ai është i natyrshëm sepse përbën esencën e demokracisë. Jashtë shumicës në rendin demokratik asgjë tjetër nuk ekziston, që nuk do të mund t’i kundërvihet atij rendi dhe asaj shumice.

Në demokraci populli është burim dhe esencë e çdogjëje<sup>3</sup>. Derisa në monarki mbretëronte bindja dhe maksima e mirënjohur sipas së cilës mbreti nuk mund të gabojë, në demokraci katërcipërisht vlen parimi se populli (shumica elektorale) gjithmonë ka të drejtë<sup>4</sup>.

Sipas **Xhejms Brajsit**<sup>5</sup> autoriteti moral i shumicës pjesërisht bazohet edhe në idenë sipas së cilës më shumë njerëz kanë më shumë aftësi, kapacitete dhe potencial. Autoriteti dhe interesat e shumicës nuk bën të jenë të supozuara në relacion me interesat e pakicës. Liria e gjerë e mendimit dhe e diskutimit po ashtu ndihmojnë epërsinë e gjithfuqishme të shumicës. Indiferenca në shoqëri është armik i saj, andaj pjesëmarrja aktive si e shumicës ashtu edhe e pakicës në proceset politike dhe elektorale është imperitiv. Kjo vlen edhe sa i

<sup>2</sup> IBID, nr. 10. , fq. 80.

<sup>3</sup> Tocqueville, De la Democratie en Amerique, Libri I, fq. 56; 257.

<sup>4</sup> Alexis de Tocqueville, OEYVRES completes: voyages en Sicile et aux Etats – unis, Paris, Galimard, 1957, vëllimi 5; libri I.

<sup>5</sup> Tocqueville, De la Democratie en Amerique, Libri I; fq. 258.

përket mënyrës, kohës dhe cilësisë së përgatitjes dhe miratimit të legjislacionit elektoral dhe zbatimit të tij në praktikë.

Askush nuk mund ta mohojë faktin se nuk ka pasur mundësinë, çastin dhe rastin që fjala, mendimi ose të paktën vota e tij të dëgjohen dhe valorizohen. Ata të cilët shumicën demokratike e nënvlerësojnë ose edhe më tepër se kaq e akuzojnë (gjykojnë), nuk kanë tashmë se kujt ti ankohen, sepse i kanë shfrytëzuar ose kanë pasur rastin dhe mundësinë e përcaktimit të tyre politik, që do të thotë të shrytëzimit të së drejtës së votës për subjektin e caktuar politik, rrjedhimisht secili individ ka mundësi demokratike të pasqyrimin e të mbrojtjes së pikëpamjeve vetanake – **Roma locuta causa finite** -, thotë Xhejms Brajs, në shkrimet e tij përkitazi me këtë çështje <sup>6</sup>.

Fakti notor sipas të cilit krahas të ashtuquajturës” **tirani të shumicës**” ekziston edhe” **tirania e pakicës**”, ndër të tjera, pashmangshmërisht e imponon pyetjen legjitime të çdo qytetari, veçmas të atyre që janë ithtarë të flaktë të demokracisë si proces dhe sidomos si sistem më i etabluar, më i avansuar dhe më i admiruar aktualisht në botë, se a mbetet hapësirë veprimi dhe funksionimi për demokracinë, e cila gjithnjë sipas tyre gjendet nën një lloj ”senvigji” (qoftë ai edhe alternativ ose i kohëpaskohshëm) të të dy llojeve të tiranisë së elaboruar më lart?!

Përgjigjja më e shpeshtë dhe madje si të thuash edhe e etabluar tashmë me predominancë në këtë pyetje është pozitive. Pra, përkundër pranisë së fenomenit ”tirani të shumicës” ose ”tirani të pakicës”, **demokracia** megjithatë funksionon dhe zhvillohet si **fenomen demokratik**, si proces, si sistem i sundimit të shumicës i etabluar dhe i stabilizuar tashmë. Paraqitja e kohëpaskohshme e ”tiranive” të sipërelaboruara nuk do të thotë katërcipërisht se demokracitë specifike bashkëkohore sot në vende të ndryshme të botës janë **dukuri syprinore ose edhe periferike shoqërore**, të pataban dhe të parrënjë. Përkundrazi, ato sipas pikëpamjeve të një numri dominues teorikësh janë (ku më shumë e ku më pakë) madje edhe gjithëpërfshirëse, progresive dhe perspektive.

Mirëpo nga ana tjetër ekzistojnë mendimtarë skeptikë dhe kritikë të ashpër të demokracisë, sidomos asaj elektorale, siç është Gjovani Santori (Demokracia, ç’është kjo?) e ndonjë tjetër, të cilët për

---

<sup>6</sup> James Bryce, *The American Commonwealth*, Neë York, Macmillan, 1920, Libri II, fq. 338-346.

më tepër debatojnë fuqimisht, madje edhe në formë interrogative se a ekziston fare apo jo demokracia!

Është evidente dhe e pakontestueshme, se manifestimi qoftë edhe segmentar e i herëpashershëm i cilësdo formë të" tiranisë" e dëmton dukshëm demokracinë si të tillë. Zgjidhja më e mirë, më e drejtë dhe më utilitare në kuptim të mbrojtjes së interesit të shumicës shoqërore, padyshim do të ishte konsensusi politik dhe ai institucional në drejtimin e punëve publike, respektivisht të qeverisjes së vendit. Kjo metodë e njohur e veprimit nuk nënkupton mënjanimin ose edhe abandonimin e parimit qeverisës të shumicës. Kjo në të vertetë do të thotë më shumë se kaq. Do të thotë avancim maksimal të sistemit demokratik të një vendi, përkimisht të një populli.<sup>7</sup>

Pra, me një fjalë demokracia, veçmas ajo elektorale qoftë si fenomen, qoftë si proces apo si sistemi më i pranuar dhe i avancuar i sundimit e qeverisjes sot ka ende shumë nevojë për analiza, eksplorime dhe hulumtime serioze shkencore, empirike dhe pragmatike, në mënyrë që të jetë edhe më e shtrirë dhe më e përfaqshme gjithandej botës mbarë.

Për t'i kuptuar më mirë çështjet që kanë të bëjnë me legjislacionin elektoral, është e dobishme që të kuptojmë esencën dhe përkufizimin e sistemit elektoral. Sistemi elektoral ngërthen në vete një tërësi të parimeve dhe procedurave me të cilat është trajtësuar dhe rregulluar procesi i zgjedhjes së bartësve të funksioneve publike para se gjithash në organet përfaqësuese dhe ato të pushtetit.

Elementët e sistemit elektoral janë:

- **parimet e caktuara;**
- **të drejtat dhe marrëdhëniet e subjekteve elektorale;**
- **etapat - fazat zhvillimore elektorale;**
- **korniza territoriale dhe kohore e procesit elektoral, si dhe të gjitha**
- **veprimet e tjera politike dhe teknike, të cilat janë të domosdoshme për zhvillim efikas, efektiv e të bazuar në parimet dhe normat e pranuar të zhvillimit të zgjedhjeve në një vend të caktuar.**

<sup>7</sup> Më gjerësisht për këtë shih: Robert Dal:Demokracia dhe kritikuesit e saj, fq. 231 etj. , ;Prof. dr. Radovan Radonjic: Demokracia, Podgoricë, 2004, fq. 73-75).

Është i madh dhe i pazëvendësueshëm roli i sistemit elektoral të një vendi në krijimin e kushteve, klimës dhe mileut të tillë të përshtshëm, në mënyrë që qytetarët të zgjedhin ata për të cilët besojnë që do ta respektojnë vullnetin e tyre, do t'i përfaqësojnë interesat e tyre dhe do ta përçojnë zërin e tyre sovran në instucionet ku do të jenë të përfaqësuar. Mu për këtë arsye shpesh thuhet se i tillë çfarë është sistemi elektoral, i tillë do të jetë edhe sistemi partiak e edhe shteti. Kësodore, sfera elektorale e kornizuar me sistemin elektoral ndërthet në vete distriktin e” **ligjeve themelore të demokracisë**” dhe është njëra nga vatrata dhe foletë e kulturës politike të shoqërisë në përgjithësi. Nuk mund të imagjinohet demokracia në një vend, veçanërisht kultura demokratike politike “**në të cilën baza apo hapi i parë, zgjedhjet nuk janë demokratike ose janë të tilla vetëm formalisht**”<sup>8</sup>. Ende në botën bashkëkohore nuk ekziston një sistem elektoral universal, i gjithpranueshëm dhe më i miri i mundshëm. Sipas pikëpamjeve të teoricienëve të ndryshëm, ekzistojnë vetëm elementët e shumtë, divers dhe të rëndësishëm të cilët e bëjnë strukturën e një sistemi elektoral. Se cilët nga elementët do të merren parasysh varet nga shumë faktorë, kushte dhe rrethana specifike të regjimeve të ndryshme, në vende të ndryshme të globit. D. Nolen, p. sh., konsideron se për një sistem elektoral më të rëndësishëm janë 4 elemente:

- ndarja në qarqe apo zona elektorale;
- gara apo fushata elektorale;
- procesi apo dita e votimeve dhe
- llogaria dhe numërimi i votave<sup>9</sup>.

Për Lajphart-in, nga ana tjetër, elementët kryesore të një sistemi janë:

- metoda elektorale (formulare);
- mënyra e votimit dhe
- madhësia e njësisë zgjedhore<sup>10</sup>.

---

<sup>8</sup> Milan Matic, *Izbori*, fq. 447.

<sup>9</sup> D. Nolen, *E drejta elektorale dhe sistemi partiak*, fq. 7-8.

<sup>10</sup> Shih: Veselin Paviqeviq, *Izborni sistem i izbori u Crnoj Gori 1990-1996*, fq. 43.

Për karakterin e sistemit elektoral, mënyrën dhe efikasitetin e funksionimit të tij janë veçanërisht të rëndësishme:

1. Metodrat (formularët elektoralë);
2. Sjellja elektorale;
3. Teknika elektorale dhe
4. Legjislacioni elektoral.

### **Roli dhe rëndësia e proceseve elektorale për rendin demokratik të një vendi dhe populli**

Zgjedhjet si procese elektorale në fakt kanë funksion dhe rëndësi të pazëvendësueshme në rendin demokratik të një vendi. Jo rastësisht Zhan Zhak Ruso vlersonte: ”... qytetarët e Anglisë janë sovran vetëm në momentin kur i zgjedhin anëtarët e Parlamentit”.

Proceset elektorale, sistemet elektorale dhe legjislacioni elektoral u japin qytetarëve fuqi jo vetëm për ta kufizuar qëndrimin dhe orientimin e tyre qeverisës drejt përmasave arbitrare e autoritare, por edhe mundësinë për ndërrimin e elitave të politikave nga pushteti, situatë të cilën teorecieni Talcott Parsons e shpreh përmes konstatimit të tij lapidar: **”Të votosh do të thotë të ushtrosh – demostrosh fuqi”** (Parsons 1969: 108). Zgjedhjet në të vërtetë maksimalisht e shprehin dhe e forcojnë perkatësinë dhe përkushtimin nacional të individit ndaj bashkësisë politike, për t’i kontribuar në këtë mënyrë integritet të saj, thotë një tjetër teoreciën e rëndësishëm – Nordlinger (Nordlinger, 1968: 124).

Përkunder kësaj, refuzimi ose më mirë thënë mospjesëmarrja e segmenteve të rëndësishme të popullsisë në proceset elektorale, në një mënyrë apo një tjetër, është shenjë e mungesës së konsensusit themelor në një bashkësi të caktuar politike. Mospjesëmarrja aktive dhe kualitative e një mase, rrjedhimisht përqindjeje të konsiderueshme në proceset e caktuara elektorale të një vendi është pasojë e ndikimit dhe të pranisë së shumë faktorëve. Për ta parandaluar, zbuluar dhe zbërthyer shumësinë e faktorëve, të cilët mund të ndikojnë në daljen me pakicë ose numerikisht në shkallë më të ulët për nga përqindja e votuesve në një proces elektoral, gjithsesi lypset bërë analiza dhe studime serioze të vazhdueshme dhe me kompetencë nga ekspertët e fushave ndërlllore të një vendi.

Çdo gjë që u tha më sipër lidhur me zgjedhjet dhe esencën e tyre do të ishte pasqyrim i pamjaftueshëm dhe jo i plotë pa elaborimin e peshës dhe të rëndësisë që ka legjislacioni elektoral për zgjedhjet e drejta, demokratike, korrekte dhe mbi të gjitha të ligjshme.

## **Shkurtimisht për sistemin elektoral dhe të drejtën elektorale**

Sistemi elektoral është një nga pjesët më të rëndësishme të së drejtës kushtetuese. Përmes proceseve elektorale shtetasit realizojnë njërën ndër të drejtat e tyre themelore dhe vitale, të drejtën e zgjedhjes, përkatësisht të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Me sistem elektoral nënkuptohet një tërësi e procedurave dhe e veprimeve të cilat përcaktojnë se si qytetarët-votues mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës, përkatësisht të zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre në institucionet e vendit. Këto procedura ndër të tjera përfshijnë mënyrën se si është strukturuar dhe modeluar fletëvotimi, mënyra e zgjedhjes – e votimit, e numërimit të votave dhe e shpalljes së fituesve. Sistemi elektoral përkufizohet në kuptim të gjerë dhe në atë të ngushtë. Me sistemin elektoral në kuptim të gjerë kuptojmë tërësinë e parimeve, të drejtave, garancive, aktiviteteve dhe punëve të tjera teknike të sanksionuara me kushtetutë, ligje dhe akte të tjera juridike në bazë të të cilave përcaktohet dhe sendërtohet pjesëmarrja e shtetasve në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre në organet përkatëse të shtetit. Ndërkoq në kuptimin e ngushtë, sistemi elektoral vetëkupton mënyrën e ndarjes së mandateve. Ndarja e mandateve nuk është çështje teknike, ngase nënkupton formën e katalizimit dhe të rreshtimit të kandidatëve të zgjedhur, ndaj si e tillë ndarja e mandateve nënkupton esencën e një elementi të qenësishëm të sistemit elektoral.

E drejta elektorale nga ana tjetër ngërthen në vete njërin ndër komponentët më qenësor të sistemit elektoral. E drejta elektorale në kuptimin subjektiv vetëkupton njërën nga të drejtat më themelore dhe të rëndësishme të shtetasve në veprimtarinë e tyre politike – të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur; rrjedhimisht të drejtën e zgjedhjes aktive dhe të drejtën e zgjedhjes pasive në organet shtetërore të një vendi. Në kuptimin objektiv, nga ana tjetër, e drejta elektorale ngërthen atë pjesë të së drejtës pozitive të shtetit, përkatësisht atë sistem të normave juridike, me të cilat rregullohet zgjedhja e organeve më të larta shtetërore. Me këto norma në fakt përcaktohet se kush ka të

drejtë të zgjedhjes në organet dhe institucionet kompetente; përcaktohet baza e elektoratit dhe rrethi i pjesëmarrësve në zgjedhje, normat e përfaqësimit; të drejtat dhe detyrat e partive politike, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e organeve shtetërore të ngarkuara për zbatimin e zgjedhjeve.

### **Legjislacioni elektoral aktual në Republikën e Kosovës dhe domosdoja imperative e kodifikimit të tij**

Çfarë është gjendja aktuale e legjislacionit elektoral te ne sot dhe çka duhet bërë për ta avancuar atë?

Cilët janë faktorët orientues, parësor dhe vendimtar në këtë çështje?

Faktorët vendimtarë janë:

- vetëdija e lartë qytetare dhe shoqërore;
- rrethanat dhe interlokutorët influencues nga jashtë dhe nga brenda (politikbërësit dhe opinionkrijuesit);
- legjislacioni i mirëfilltë i reformuar dhe i kodifikuar në plotëni, i cili do të respektohet nga të gjithë dhe do të zbatohet efektivisht, etj.

Në trajtimin e mëtejme do të bëhet fjalë përkitazi me faktorin legjislativ, si njërin nga faktorët më relevant i cili drejtëpërsëdrejti ndikon në avancimin demokratik, politik dhe gjithëpërfshirës të ndërtimit të qëndrueshëm të sistemit të vlerave, të kornizës institucionale shtetndertuese dhe qeverisjes, respektivisht sundimit të mirëfilltë dhe legjitimit të shumicës demokratike në shoqërinë tonë.

Pavarësisht nga fakti që në aspektin etimologjik demokracia e vërtetë nënkupton sundimin e popullit, ajo në realitet objektivisht sendertohet vetëm si sundim të përfaqësuesve të zgjedhur në emer të popullit. Meqë populli nuk mund të qeverisë drejtëpërsëdrejti, ngase demokracia e drejtëpërdrejtë ende ka mbetur një synim ideal i parealizuar, zgjedhjet, krahas legjislacionit elektoral, paraqesin një instrument të domosdoshëm të demokracisë së ashtuquajtur përfaqësuese e cila në praktikë mund të sendertohet.

## **Roli dhe rëndësia e legjislacionit elektoral në proceset demokratike**

Për të pasur zgjedhje të rregullta, të drejta dhe demokratike në një vend, përveç tjerash lypset instaluar një legjislacion të mirëfilltë po ashtu demokratik, të avancuar, human dhe të zbatueshëm elektoral.

Roli dhe rëndësia e legjislacionit elektoral në proceset demokratike zgjedhore është i pazavendësueshëm.

Me legjislacionin elektoral, duhet rregullohen të gjitha qështjët që kanë peshë, reflektim dhe rëndësi për ecurinë formale-procedurale të proqesit electoral; për sjellje elektorale, si dhe për financimin e zgjedhjeve dhe të fushatës elektorale.

Kontrollin e ligjëshmerisë së veprimeve dhe të sjelljeve elektorale të aktorëve pjesëmarrës në zgjedhje, varësisht si është paraparë e rregulluar me legjislacionin elektoral e ushtrojnë organët kompetente administrative dhe ato gjyqësore.

## **Shkurtimisht përkitazi me retrospektivën e legjislacionit elektoral dhe çështjet elektorale nga viti 2000 e këndej**

Kosova e pasluftës së fundit, Kosova e konsolidimit dhe zhvillimit demokratik ka përjetuar një varg procesesh elektorale që nga viti 2001 e deri në zgjedhjet e fundit të përgjithshme të vitit 2010. Zgjedhjet e para komunale në Kosovën e pasluftës janë mbajtur më 28 tetor të vitit 2000. Zgjedhjet pasuese po në nivelin komunal janë mbajtur më 26 tetor të vitit 2002. Dhe në vitin 2004 janë mbajtur zgjedhjet komunale - saktësisht më 23 tetor të vitit në fjalë.

Zgjedhjet e para për Kuvendin e Kosovës ndërkaq janë mbajtur më 17 nëntor të vitit 2001, edhe në vitin 2007, saktësisht më 17 nëntor janë mbajtur zgjedhjet e dyta për Kuvendin e Kosovës. Ndërkaq, zgjedhjet e fundit të përgjithshme, përkatësisht për Kuvendin e Republikës së Kosovës janë mbajtur në vitin 2010.

Në funksion të pasqyrimin kronologjik të retrospektivës zgjedhore në Kosovë vlen të përmendet fakti se në vitin 2007 (më 17 nëntor) në Kosovë janë mbajtur 3 palë zgjedhje:

- Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;
- Zgjedhjet për kuvendet e komunave të Kosovës dhe
- Zgjedhjet për kryetarë të komunave të Kosovës.

Në vitin 2009, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, për herë të parë në shtetin e lirë dhe demokratik do të mbahen zgjedhjet e para komunale, ndërsa në vitin 2010 siç u theksua më sipër, do të mbahen zgjedhjet e para të përgjithshme për Kuvendin e Kosovës në Republikën e Kosovës, shtet sovran dhe i pavarur.

Nga sa u pasqyrua më sipër mund të theksohet pa ngurim se historiku i zhvillimit të proceseve elektorale në Kosovën e pasluftës së fundit është karakterizuar me një entuziazëm, emulacion dhe përkushtim, do të thoshim gjithëshoqëror të mbarë shoqërisë kosovare. Në këto zgjedhje, marrë në tërësi, qytetarët e Kosovës, institucionet si dhe partitë politike të saj kanë treguar dhe dëshmuar një pjekuri të lartë politike dhe sjellje dinjitoze qytetëruese si gjatë fushatave paraelektorale, ashtu edhe në fazat tjera të proceseve elektorale. Pikërisht për këtë arsye, zgjedhjet në Kosovë në këtë periudhë të konsolidimit demokratik janë vlerësuar të drejta, të qeta dhe demokratike. Për më tepër, Kosova, respektivisht qytetarët e saj si nga vlerësuesit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë, ashtu edhe nga institucionet përkatëse janë vlerësuar me një kulturë dhe pjekuri të lartë politike dhe për dinjitet e përkushtim demokratik në ndërtimin institucional të vendit. Në këtë mënyrë Kosova përsa u përket proceseve elektorale ka shërbyer si model dhe shembull pozitiv qoftë për shtetet e rajonit, ashtu edhe më gjerë.

Mirëpo përkundër sukseseve dhe rezultateve të arritura në këtë domen, gjatë proceseve elektorale, veçanërisht atyre të vitit 2009 dhe 2010, janë paraqitur edhe probleme, lëshime dhe dobësi të natyrave të ndryshme. Përveç problemeve organizative, drejtuese (menaxheriale) dhe koordinuese, problemi kryesor që ka shkaktuar pasoja të vazhdueshme gjatë proceseve elektorale, por edhe para dhe pas tyre, është legjislacioni elektoral i cili ka qenë dhe vazhdon të jetë në fuqi ende në Kosovë. Për t'i organizuar zgjedhjet e para dhe ato të mëpastajme të pasluftës në Kosovë, Administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut në Kosovë me shpejtësi dhe pa profesionalizëm të mjaftueshëm ka nxjerrë një varg rregulloresh si akte me fuqi ligjore dhe udhëzime administrative e rregulla të brendshme elektorale. Me këto akte legjislative primare dhe sekondare, UNMIK-u së bashku me institucionet vendore i ka organizuar zgjedhjet e ndryshme deri në vitin 2008. Këto akte të legjislacionit primar dhe sekondar janë përcjellur me shumë e shumë lëshime dhe mangësi të natyrave të ndryshme. Mirëpo as ligjet e fundit, pra më të rejtat në Republikën e Kosovës të nxjerra në vitin 2008, si:

- Ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe
- Ligji për zgjedhjet lokale,

nuk kanë qenë më të avancuara dhe më të kompletuara. Përkundrazi, ligjet në fjalë janë përcjellë me shumë mangësi, zgjidhje kontradiktore dhe ambivalente, duke shkaktuar kështu vështirësi, pakënaqësi dhe probleme të shumta në interpretimin e tyre qoftë nga subjektet politike, qoftë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioni për Parashtresa dhe Ankesa, Gjykata Supreme e deri te Gjykata Kushtetuese.

Pikërisht për shkak të lëshimeve dhe mangësive të shumta të legjislacionit elektoral ndodhën shumë parregullsi, vështirësi dhe probleme në zbatimin e këtyre ligjeve sidomos gjatë dy proceseve të fundit elektorale në Republikën e Kosovës. Kjo gjendje e krijuar në legjislacionin elektoral më në fund i bindi të gjithë aktorët dhe faktorët relevantë institucionalë – vendorë e ndërkombëtarë, si dhe subjektet politike relevante që të ndërmarrin niasativa për reformimin e legjislacionit elektoral deri në kodifikim të tij.

## **Korniza aktuale pozitive legjislative elektorale në Republikën e Kosovës**

### **Kodifikimi**

Legjislacioni në fuqi që regullon materjen elektorale në Republikën e Kosovës, aktualisht përbëhet nga:

- Legjislacioni primar dhe
- Legjislacioni sekundar.

Ndonse me pakon e ashtuquajtur të Ahtisarit qysh në vitin 2008 Kosova është dashur të pregatisë dhe të miratojë të paktën katër ligje, që kanë të bëjnë me materjen elektorale dhe atë: Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, Ligjin për zgjedhjet lokale, Ligjin për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Ligjin për financimin e partive politike. Mirëpo, aktualisht te ne janë në fuqi tri nga ligjet e sipërpermendura, duke përjashtuar këtu Ligjin për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Legjislacioni ynë elektoral në fuqi, si i tillë është edhe i mangët, edhe kontradiktor e edhe i pazbatueshëm në tërësinë e tij.

Mangësitë, inkonsekuencat dhe lëshimet e këtij legjislacioni janë të shumta dhe të nduarnduarta. Për shkak të kohës së kufizuar

nuk do të ndalemi për të elaboruar detajisht ato mangësi dhe lëshime. Mirëpo është e domosdoshme që së paku të përmenden disa nga më kryesoret.

Që në fillim vlen të theksohet struktura legjislative dhe nomoteknike e Ligjit për zgjedhjet lokale. Ky është një ligj pa një strukturë të mvetësishme, të natyrshme, vetëfunksionuse dhe normale. Në fakt ligji në fjalë është skajshmërisht dhe panatyrshëm i interkonektuar me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme. Kjo strukturë invalide dhe e pazakonshme nga aspekti i mangësive e bën këtë ligj jo vetëm problematik, por edhe të paaplikueshëm.

Ligji për zgjedhjet e përgjithshme i Kosovës është një tjetër ligj shumë i rëndësishëm që do të duhej të siguronte ligjshmëri të plotë përkitazi me realizimin e proceseve elektorale që organizohen te ne.

Mangësitë dhe lëshimet në këtë ligj janë të shumta dhe serioze. Disa nga inkonsekuencat dhe mangësitë e këtij ligji janë bërë brengë e përgjithshme dhe e përbashkët e gjithë opinionit publik gjatë zgjedhjeve të fundit të përgjithshme të vitit 2010.

Zgjidhjet joadekuate të këtij ligji kanë reflektuar pasoja dhe probleme serioze në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, komisioneve komunale zgjedhore, PZAP-it, Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Ligji për financimin e subjekteve politike është një ligj tjetër në kuadër të legjislacionit elektoral të Republikës së Kosovës, i cili po ashtu veçohet me lëshime, gabime dhe mangësi të shumta e zgjidhje irracionale. Njëra nga zgjidhjet më joadekuate që po krijon pasoja dhe probleme në zbatimin e tij në praktikë është padyshim çështja e burimeve dhe transparencës së financimit të subjekteve politike; veçmas para dhe gjatë fushatave elektorale. Një tjetër zgjidhje e papërshtatshme, e pazbatueshme dhe me shumë rrjedhoja në praktikë është çështja e kompetencës së KQZ-së që të merret me menagjimin e mjeteve financiare të subjekteve politike parlamentare, të cilat mjete, ju ndahen atyre nga një fond i caktuar i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pikërisht mungesa e vullnetit politik të klasës politike me influencë ka krijuar vonesat e mëdha dhe të paarsyeshme në procesin e miratimit të këtij ligji të veçantë, me peshë shoqërore dhe politike të ne.

Nuk mund të kalohet lehtë e shpejt pa vlerësuar këtu jo vetëm vulnerabilitetin e legjislacionit pozitiv elektoral nga aspekti i cilësisë, por edhe nga ai i sasisë. Thuhet kështu, sepse republikës së Kosovës i

duhen edhe disa ligje dhe akte të tjera nënligjore dukshëm më përmbajtësore, më korrekte, më humane dhe më të avancuara në aspektin shumëdimensional e formal.

Ky legjislacion yni jo vetëm që është i mangët dhe gati i pazbatueshëm, por është edhe i shkapërderdhur, jokoheziv dhe jokonsistent sa i përket akteve ligjore e nënligjore me njëri-tjetrin.

Cila është zgjidhja adekuate efikase dhe racionale e problemit sa i përket legjislacionit elektoral te ne?

Sigurisht reformimi, që do të nënkuptonte domosdoshmërisht kodifikimin urgjent dhe immanent të tij.

Pikërisht si pasojë e një vetëdije të pjekur publike lidhur me përmasat brengosëse të dobësive dhe mangësive të legjislacionit elektoral, vetëdije kjo që shkon e rritet dhe piqet deri në kërkesë imanente dhe emergjente, sidomos pas zgjedhjeve të fundit nacionale të vitit 2010. Tashmë është formuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës një komision i posaçëm i tij për reformimin (lexo kodifikimin) e legjislacionit ekzistues elektoral në Republikën e Kosovës.

Reformimi deri në kodifikim të plotë e cilësor të legjislacionit elektoral te ne nuk do të duhej të ishte as improvizues dhe as surrogativ. Përkundrazi, ai do të duhej të ishte një proces autentik, gjithëpërfshirës, proces që do të debatohej nga të gjithë faktorët dhe aktorët relevantë shoqëror të këtij vendi.

Legjislacioni elektoral nuk mund të trajtohet e as të reformohet në mënyrë të izoluar nga sistemi elektoral dhe nga procesi elektoral. Përkundrazi, që të tre këta faktorë janë gama, komponenti apo më mirë thenë pjesë përbërëse e një tërësie - TË DREJTËS ELEKTORALE. Pikërisht për këtë arsye që të tri këto komponente, që u përmenden më lart në procesin vijues të reformimit si nga komisioni përkatës i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ashtu edhe nga mbarë shoqëria jonë do të duhej analizuar dhe trajtuar gjithanshmërisht e në mënyrë substanciale. Ky veprim dhe kjo detyrë duhet kryer pikërisht në të mirë të një legjislacioni dhe të një sistemi stabil, adekuat me rrethanat, kushtet dhe specifikat e Kosovës, të cilat do të ndihmonin dhe ndikonin shumë dhe qenësisht në avancimin e vetëdijës së përgjithshme dhe të demokracisë në vendin tonë.

Ja në vazhdim disa nga hapat dhe veprimet e nevojshme që do të duhej ndërmarrë në drejtim të reformimit-kodifikimit të plotë e të

qëndrueshem të legjislacionit, sistemit dhe procesit elektoral - me një fjalë të së drejtës elektorale të ne.

Hapi i parë, përmbajtësor dhe primar, që aktualisht do të duhej ndërmarrë në procesin e reformimit elektoral do të ishte rishikimi substancial dhe gjithëpërfshires i legjislacionit primar dhe atij sekondar, duke eliminuar të gjitha kontradiktat, mangësitë dhe paqartësitë ekzistuese të korpusit legjislativ për ta bërë kodifikimin e tij në një vend, pra:

- në një kod zgjedhor të Republikës së Kosovës;
- do të duhej të mosaplikohej institucioni i votimit me kusht;
- do të duhej bërë spastrimi, përditësimi dhe kompletimi i listës së votuesve; pastaj:
  - depolitizimi, profesionalizimi dhe pavarësimi i plotë i institucioneve të pavarura elektorale: KQZ; PZAP, po edhe i organeve gjyqësore e të drejtësisë gjithandaj;
  - ashpërsimi i sanksioneve ligjore, rrjedhimisht avancimi dhe forcimi i sundimit të rendit e të ligjit - shtetit të së drejtës;
  - angazhimi gjithëinstitucional dhe shoqëror në sensibilizimin dhe vetëdijësimin e qytetarëve përkitazi me rëndësinë e zgjedhjeve, ushtrimit të të drejtës së shenjtë të votës dhe të zbatimit të ligjit;
  - ngritja dhe rritja e ndjeshme e zotimeve dhe përgjegjësisë së subjekteve politike dhe ngritja e nivelit të bashkëpunimit të vazhdueshëm (jo vetëm gjatë fushatave elektorale) të tyre me elektoratin, si dhe me institucionet shtetërore;
  - rritja e kulturës dhe e vullnetit politik të partive politike për t'ua nënshtruar interesat, synimet dhe qëllimet e tyre politike e partiake interesave madhore të vendit, respektivisht të qytetarit tonë;
  - i korporimi më intensiv, më aktiv dhe i vazhdueshëm i shoqërisë civile në procesin e reformimit elektoral dhe gjithëshoqëror;
  - pozita, ingerencat dhe integriteti institucional i kQZ-së dhe i organizmave të tjerë zgjedhor duhet të përforcohet, garnatohet dhe të mos cenohet në të ardhmen sikurse deri më tani dhe tani;
  - rregullimi më i avancuar i mekanizmave ankimore dhe vendimmarrëse;
  - të analizohet mirë dhe shkencërisht sistemi shumëzonal, përparsitë dhe mangësitë e tij;

- të studiohet dhe elaborohet në mënyrë analitike, sintetike dhe me akribi shkencore sistemi ekzistues elektoral-proporcional e me lista të hapura, të mbyllura apo sistemi i kombinuar;

- pragu zgjedhor të zbritet nga 5% në 3% p.sh. dhe të eliminohet diskriminimi pozitiv si favorizim dhe diskriminimi i partive të vogla shqiptare të Kosovës, nga ana tjetër;

- komisionarët dhe menaxherët nëpër vendvotime dhe nëpër qendra votuese do të duhej të mos ishin të politizuar dhe as reprezentë të subjekteve të caktuara politike, përkatësisht partiake;

- të analizohet mundësia e riorganizimit të KQZ-së, depolitizimit të tij, rrjedhimisht strukturimit të tij adekuat me rrethanat dhe kushtet tona zhvillimore si një organ a institucion plotësisht i pavarur dhe jopolitik;

- të votohet sipas parimit një qytetar një votë e jo për partinë dhe për 5 kandidatë (siç ishte në zgjedhjet e fundit ose një votë për partinë dhe deri në 10 kandidatë, siç ishte në zgjedhjet nacionale të vitit 2007);

- të rishikohen proporcionet e vendeve të rezervuara e të garantuara për minoritetet, sidomos për minoritetin serb;

- të studiohen, analizohen dhe sintetizohen sistemet potenciale elektorale me lista të mbyllura apo të hapura; të kemi sistem elektorale proporcional me lista të hapura a të mbyllura, apo sistem të kombinuar, etj.

Hapi i parë përmbajtësor dhe primar, që aktualisht do të duhej ndërmarrë në procesin e reformimit elektoral do të ishte rishikimi substancial dhe gjithëpërfshirës i legjislacionit primar dhe atij sekondar, duke eliminuar të gjitha kontradiktat, mangësitë dhe paqartësitë ekzistuese të korpusit legjislativ për ta bërë kodifikimin e tij në një vend - në një kod zgjedhor të Republikës së Kosovës;

- do të duhej të mosaplikohej institucioni i votimit me kusht;

- do të duhej bërë spastrimi, përditësimi dhe kompletimi i listës së votuesve; pastaj:

- depolitizimi, profesionalizimi dhe pavarësimi i plotë i institucioneve të pavarura elektorale: KQZ; PZAP, po edhe i organeve gjyqësore e të drejtësisë gjithandej;

- ashpërsimi i sanksioneve ligjore, rrjedhimisht avancimi dhe forcimi i sundimit të rendit e të ligjit - shtetit të së drejtës;

- angazhimi gjithëinstitucional dhe shoqëror në sensibilizimin dhe vetëdijësimin e qytetarëve përkitazi me rëndësinë e zgjedhjeve, ushtrimit të së drejtës së shenjtë të votës dhe të zbatimit të ligjit;

- ngritja dhe rritja e ndjeshme e zotimeve dhe përgjegjësisë së subjekteve politike dhe ngritja e nivelit të bashkëpunimit të vazhdueshëm (jo vetëm gjatë fushatave elektorale) të tyre me elektoratin, si dhe me institucionet shtetërore;

- rritja e kulturës dhe e vullnetit politik të partive politike për t'ua nënshtruar interesat, synimet dhe qëllimet e tyre politike e partiake interesave madhore të vendit, respektivisht të qytetarit tonë;

- i korporimi më intensiv, më aktiv dhe i vazhdueshëm i shoqërisë civile në procesin e reformimit elektorale dhe gjithëshoqëror;

- pozita, ingerencat dhe integriteti institucional i KQZ-së e organizmave të tjerë zgjedhor të përforcohet, gamatohet dhe të mos cenohet në të ardhmën sikurse deri më tani dhe tani;

- rregullimi më i avancuar i mekanizmave ankimore dhe vendimmarrëse;

- të analizohet mirë dhe shkencërisht sistemi shumëzonal; përparsitë dhe mangësitë e tij;

- të studiohet dhe elaborohet në mënyrë analitike, sintetike dhe me akribi shkencore sistemi ekzistues elektorale-proporcional e me lista të hapura, të mbyllura apo sistemi i kombinuar;

- pragu zgjedhor të zbritet nga 5% në 3% p.sh., dhe të eliminohet diskriminimi pozitiv si favorizim dhe diskriminim i partive të vogla shqiptare të Kosovës, nga ana tjetër;

- komisionarët dhe menagjerët nëpër vendvotime dhe nëpër qendra votuese do të duhej të mos ishin të politizuar dhe as reprezentë të subjekteve të caktuara politike, përkatësisht partiake;

- të analizohet mundësia e riorganizimit të KQZ-së, depolitizimit të tij, rrjedhimisht strukturimit të tij adekuat me rrethanat dhe kushtet tona zhvillimore si një organ a institucion plotësisht i pavarur dhe jopolitik;

- të votohet sipas parimit një qytetar një votë e jo për partinë dhe për 5 kandidatë (siç ishte në zgjedhjet e fundit ose një votë për partinë dhe deri në 10 kandidatë, siç ishte në zgjedhjet nacionale të vitit 2007);

- të rishikohen proporcionet e vendeve të rezervuara e të garantuara për minoritetet, sidomos për minoritetin serb;

- të studiohen, analizohen dhe sintetizohen sistemet potenciale elektorale, me lista të mbyllura apo të hapura; të kemi sistem elektorale proporcional, me lista të hapura a të mbyllura, apo sistem të kombinuar, etj.

---

## **Rezyme**

Çështjet elektorale, sistemet elektorale dhe proceset elektorale padyshim që janë tepër të rëndësishme për zhvillimin e shëndosh politik dhe demokratik të një vendi - në rastin tonë të Kosovës. Legjislacioni elektoral sigurisht që është hallka më ndërvarëse dhe më ndërvepruese, që lidhet edhe me sukseset dhe rezultatet elektorale të një procesi elektoral, por edhe me mbarëvajtjen e rrjedhave dhe lëvizjeve demokratike dhe politike brendapërbrenda një shteti të caktuar në botë.

Për të siguruar këtë sukses dhe këto rezultate duhet bërë shumë më tepër se deri më tani në mobilizimin gjithëshoqëror të qytetarëve, të institucioneve dhe të shoqërisë civile në tërësi. Duhet punuar shumë e vazhdimisht në ngritjen dhe forcimin deri në kultivim të vetëdijes së lartë qytetare dhe politike, e cila vetëdije dhe nivel i saj nënkupton mosabuzimin me proceset elektorale, me votën e shenjtë të qytetarit dhe me respektimin e orientimeve, bindjeve dhe përcaktimeve të qytetarëve në proceset elektorale, në relacion me partitë politike konkrete. Respektimi i parimeve elektorale, dispozitave elektorale dhe votës së lirë të qytetarit, respektivisht përcaktimit të tij të lirë për të votuar për kandidatët dhe subjektet politike të preferuara paraqet në të vërtetë një kontribut me vlerë në avancimin e mëtejshëm dinamik dhe rezultadhenës të gamës dhe përmasave të demokracisë, lirisë dhe kategorive të tjera relevante që kanë të bëjnë edhe me të drejtat dhe liritë elementare të familjës si tërësi dhe të qytetarëve të vendit tonë.

Legjislacioni elektoral human, i studiuar dhe i analizuar mirë, drejt dhe me kompetencë substanciale dhe të lartë humane, sigurisht që do të kontribuonte shumë në kthimin e besimit të elektoratit në institucionin e votës së shenjtë e të paprekshme të secilit qytetar, por edhe në krijimin, forcimin dhe avancimin e institucioneve shtetërore të mirëfillta, demokratike dhe perspektive të shtetit të së drejtës - të qeverisjës së mirë, joabuzuese, stabile dhe me primesa të qëndrueshme drejt ardhmërisë së ndritur për të gjithë. Kjo më tutje do të thotë sigurim i një infrastrukture të pranueshme (për shumicën dërmuese të elektoratit), të qëndrueshme, kredibile dhe perspektive të institucioneve demokratike të një vendi.

**Referencat**

John Stuart Mill: Consideration ou Representative Government, Indianapolis, 1958.

Giovani Sartori, Demokracia ç'është kjo? në Prof. dr. Radovan Ratkonjic: Demokratija, Podgorica, 2004.

Hamilton Madison, JAY: The Federalist Papers, Nr. 51.

Tocqueville, De la Democratie en Amerique, Libri I-rë.

Alex de Tocqueville, Oeuvres Completes: Voyages en Sicilie et oux Etats- Unis, Paris, Galimard, 1957, vellimi I, libri I.

Milan Matic: Izbori.

James Bryce, The American Commonwealth, New York, Macmillan, 1920, libri II.

D. Nolen: E drejta elektorale dhe sistemi electoral.

Veselin Paviçeviq, Izborni sistem i izbori u Crnoj Gori, 1990-1996.

Parsons, 1969; Nordlinger, 1968.

Akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore të Republikës së Kosovës.

Akademik Mark Krasniqi

## KOSOVA NË VEPRATË AUTORËVE SERBË

Literatura për Kosovën e autorëve serbë e malazezë është shumë voluminoze, kështu që për shqyrtimin e saj do të nevojitet një kohë e gjatë. Me këtë rast mund të shqyrtohet në vija të shkurtëra vetëm një numër i vogël i tyre, kryesisht nga aspekti i gjeografisë shoqërore (antropogjeografisë), të cilën e ka krijuar akademiku dhe politikani i njohur serb Jovan Cvijiqi (1864-1929). Madje kjo degë shkencore mban edhe emrin e tij si “Shkolla e Cvijiqit”, të cilën e kanë vazhduar gjenerata të tëra si metodologji shkencore. Cvijiqi ka qenë njeriu më i zellshëm dhe më autoritativ i ideologjisë serbomadhe të minitrit serb Ilija Garashanin të vitit 1844, të formuluar e të njohur si Naçertanija (Program). Poenta kryesore e Programit të Garashaninit është politika serbomadhe, lufta për krijimin e Serbisë së Madhe, të Perandorisë jetëshkurtër të car Dushanit të shekullit 14. Kjo ideologji ekspansioniste serbe gjatë shekujve ka qenë në programin e të gjitha institucioneve të shkencave shoqërore dhe të politikës së qeverisë serbe, siç janë historia, gjeografia, etnologjia, pedagogjia, sociologjia, demografia etj. Kisha ortodokse serbe gjithmonë ka luajtur rol të rëndësishëm në propagandën dhe zbatimin e politikës ekspansioniste serbe antishqiptare.

Serbia i ka zgjeruar kufijtë e vet shtetëror drejt jugut që nga Kongresi famkeq i Berlinit më 1878 e deri më sot vetëm duke okupuar trojet etnike shqiptare. Kështu, për shëmbull, ajo ka okupuar më 1877 Sanxhakun e Nishit, Toplicën e sotme ku kanë qenë më se 700 venbanime shqiptare dhe sot nuk gjendet asnjë shtëpi e tyre, asnjë familje, asnjë xhami, bile asnjë varr shqiptar. Madje në atë kohë vetë sundimtari i Serbisë Millan Obrenoviq, me krenari ka deklaruar: “Ne arritëm që me shpatë e zjarr ta shndërrojmë Toplicën, që deri dje ishte thjesht shqiptare, në një trevë thjesht serbe!” Këto ndryshime të përgjakura i ka studiuar dhe vërtetuar edhe profesor dr. Sabit Uka në bazë të dokumenteve arkivore dhe të literaturës përkatëse turke, serbe, shqiptare e të tjera. Por gjithashtu edhe nga dëshmitë gojore të familjeve shqiptare me prejardhje nga Toplica, nga muhaxhirët, të cilët edhe sot mbajnë mbiemrin e fshatrave dhe qyteteve të tyre të vendbanimeve në Toplicë, ku kanë jetuar të partë e tyre, të përndjekur e të masakruar nga ushtria serbe.

Kjo politikë serbomadhe është prezente edhe sot e kësaj dite në trurin dhe praktikën e çdo qeverie të Serbisë dhe të kishës ortodokse serbe. Kjo politikë gjatë shekujve, por sidomos në shekullin 19 e këndej, është preokupim dhe detyrë e shkencës, e arsimit dhe e kishës ortodokse serbe. Këtë politikë serbomadhe antishqiptare Serbia e ka zbatuar dhe përpiket ta zbatojë dita-ditës ndaj Kosovës, të cilën e paraqet para faktorit ndërkombëtar, gjoja në mënyrë shkencore, se Kosova është trevë ku është formuar shteti dhe kultura serbe. Kjo është një gënjeshtër ordinere, të cilën e ka demantuar në kohën e fundit me argumente arkivore edhe historiani i njohur anglez Noel Malkolm në librin e tij “Kosova – një histori e shkurtër”, botuar anglisht dhe përkthyer edhe në gjuhën shqipe.

Autorët serbë, politika dhe kisha ortodokse serbe përpiqen që në bazë të faktit që edhe sot janë në Kosovë disa kisha ortodokse të mesjetës, t’i marrin si argument kryesor për autoktoninë (lashtësinë) e serbëve në Kosovë dhe për ta përvetësuar këtë trevë historikisht e etnikisht gjithmonë shqiptare. Por këto kisha mesjetare nuk kanë qenë kurrë serbe, sepse ato janë ndërtuar në kohën kur Bizanti ka sunduar gjatë kohë edhe në këtë pjesë të Ballkanit, kur serbët kanë qenë larg Kosovës si popull rezident. Madje kisha dhe pushtetarët serbë kanë përvetësuar edhe shumë kisha katolike gjatë shekujve, bile edhe gjatë sundimit të Perandorisë Osmane në këto anë, kur kisha serbe ka qenë e autorizuar nga vetë sulltani që të “administrojë besimtarët kristianë në këto vise”. Në pllajën e Kosovës në atë kohë një pjesë e madhe e shqiptarëve ka qenë e besimit ortodoks, të cilët me presionin e kishës serbe të gjithë janë sllavizuar. Prandaj edhe autori serbomadh Tatomir Vukanović ka botuar në Prishtinë librin e tij “Kosovo – druga srpska Sveta Gora” (“Kosova – i dyti Mal i Shenjtë serb”). Mali i Shenjtë është një manastir i njohur ortodoks në Greqi, brenda të cilit shumë sundimtarë të huajë kanë ndërtuar nga një kapelë të vogël. Kishat ortodokse mesjetare në Kosovë i kanë ruajtur gjatë shekujve shqiptarët. Madje nga aspekti fetar ato kisha kanë qenë edhe të shqiptarëve ortodoksë, tashmë të parët e tyre janë sllavizuar me dhunë. Priftërinjtë katolikë shqiptarë e të huaj i janë ankuar me shkrim papës se shqiptarët katolikë në Ballkan janë më në hall nga kisha ortodokse serbe se nga pushteti turk. Argumente për okupimin e kishave katolike shqiptare nga kisha e pushteti serb ka shumë, ndër të cilat edhe libri i doktoraturës së Dom Gasper Gjinit, botuar në Zagreb më 1986, por edhe në librin e autorit malazez, Savo Bërković, “Etnogenezofobija, prilog kritici velikosrpstva”. Ky autor

shkruan: "Car Duhani (shekulli 14, M.K.) me ligj e ka ndaluar katolicizmin dhe e ka përndjekur e shkatërruar edhe fizikisht..." Deri në mesin e shekullit XIV u zhduk një numër i madh i kishave të mëdha e të vogla të benediktinve, të cilat ndodheshin në numër të madh sidomos në trevat e Bokës së Kotorrit. "Benediktinët janë priftërinj katolikë. Edhe Vito Kuçi, prift katolik shqiptar, ka qenë nga Kotorri, i cili, siç dihet, ka projektuar dhe ka mbikëqyrur zbatimin e projektit gjatë ndërtimit të kishës së Deçanit. Këtë të vërtetë autorët serbë dhe autoritetet kishtarë serbe nuk e përmendin, me përjashtim të ndonjë rasti shumë të rrallë.

Shkenca, politika dhe kisha serbe përpiqen ta bindin faktorin ndërkombëtar të vendosjes së disa manastire (kisha) ortodokse mesjetare që janë në Kosovë dëshmojnë për autoktoninë e serbëve në këtë pjesë të Ballkanit. Por faktet historike tregojnë të kundërtën. Serbët për herë të parë përmenden në shekullin 9 në Mal të Zi, kurse në Kosovë shumë më vonë, aty kah fundi i shekullit 11. Madje jo si banorë të përhershëm, por vetëm si pushtues në krye me Stevan Nemanjiqin, në luftë me Bizantin në një pjese të territorit iliro-shqiptar të Kosovës. Këto kisha ortodokse mesjetare nuk i kanë ndërtuar serbët, ato janë të kohës së Bizantit, kur serbë nuk ka pasur në këto vise të Dardanisë shqiptare. Këtë e thotë edhe historiani i njohur çek, miku i serbëve, Konstantin Jireček. Kështu ka shkruar, madje edhe më qartë, historiani serb Pero Slijepçeviq më 1934. Këto kisha ortodokse bizantine në Kosovë dhe shumë kisha të tjera katolike shqiptare të mesjetës i kanë uzurpuar serbët, për çka ka protestuar edhe Papa i Romës në mesjetë. Madje në kohën e ardhjes së kolonizatorëve serbë, si paganë nga viset tej Karpateve, në Ballkan ka jetuar popullsia ilire-shqiptare, kështu që serbët ardhacakë në Kosovë kanë qenë vetëm uzurpatorë të trojeve tona e jo popull autokton. Edhe vetë Cvijiq në veprën e tij monumentale "Balkansko poluostrvo" thotë: "Me invadimin e sllavëve në Ballkan, fiset ilire janë strehuar në viset malore e janë bërë barinj".

Nga ana tjetër, socialisti serb Dimitrije Tucoviq në librin e tij "Serbia dhe Shqipëria" dënon ashpër politikën kriminale dhe gjenocidin e ushtrisë serbe ndaj popullit shqiptar në Kosovë e Shqipëri më 1913. Historiani serb, dr. Millovan Obradoviq, në librin e tij "Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë 1918-1941", me argumente konkrete tregon numrin dhe emrat e kolonistëve serbo-malazezë, të cilët në këtë periudhë i ka vendosur shteti në toka të shqiptarëve për të zvogëluar përqindjen e tyre në Kosovë, nga e cila i

ka dëbuar me qindra-mijëra në Turqi. Por autorë të tillë objektivë serbë janë raste shumë të rralla.

Trajtimet e Kosovës në veprat e autorëve serbo-malazezë e maqedonë të gjitha janë në shërbim të politikës antishqiptare, ekspansioniste, serbomadhe. Nxënësit e Cvijiqit, i cili ka qenë profesor dhe rektor i universitetit të Beogradit, kanë vazhduar me përkushtim punën e tij shkencore serbomadhe. Nga këta po përmend vetëm disa gjeografë, etnologë dhe historianë, siç janë akademiku Vlladan Gjorgjeviq, i cili shkruan se shqiptarët ende kanë bishtin e majmunit, kështu që janë në shkallën më të ulët të shoqërisë njerëzore, janë njerëz primitivë, të cilët vetëm shteti serb mund t'i edukojë e civilizojë. Historiani e akademiku Vasa Çubrilloviq ka shkruar dy elaborate për qeverinë jugosllave se duhet të merren masa drastike për t'i dëbuar shqiptarët nga Jugslavia, para së gjithash nga Kosova e Maqedonia. Njërën elaborat, me 1937, ia ka dorëzuar qeverisë monarkiste, tjetrin më 1944 qeverisë komuniste të Jugosllavisë. Të dyja këto elaborate janë zbatuar duke dëbuar me qindra-mijëra shqiptarë në Turqi dhe duke vendosur në tokat e uzurpuara kolonë serbë e malazezë, me qëllim të pastrimit etnik të Kosovës, kurse, nga ana tjetër, duke vrarë me dhjetëra-mijëra shqiptarë të pafajshëm.

Pasardhësit e Cvijiqit kanë vazhduar me përkushtim punën e tyre kuazishkencore në frymën e politikës serbomadhe në lidhje me Kosovën, siç kanë qenë Atanasije Urosheviq, sidomos me librin e tij “Kosovo” (1956); Milenko Filipoviq më librin “Has pod Pashtrikom”, Jovan Trifunski me disa punime të tij për shqiptarët e Maqedonisë e të Kosovës, sidomos për Kaçanikun, Tatomir Vukanoviq për Drenicën, Millovan Radovanoviq për Podgurin e Prizrenit, Sreçko Nikoliq për Siriniqin, Milenko Lutovac për Gorën, Opojen, për Koloshinin e Ibrit (Zubin Potokun, etj.) dhe për “Metohinë”, të gjitha në frymën ekspansioniste, shoviniste, antishqiptare e antishkencore; pastaj Vladimir Stojançeviq, Ruzha Petroviq, Marina Blagojeviq, Milosh Macura, Dimitrije Bogdanoviq, Kosovka Ristiq dhe shumë të tjerë. Të gjithë këta autorë serbo-malazezë e maqedonë, në botimet e veprave të tyre, gjoja shkencore, përpiqen të shpifin autoktoninë serbo-sllave në trojet iliro-shqiptare. Ata shkruajnë se me invadimin e fiseve sllave në Ballkan në shekullin VI e VII, në këto vise, sidomos në Kosovë e në Maqedoni, kanë gjetur vetëm popullsi të romanizuar dhe baritore e jo ilire. Por historia e këtyre trojeve nuk fillon nga shekulli VI ose VII. Ilirët shqiptarë kanë qenë gjithmonë, dhe para të

gjithëve, popullsi e përhershme e këtyre trojeve siç dihet nga historia, kurse popullsi “baritore”, siç thotë edhe vetë Cvijiqi, “kanë qenë vetëm fiset ilire të strehuara në malet shqiptare nga invazioni sllav”.

Shumë autorë serbë këmbëngulin në një të pavërtetë se gjoja shteti serb është formuar në Kosovë. Këtë trillim të politikës dhe shkencës serbe e kanë demantuar me fakte historike shumë autorë të huaj. Për çudi, këtë e ka bërë edhe autori serb, historiani Dimitrije Bogdanoviç, i cili në librin e tij “Knjiga o Kosovu”, megjithëse i shkruar në frymën shoviniste të ideologjisë serbomadhe antishqiptare, thotë: “Shteti i popullit serb është formuar nga grupacionet e vogla të fiseve dhe të principatave të njohura të shekullit IX e XI në trevat e Duklës (Zetës), të Travunisë dhe të Zahumles, që nga Neretva deri në Dri”. Pra, jo në Kosovë!

Kështu, pretendimet serbe për të sunduar sot Kosovën, duke u bazuar gjoja në të “drejtën historike” janë vetëm ëndrra mitologjike mesjetare, pa kurrfarë argumenti shkencor dhe madje pa aspak logjikë të shëndoshë.

Serbia e ka humbur Kosovën më 1389, me humbjen e Betejës së Kosovës, pra para 622 vjetësh. Sipas logjikës serbe, në përgjithësi, për ta okupuar përsëri Kosovën në bazë të “të drejtave historike”, sot Turqia do të kishte shumë më të drejtë ta okupoje Serbinë, të cilën e ka okupuar e sunduar gjatë 523 vjetëve dhe e ka humbur më 1912, pra vetëm para 99 vjetësh. Madje edhe shqiptarët, në bazë kësaj logjike historike serbe, do të kishin plot të drejtë ta kërkojnë Toplicën në Serbi, ku kanë qenë më se 700 venbanime shqiptare deri më 1877, kur e kanë okupuar serbët, siç u tha më parë, dhe e kanë humbur para 134 viteve e jo para 622 vitesh, siç e kanë humbur serbët Kosovën shqiptare. Por e kaluara shekullore le të mbetet në faqet e librave, në arkiva e muzeume, por jo si argument për të zgjidhur problemet ndëretnike e ndërshtetërore sot në shekullin XXI.

Megjithatë, autorët serbomalazezë përpiqen edhe sot të sanksionojnë një të pavërtetë të madhe se gjoja shqiptarët kanë zbritur në Kosovë e në Maqedoni nga malet shqiptare vetëm pas luftës austro-turke, e cila u zhvillua në këto troje më 1690, kurse, sipas trillimeve të tyre shqiptarët më parë nuk kanë ekzistuar fare në këto vise. Por këtë gënjeshtër të përsëritur me qindra herë e kanë demaskuar me fakte të pamohuara historianët, arkeologët, etnologët e të tjerët, madje në kohën e fundit edhe historiani i njohur anglez, Noel Mallkolm në librin e tij “Kosova – një histori e shkurtër”. Etnologët

dhe hulumtuesit e ndryshëm shqiptarë e të huaj, studiues të traditës shqiptare në popullsinë e Malësisë së Shkodrës dhe të Gjakovës, kur i kanë pyetur malësorët e moshuar - nga keni ardhur në këto male?, të gjithë janë përgjigjur se të parët e tyre kanë ardhur këtu nga Kosova e Maqedonia, për të shpëtuar jetën nga okupatorët serbo-sllavë e turq të këtyre viseve shqiptare. Nga ana tjetër dihet se në luftën e përmendur austro-turke të vitit 1690 kanë marrë pjesë në anën austriake më se 12.000 shqiptarë katolikë e myslimanë nga Kosova, Maqedonia, Sanxhaku i Novi Pazarit dhe i viseve të tjera shqiptare. Në krye të kësaj ushtrie vullnetare ka qenë arqipeshkvi dhe shkrimtari i njohur shqiptar, Pjetër Bogdani. Historiani N. Mallkollm në bazë të dokumenteve arkivore githashtu hedh poshtë trillimet e autorëve serbë gjoja për dyndjen e madhe të serbëve nga Kosova në krye me patrikun Arsenije Çarnojeviq, pas dështimit të austriakëve në luftën kundër turqve më 1690. Historiani Mallkollm shkruan se nuk ka pasur kurrfarë dyndjesh të madhe të serbëve nga Kosova në krye me patrikun Çarnojeviq, i cili është largua nga Kosova vetëm me disa njerëz dhe me disa kuaj të ngarkuar me pasurinë e manastirit të Pejës. Madje atë e kanë plaçkitur serbët porsa ka arritur në Serbi.

Akademia Serbe e Shkencave ka organizuar një tubim shkencor ndërkombëtar më 16 e 18 mars 2004 në Beograd, ku kanë marrë pjesë 50 autorë serbë e të huaj me elabore të disiplinave të ndryshme në kuadër të temës “Kosova e Rrafshi i Dukagjinit - e kaluara – e tashmja - e ardhmja”. Të gjitha kumtesat e tyre janë shkruar në frymën e politikës ekspansioniste serbe dhe janë botuar në librin voluminoz prej 500 faqesh në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbe. Libri anglisht është shpërndar në katër anët e botës për të dezinformuar opinionin e gjerë me shpifje, falsifikate e gënjeshtër të ndryshme se Serbia ka të drejtë ta sundojë Kosovën, kurse shqiptarët, gjoja ardhacakë dhe popull destruktiv fanatik mysliman, nuk kanë të drejtë të formojnë shtet të tyre në këto “troje të shenjta serbe”. Siç dihet dhe siç e thamë edhe më parë, këtë politikë ekspansioniste serbe e përkrah fuqimisht kisha ortodokse serbe. Po këtë qëndrim ndaj shqiptarëve në Çamëri e përgjithësisht në Greqi e ka edhe kisha ortodokse greke dhe pushteti grek, duke dëbuar dhe masakruar popullsinë shqiptare dhe duke e greqizuar me masa të dhunshme. Cvijiqi shkruan në veprën e tij kapitale “Balkansko Poluostrvo” (“Siujdhesa e Ballkanit”) kësajsoji: “Popullit serb ka arritur që Kishës ortodokse serbe t’ia imponojë nacionalizmin serb dhe fenë e re të Obiliqit, e cila lufton për ringjalljen e Perandorisë së car Dushanit” Kështu, sipas Cvijiqit,

serbët nuk kanë fe monoteiste kristiane, nuk kanë Zot myslimano-kristian, por kanë fenë nacionaliste të Millosh Obiliqit, të një atentatori ordiner nga mesjeta më 1389, i cili, sipas disa historianëve, mund të jetë vetëm një legjendë e shpikur politike e asgjë tjetër.

Gjenocidi serb më 1998/99 ka qenë aksioni i fundit për ta spastruar Kosovën nga shqiptarët. Kurse, nga ana tjetër, politika dhe shkencë serbe vazhdon të ndjekë rrugën e gënjeshtrove për Kosovën dhe për shqiptarët, sipas aksiomës së ish-kryetarit të Jugosllavisë, akademik Dobrica Qosiqit, se “gënjeshtro për serbin është detyrë e patriotizmit të tij” (!) Shumë autorë serbë letrarë, shkencorë, fetarë e politikë i përmbahën kësaj aksiome të shkrimtarit dhe shkencëtarit të njohur serb, akademikut Dobrica Qosiqit. Ata mendojnë, siç shkruan autori malazez Savo Bërković, se “Të pavertetat duhet të përsëritën sa më shpesh, duhet të popullarizohen në opinion të përgjithshëm, të afirmohen për t’u bërë të vërteta” Kështu shkruan ky autor malazez duke kritikuar politikën ekstreme nacionaliste serbomadhe.

Autorët serbo-sllavë, siç u pa pjesërisht edhe në këtë paraqitje të shkurtër, me shkrimet e tyre për Kosovën dhe për shqiptarët në përgjithësi kanë krijuar gjatë shekujve një atmosferë mostolerance, mosbesimi, mosdurimi, një atmosferë konfliktuoze dhe armiqësore mes popullit shqiptar dhe popujve fqinj të tyre, duke qenë kështu në shërbim të politikës ekspansioniste të qarqeve politike dhe kishtare të Serbisë. Në këtë mënyrë shkencë e letërsia dhe mjetet e informimit serbe e kanë indoktrinuar mbarë popullin serbo-sllav me një ideologji të rrezikshme të nacionalizmit dhe ortodoksizmit ekstrem, me urrejtje shtazarake ndaj shqiptarëve dhe, më në fund, me konflikte të përgjakshme, kur shqiptarët, si popull i vogël dhe paqësor, kanë qenë kurban i gjenocidit serb ndaj tyre.

Madje edhe në marsin e vitit 2011, sipas lajmeve të mjeteve të informimit, Akademia e Shkencave e Serbisë, bashkë me autoritetet shtetërore, kishtare, politike e kulturore serbe kanë mbajtur në Beograd një kuvend të rëndësishëm, i cili ka prurë një memorandum me të cilin u vëhet si detyrë obligative dhe urgjente organeve qeveritare, politike, kishtare, shoqërore e kulturore që me të gjitha mjetet e nevojshme të veprohet për të krijuar Serbinë e Madhe me aneksimin e të gjitha “trojeve të shenjta serbe” në kuadër të saj – Republikën Serbe, Bosnjën e Hercegovinën, Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë dhe një pjesë të Kroacisë. Këtë kuvend thonë se e kanë mbajtur në diskrecion të madh. Megjithatë, gazeta e Sarajevës

“Slobodna Bosna”, dt. 24 mars 2011, arriti ta zbulojë e para këtë sekret. Rolin kryesor në këtë kuvend të politikës ekspansioniste të Serbisë thuhet se e ka pasur akademik Dobrica Qosiqi. Ndërkaq, autori i “Librit për Qosiqin”, një avokat i njohur i Beogradit, Dragolub Todoroviq, në këtë vepër të tij shkruan: “Mbas demonstratave në Kosovë në prill 1981, Qosiqi në mënyrë intensive, gati krejtësisht haptas, i ka nxitur serbët e Kosovës që të vijnë në Beograd e të protestojnë, të shkruajnë peticione, të organizohen, të krijojnë rrëmujë, çrregullim, të shkaktojnë përlëshje me shqiptarët etj. Fjalja e parë e këtij libri fillon me këtë konstatim: “Dobrica Qosiq ka qenë njeriu më besnik i Aleksandër Rankoviqit. I kanë bashkuar e lidhur parimet identike politike në botë. Të dy kanë qenë e kanë metur komunistë të parimeve nacionaliste”. Siç dihet, Rankoviqi ka qenë ministër kriminel i punëve të brendshme, përkastësisht kryeshef i UDB-së, policisë famkeqe sekrete, e cila ka bërë krime të tmerrshme në popullsinë shqiptare në Jugosllavi. Madje në zbatimin e Memorandumit rol të madh do të luajnë pakicat serbe në shtetet fqinjë për destabilizimin e tyre në mënyra të ndryshme, siç bënë pakica serbe në Kosovë.

Por kjo nuk është asgjë e re, sepse programe, memorandume dhe ligje të tilla të politikës ekspansioniste e shoviniste serbe Serbia ka pasur që nga shekulli 12 e deri më sot. Që nga Stefan Nemanja, Car Dushani, Obrenoviqët, Karagjorgjeviqët e deri te Milosheviqët, Koshtunicat e Boris Tadiqët e ditëve tona. Këtë ideal kombëtar megaloman në vazhdimësi do ta kenë të struktur në psikologjinë e tyre të sëmundë çdo qeveri, çdo patriark i kishës serbe ortodokse, çdo politikan dhe çdo shkencëtar e shkrimtar shovinist serb. Fatkeqësisht, edhe shumë gjenerata të popullit të indoktrinuuar serb do të ushqehen me këtë opium vdekjeprurës për fatin e tij dhe për paqen në këtë pjesë të Evropës, sepse, siç thotë populli “Çka piqet, nuk hiqet!”

Duket se Evropa nuk e njeh sa duhet psikologjinë serbe. Ajo po e përgëdhelë në njëfarë mënyre Serbinë në dëm të pavarësisë dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës për ta futur atë në institucionet e larta të Evropës Perëndimore. Por në këtë mënyrë po e fut gjarprin në gjë, siç thotë populli, i cili politikën dhe veprimet ekspansioniste gjenocidale të Serbisë i ka përjetuar në supat e veta gjatë shekujve, kështu që shqiptarët e njohin më mirë Serbinë se çdokush tjetër. Serbia gjithmonë do ta luajë rolin e “Kalit të Trojës”, përkatësisht të Moskës në Ballkan. Serbia me politikën e saj ekspansioniste

gjithmonë ka qenë shkaktare e trazirave dhe konflikteve të përgjakshme në këtë pjesë të Evropës dhe më gjerë.

Por, megjithatë, gjithmonë mund të ketë përjashtime dhe njerëz që mendojnë, gjykojnë e veprojnë me mend dhe arsye. Shpresojmë se në këtë drejtim duhet të prijnë intelektualët serbë, autorë shkencorë e letrarë, njerëz të kulturës, të vullnetit të mirë, të tolerances dhe të moralit të lartë për të mirën e përgjithshme, siç ka qenë Dimitrije Tucoviqi dhe disa shokë të tij të paktë.

Shqiptarët do të jenë, siç kanë qenë gjithmonë, njerëz paqësorë, tolerantë, mikpritës, njerëz të burrërisë, trimërisë, të besës e të nderit, pra të moralit të lartë të traditës shqiptare. Këto veti pozitive të traditës shqiptare kanë qenë dhe janë temë e shpeshtë e autorëve shkencorë e letrarë të të gjitha gjeneratave shqiptare. Ne nuk mund t'i harrojmë viktimat e gjenocidit serbo-malazez gjatë shekujve ndaj popullit fisnik shqiptar, siç kanë qenë, për shëmbull, viktimat e gjenocidit me zbatimin e programit të qeverisë serbe "Naçertania" të vitit 1844. Sipas librit "Naçertania" të H. Bajramit, "Serbia gjatë viteve 1878-1879 i ka shkatërruar 714 fshatra shqiptare të Sanxhakut të Nishit (Toplicës, M.K). Nga trojet etnike shqiptare atëbotë u dëbuanë mbi 350.000 shqiptarë, ndërsa llogaritet se në viset e ndryshme të Kosovës, me kërkesë të qeverisë serbe, në trojet e shqiptarëve të Sanxhakut të Nishit u sollën vetëm 5.600 serbë... Dihet në bazë të dokumentave se deri në fund të vitit 1913 Serbia i likuidoi 150.000 shqiptarë". Janë të njohura viktimat e mëdha të gjenocidit malazez të vitit 1913 në Rrafshin e Dukagjinit për ndërrimin e fesë e të kombësisë, pastaj gjenocidi i tmerrshëm në Tivar më 1945, ku u masakruan mbrenda ditës më se 4.600 të rinj shqiptarë të Kosovës, të Maqedonisë etj. të mobilizuar, pa armë, pa uniformë, gjoja për të luftuar kundër nacistëve gjermanë. Më në fund po përmendim gjenocidin kundër popullsisë civile shqiptare në Kosovë të kasapit të Ballkanit Sllobodan Millosheviqit më 1998-1999, ku ranë më se 12.000 viktima të civilëve, kryesisht pleq, gra e fëmijë, madje edhe të sëmurë e të shtruar në spitale, dhe dëbimin e dhunshëm të mbi 800 mijë shqiptarëve, duke bërë kështu spastrimin etnik të Kosovës. Për fat të keq në këtë gjenocid kanë marrë pjesë aktive edhe shumë kolonistë serbo-malazezë, të cilët shqiptarët i kanë mbrojtur gjatë Luftës së Parë e të Dytë Botërore. Ky gjenocid serbo-malazez ka peshën më të rëndë nga fakti që asnjë zyrtar kompetent serb nuk e ka dënuar këtë krim të shëmtuar. Madje as Kisha serbe ortodokse, asnjë

autor autoritativ shkencor e letrar nuk e ka dënuar këtë gjakderdhje të mijëra viktimave të njerëzve krejtësisht të pafajshëm.

Megjithatë, autorët shqiptarë të shkencës, të letërsisë dhe të politikës, përpiqen të shuhet mllëfi i arsyeshëm, të qetsohen zemrat e lënduara për të dashurit e tyre të humbur, të mos ushqehet psikologjia e hakmarrjes, por ajo e tolerancës dhe e pajtimit. Por mos të harrohet ajo që s'mund të harrohet.

## Literatura

Jovan Cvijić, *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje*, Beograd 1956.

Savo Brković, *Etnodenezofobija - Prilog kritici velikosrpstva*, Cetinje 1988.

Dimitrije Tucović, *Srbija i Albanija*, Beograd 1914.

Atanasije Urošević, *Kosovo*, Beograd 1965.

Tatomir Vukanović, *Drenica - druga srpska Sveta Gora*, Priština, 1998.

Gjini Gasper, *Skopsko-Prizrenska biskupija kroz stoljeća*, Zagreb, 1986.

Dr. Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Priština, 1981.

Jusuf Osmani, *Kolonizimi serb i Kosovës*, Prishtinë, 2000.

Dimitrije Bogdanović, *Knjiga o Kosovu*, Beograd, 1986.

Ruža Petrović, Marina Blagojević, *Seoba Srba i Crnogoraca sa Kosova i iz Metohije -Rezultati ankete sprovedene 1985-1986*, Beograd, 1989.

Dragoljub Todorović, *Knjiga o Ćosiću*, Beograd, 2005.

Hakif Bajrami, *Naçertania – program politik serb që shpie në shfarosjen e shqiptarëve 1844 – 1999*, Prishtinë, 2004.

Konstantin Jireček, *Istorija Srba*, Beograd, 1952.

Jovan Radonić, *Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd, 1950.

Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, Tiranë, 1998.

Hivzi Islami, *Kosova dhe shqiptarët – Çështje demografike*, Prishtinë, 1990.

Ibrahim Hoxha, *Çamëria dhe Janina në vitet 1912–1922*, Tiranë, 1996.

Mid'hat Frashëri, *Çështja e Epirit*, Tiranë, 1998.

Ismail Kadare, *Ra ky mort e u pamë – Ditat për Kosovën*, artikuj, letra, Nju-Jork, 2005.

Nevila Nika, *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910-1912)*, Prishtinë, 2003.

Instituti arkeologjik i Kosovës, Grup autorësh, *Kosova arkeologjike*, Prishtinë, 2006.

*Časopis kritiko znanosti, Pregled politike Srbije prema Albancima 1913 do 1945 godine*, Ljubljana, 1989.

Špiro Kulišić, *O etnogenezi Crnogoraca*, Titograd, 1980.

Ali Hadri, *Pozita dhe gjendja e Kosovës në mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941)*, “Gjurmime albanologjike” nr. 2, Prishtinë, 1968.

Hajredin Hoxha, *Politika e eliminimit të shqiptarëve nga trualli i Jugosllavisë së vjetër*, revista “Përparimi” nr. 4, Prishtinë, 1970.

Aleksander Stipčević, *Iliri*, “Školska knjiga”, Zagreb, 1974.

Sabit Uka, *Venbanimet e Sanxhakut të Nishit të banuara me popullsi shqiptare dhe të përzier në vitet 1877-78*, revista “Gjurmime albanologjike”, Seria e shkencave historike XII, Prishtinë 1983.

Skënder Riza, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, “Rilindja”, Prishtinë, 1982.

Shukri Rahimi, *Vilajeti i Kosovës*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1969.

Selami Pulaha, *Të dhënat ekonomike dhe demografike për krahinën e Hoçës, - regjistrimi kadastral i vitit 1591*, revista “Studime historike” nr. 1, Tiranë, 1976.

Selami Pulaha, *Të dhëna ekonomike dhe demografike për krahinën e Opojës në gjysmën e dytë të shejkullit XVI*, revista “Studime historike”, nr. 3, Tiranë, 1975.

Dr. Don Shon Zefi, *Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve*, Prizren, 2000.

Dr. Xheladin Shala, *Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918*, Prishtinë, 1990.

Dr. Skënder Duraj, *Shqiptarët dhe serbët*, Prishtinë, 1991.

---

Zekeria Cana, *Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë, 1908-1912*.

Dr. Lush Culaj, *Shqipëria dhe problemi kombëtar gjatë viteve 1918-1928*, Prishtinë, 2004.

Abdullah Bytyçi, *Terrori shtetëror dhe gjenocidi serbo-malaziaz në Kosovë 1878-1993*, Prishtinë, 2001.

Rrustem Berisha, *Holokausti shqiptar, I*, Nju-Jork, 2002.

Shaban Braha, *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare (1844-1990)*, Tiranë, 1991.

Pero Slijenčević, *Ranopis "Ogledi"*, Beograd, 1934.

Mark Krasniqi, *Rojtarët e kishave në Kosovë*, në librin *Gjurmë e gjurmime*, Prishtinë, 1979. Botuar edhe serbisht në Qlasnik Muzeja Kosova i Metohije, III, Prishtina, 1958.

---

Akademik Pajazit Nushi

## **TË DREJTAT E NJERIUT DHE KORELATAT TEORIKE E PRAKTIKE ME FAKTORËT SHTETNDËRTUES TË KOSOVËS**

Subjektiviteti politik, ekonomik e social i Kosovës dhe organizimi shtetëror i tij për zhvillim të pavarur dhe sovran tashmë ka hyrë në përfundim të gjysmës së parë të vitit tretë. Gjatë këtyre 42 muajve të funksionimit shtetëror të Kosovës është zhvilluar përvojë e çmueshme shtetndërtuese, e cila kërkon identifikim të faktorëve veprues të një procesi specifik të ndërlikuar politik, siç është ai përforcimit dhe i stabilizimit të organizmave shtetërorë veprues në fushën e politikës së brendshme dhe të jashtme të Kosovës. Procesi i përforcimit dhe i stabilizimit të organeve shtetërore dhe i institucioneve të shoqërisë civile të Kosovës është i lidhur me një kompozicion faktorësh politikë, ekonomikë dhe socialë të ndërlidhur ndërmjet tyre, ku të drejtat dhe liritë e njeriut që nga miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës kanë zënë vendin qendror dhe më të rëndësishëm për zhvillimin e shtetësisë së Kosovës. Me sistemin e definuar në Kushtetutë të vlerave të njeriut dhe me dinjitetin e pacenueshëm të secilit qytetar e respektimin e mobilizuar të tij ndaj tjetrit pavarësisht nga përkatësia gjinore, moshore, kombëtare, fetare e racore e tij Kosova është përcaktuar që pavarësinë e sovranitetin e vet ta përforcojë pikërisht me zhvillimin humanist të kapaciteteve njerëzore, duke e lidhur zhvillimin e këtillë me faktorin e unitetit dhe të pandashmërisë gjeografike, shoqërore, kulturore, morale e shpirtërore, si edhe me rrjedhat karakteristike të së kaluarës së përgjakshme dhe me synimet paqedashëse e demokratike të së ardhmes së saj dhe të vendeve të Evropës Juglindore dhe më gjerë. Në këtë kontekst të gjerë, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimi i ligjit është vlerë e ndërlidhur me parimet e lirisë, të paqes, të demokracisë, barazisë, mosdiskriminimit, të drejtën e pronës, të mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut<sup>1</sup>. Gjykuar sipas këtij drejtimi zhvillimor të drejtat e liritë e njeriut dhe shkalla e realizimit të tyre në Kosovë, përkatësisht “sigurimi i respektit të plotë i të drejtave të njeriut është prioritet kyç në partneritetin evropian”<sup>2</sup>.

Meqë Kosova është përcaktuar për t'u bërë partner i devotshëm evropian, arritja e këtij caku qenësor për Kosovën është njëkohësisht sa

---

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nei 7, fq. 2, Prishtinë, 2008.

<sup>2</sup> Komisioni i Komunitetit Evropian, Prishtinë, 2009, fq. 12.

vlerë aqsa edhe detyrim kryesor i të gjithë shtetasve të Kosovës për ngritje dhe përforsim të shtetit të tyre, duke i kontribuar paqes dhe mirëqenies në regjionin më të gjerë. Ky synim bashkëkohor i zhvillimit të qenies së shtetit të Kosovës del nga Kushtetuta e Kosovës, ku kompozita e faktorëve shtetndërtues është konceptuar duke i lidhur ngushtë vlerat e respektimit të të drejtave të njeriu me ato politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Lidhur me këtë parashtruar pyetjen:

1. Çfarë tregojnë faktet dhe të dhënat empirike për nivelin dhe cilësinë e përpunimit teorik dhe të realizimit të vlerave të të drejtave të njeriut? Kjo është detyrë e vetme e kësaj kumtese.

### **Burimet e fakteve dhe e të dhënave**

Për t'iu përgjigjur pyetjes së parashtruar shfrytëzuam shumë burime. Nga burimet e shfrytëzuara dalluam më të rëndësishmit, ndër të cilët përmendim: Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Raportet e Progresit për Kosovën, tekstin e KMDLNJ-së “Të drejtat e njeriut, diçka për t'u dëshiruar i vitit 2010, Komunikatën nga Komisioni Evropian për Parlamentin dhe Këshillin e Evropës, Raportin e Progresit të UNDP-isë, etj.

### **Aspekti teorik i të drejtave të njeriut dhe lidhja e tyre me faktorët shtetndërtues**

Institucionet e shoqërisë civile dhe organet e pushtetit të Kosovës i kanë kushtuar kujdes analizës teorike të kushteve dhe të raporteve të respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në procesin shtetndërtues të Kosovës. Shumë prej këtyre analizave kanë të bëjnë më tepër me komentim të të dhënave e fakteve të mbledhura nga përvojat trevjeçare të zhvillimit të proceseve shtetërore të Kosovës, duke përfshirë edhe analizën e pasojave të luftës e të konflikteve ushtarake në Kosovën e viteve 1998 – 1999 dhe reflektimin e këtyre pasojave në raportet sociale, politike dhe ekonomike të shtetndërtimit të Kosovës. Në këtë pikëpamje dallohen institute të veçanta profesionale e shkencore, siç janë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Instituti për Studime të Avancuara, Instituti për Shoqëri të Hapur, Instituti i Historisë, Instituti për Studime Demokratike, etj.

Në nivelin e mendimit akademik të drejtat dhe liritë e njeriut u përpunuan më tepër për nevoja arsimore dhe edukative. Në kuadrin e këtyre nevojave dhe të mundësive, të kushteve dhe të raporteve të bashkësisë së Kosovës dhe të synimeve shtetndërtuese të Kosovës u shtjellua dhe u përpunua në pikëpamje teorike një disiplinë e posaçme e pedagogjisë bashkëkohore, që autori i saj e emërtoi “Pedagogjia ndërkombëtare”<sup>3</sup>. Nga analiza e hollësishme e dokumenteve për të drejtat e njeriut të Asamblesë së Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës, si edhe nga përparësitë e zhvillimit të arsimit në Kosovën e re, autori i kësaj vepre i sintetizoi mendimet e tij në disa detyra, nga të cilat dallohet detyra e edukimit dhe e arsimimit në frymën e paqes në botë, të tolerancës ndërnjerëzore dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar<sup>4</sup>. Madje ka vë bazat e parimeve të kësaj discipline, ku ka dalluar këto parime: 1. Parimi i arsimit të përhershëm, parimi integrues i arsimit, i demokratizimit, parimi ndërdisiplinor në arsimin ndërkombëtar, parimi i arsimit multietnik dhe multikulturor, parimi i arsimit në të ardhmen, etj.<sup>5</sup>.

### **Aspekti praktik i të drejtave të njeriut dhe lidhja e tyre me faktorët shtetndërtues të Kosovës**

Në Kosovë janë disa institucione të shoqërisë civile që merren me monitorimin e aktiviteteve në fushën e realizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. I këtillë është Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut me nënkëshillat e tij, Organizata “Fol”, etj. Këta organizma të shoqërisë civile të Kosovës po aftësohen dhe specializohen për monitorime të fushave të ndryshme të të drejtave të njeriut, siç janë: e drejta e jetës, e sigurisë, e barazisë para ligjit, e gjykimit objektiv, e qarkullimit të lire, e pasurisë, e mendimit dhe e shprehjes së lirë, e drejta për punë, etj. Nga rezultatet e arritura dhe të publikuara të këtyre organizatave i përpunua shkëlqen e të drejtave të njeriut në dymbëdhjetë fusha gjatë tri viteve të fundit, përkatësisht gjatë vitit 2008, 2009 dhe 2010. Nivelin e përparimit të të drejtave të njeriut gjatë këtyre viteve e vlerësuam sipas kësaj shkalle: D = s’ka përparim, C = ka shumë pak përparim, B = ka pak përparim dhe A

---

<sup>3</sup> Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta, Seksioni i Shkencave Shoqërore, Libri 26, Jashar Rexhepagiq, Çështje fundamentale në pedagogjinë ndërkombëtare, Prishtinë, 2008.

<sup>4</sup> Po aty, fq. 32.

<sup>5</sup> Po aty, fq. 39 – 114.

= ka shumë përparim. Këtë lloj të shkallëzimit të ndryshimit të gjendjes së të drejtave të njeriut e kanë zbatuar edhe disa institucione<sup>6</sup>.

Sipas kësaj shkalle të vlerësimit përcaktuam ndryshimin e gjendjes së të drejtave të njeriut gjatë një periudhe prej 3 vjetësh, duke filluar prej vitit 2008 deri në vitin 2010. Në vlerësimin e këtillë u përfshinë dymbëdhjetë fusha të ndryshme të të drejtave të njeriut, të cilat u nxorën kryesisht nga Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut<sup>7</sup>. Fushat e të drejtave të njeriut dhe shkalla e vlerësimit të ndryshimit të gjendjes së tyre në periudhën prej tri vjetësh paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela e fushave të të drejtave të njeriut dhe vlerësimi i ndryshimit të gjendjes së tyre

<b>F u s h a t:</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>
1. Sundimi i ligjit	0	0	1
2. E drejta e jetës	2	2	3
3. E drejta për punë	1	2	1
4. Të drejtat e minoriteteve	1	2	2
5. Të drejtat e fëmijëve	2	2	2
6. Kthimi e integrimi	1	2	2
7. Arsimi dhe edukimi	2	2	2
8. Barazia gjinore	1	2	2
9. E drejta e qarkullimit	2	3	3
10. E drejta e informimit	1	2	2
11. Korrupcioni e krimi i organizuar	0	0	1
12. Trafikimi i qenieve njerëzore	1	1	0


Të dhënat e ponderuara për domethënien dhe rëndësinë e përparimit të të drejtave të njeriut gjatë tri viteve të fundit të dekadës

<sup>6</sup> Raportet e Progresit për Kosovën, *gap*, Prishtinë, 2010, fq. 9.

<sup>7</sup> Zyra e Komisaritit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, Kombet e Bashkuara, Prishtinë, 2000.

së parë të shekullit njëzet përputhen me shtrirjen kohore të shpalljes së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran. Këto të dhëna tregojnë avancimin e të drejtave të njeriut gjatë zhvillimeve shtetndërtuese të Kosovës. Secila nga të dhënat e ponderuara dhe të paraqitura në tabelën e mësipërme emërtojnë rëndësinë dhe peshën e ndikimit të ndryshores së të drejtave të njeriut në tërësinë e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë dhe në ritmin e shtetndërtimit të Kosovës.

Vështrimi i thjeshtë i domethënies së të dhënave të paraqitura në këtë tabelë tregon se përparimi në të gjitha fushat e të drejtave të njeriut silllet prej mungesës së përparimit, përkatësisht prej gjendjes së pakënaqshme deri në përparimin me ritëm të nivelit të ulët. Fushat më të theksuara me mungesë të ndryshimeve pozitive dhe me ritëm shumë të ulët të ndryshimeve pozitive janë: fusha e korrupsionit dhe e krimit të organizuar dhe ajo e trafikimit të qenieve njerëzore. Të gjitha fushat e tjera të të drejtave të njeriut, me përjashtim të fushës së qarkullimit të lirë të qytetarëve sillen prej gjendjes së pakënaqshme deri në përparim të nivelit të ulët të të drejtave të njeriut. Me fjalë të tjera, ritmi shumë i ngadalshëm i ndryshimeve pozitive në fushat e fokusuara të të drejtave të njeriut përbën njërën ndër karakteristikat zhvillimore të shtetësisë së Kosovës e të qytetarëve të saj. Ritmin dhe karakteristikën e kësaj të zhvillimit të të drejtave të njeriut e dallojmë më qartë në grafikonin e mëposhtëm:



**Fig. 1** – Raporti i përparimit të të drejtave të njeriut në vite

**Përfundim**

Kosova është pozicionuar drejt në rrugën e partneritetit evropian, duke trajtuar të drejtat dhe liritë e njeriut prioritet kyç i aktivitetit të gjithëmbarshtëm të saj. Por zhvillimi i vetëdijes për rëndësinë dhe rolin e të drejtave dhe lirive të njeriut, si edhe të detyrimeve të secilit për sjellje njerëzore të qëndrueshme gjendet në fazën fillestare të zhvillimeve shtetndërtuese. Në këtë fazë vështrimi i ndërlidhjeve a korelatave të të drejtave të njeriut me faktorët shtetndërtues, sidomos me faktorin e sigurisë, të sundimit të ligjit dhe të barazisë së qytetarëve të të gjitha moshave, gjinive, kombësive dhe religjioneve tregoi ngadalësim të ndryshimeve pozitive.

Pavarësisht nga ndryshimet individuale ndërmjet banorëve të regjioneve të ndryshme të Kosovës dhe ndryshimeve efektive ndërmjet fushave kryesore të të drejtave të njeriut, këto fakte dhe të dhëna për zhvillim të vetëdijes për të drejtat e njeriut te qytetarët e Kosovës tregojnë qëndrim të dëshiruar të qytetarëve të Republikës së Kosovës për nevojën e ngritjes së pozicionit të Kosovës në partneritet evropian. Ritmi kaq i ngadalshëm i ndryshimeve pozitive të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore që nënkupton detyrimet e secilit për sjellje njerëzore ndaj të gjithë të tjerëve po ndikon negativisht në zhvillimin e lidhjeve pozitive të faktorit njeri dhe të kapaciteteve njerëzore të Kosovës me faktorët e shtetndërtimit paqësor dhe demokratik të Republikës së Kosovës.

## SHKAQET DHE EFEKTET E DËSHTIMIT TË REGJISTRIMIT TË POPULLSISË

Kosova është vendi me specifika më të mëdha demografike në Evropë, **rast sui generis dhe në planin statistiko-demografik**, veçanërisht sa i përket shkaqeve të shpërnguljes sistematike dhe deportimit me masa të ndryshme të presionit dhe të dhunës deri te ndërmarrjet e hapëta gjenocidale, që bënte përjashtim në historinë e eksodeve etnike në Evropë pas Luftës II Botërore. Në instancë të fundit, këto arsye e detyruan forcën më të madhe ushtarake në botë (NATO) të ndërhyjë kundër forcave serbe në mars të vitit 1999, duke i ndjekur ato nga Kosova.

Nevoja për njohjen e realitetit etniko-demografik, social dhe ekonomik të Kosovës pas luftës u bë më se e domosdoshme jo vetëm pse nuk kishte pasur regjistrim të popullsisë që nga viti 1981, por pse lufta e fundit e kishte ndryshuar radikalisht gjendjen në terren, duke sjellë pasojë të mëdha, të drejtpërdrejta dhe indirekte demografike dhe socioekonomike (shpërnguljet, deportimet, vrasjet, shkatërrimet e shtëpive dhe dëmet e tjera materiale, zhdukja e dokumentacionit, emigrimet në botën e jashtme, redistribuimi masiv i dhunshëm i popullatës brenda Kosovës etj.).

Suksesi i çdo regjistrimi të përgjithshëm të popullsisë matet me dimensionin gjithpërfshirës dhe cilësor të tij. Mjerisht, pikërisht në këtë rrafsh në rastin e regjistrimit të prillit të vitit 2011 në Kosovë doli ajo që edhe pritej - dështimi! Dështimi u bë i ditur me shpalljen e rezultateve preliminare, kur nga Enti Statistikor i Kosovës u bë e ditur se në Kosovë u regjistruan vetëm 1.733.872 banorë dhe në metropolin e saj, në Prishtinë, jo si qytet, por si komunë u evidencuan 198.214 banorë! Rezultatet e shumëpritura të "Listës suplementare", mashtruese për bashkatdhetarët tanë në botën e jashtme, nuk u kumtuan, ndërsa shpjegime nuk u dhanë!

Të përkujtojmë se Enti Statistikor i ish-Federatës Jugosllave në vitin 1991 e vlerësoi numrin e popullsisë së Kosovës në 1.956.196 banorë dhe në periudhën 1991-2000 shtimi natyror i evidencuar në Kosovë, sipas statistikës zyrtare serbe, mesatarisht në vit ishte rreth 38.000 veta, që do të thotë për 10 vjet janë shtuar rreth 380.000

banorë. Ndërkaq, në periudhën 2001-2011 ky shtim, sipas statistikave vitale të Kosovës është mesatarisht në vit rreth 28.000 veta, me gjithë defektet në dëm të gjendjes reale (nënregjistrimi), që nënkupton se për këtë periudhë kemi pasur një shtim natyror përreth 280.000 veta. Mbi bazë të këtij treguesi vital, si argumenti më i fuqishëm i gjendjes reale demografike, Kosova ka të paktën 500.000-600.000 banorë më shumë se rezultati i shpallur zyrtarisht nga Enti Statistikor. Shpjegimi i vëllimit demografik të Prishtinës, por edhe i qendrave të tjera mezorajonale mbesin çështje në vete.

### **Shkaqet e dështimit të operacionit**

Lidhur me shkaqet e dështimit të operacionit, të shkojmë radhazi:

- pas vitit 2003 u bënë përpjekje për organizimin e regjistrimit të popullsisë, por dolën një varg pengesash dhe dobësishë, që flasin qartë për mosgatishmërinë për të hyrë në këtë operacion të ndërlikuar;

- që në nismë nga instancat politike, ndërkombëtare dhe vendore projekti u konceptua në atë mënyrë që shkonte në dëm të komponentit gjithpërfshirës dhe kualitativ, veçanërisht të popullatës shumicë;

- faktorit ndërkombëtar që nga fillimi nuk i interesonte dimensionin strukturor i regjistrimit, por vetëm pasqyra e tillë etnike, ku shqiptarët do të dilnin në numër sa më të vogël për t'i dhënë Kosovës dhunshëm dimension multietnik;

- paaftësia dhe neglizhenca e institucioneve të Kosovës, nga ato të përkohshmet deri te këto të sotmet, interferimet politike të Serbisë zyrtare dhe të faktorit ndërkombëtar, që i pranonte dhe vazhdon t'i pranojë pa rezervë kërkesat e Beogradit;

- mungesa e infrastrukturës ligjore dhe e kapaciteteve profesionale, organizative teknike dhe menaxhuese të Entit Statistikor të Kosovës si bartës i organizimit dhe realizimit të operacionit, i cili për më se 10 vjet nuk bëri gjë për ndërtimin e tyre;

- dështimi i tri regjistrimeve provuese (më 2005, 2006 dhe 2009), kur ditën që mbaronin, pa u mbledhur asnjë material nga zyrtarët e Qeverisë shpallëshin të suksesshëm, me notë dhjetëshel;

- për çdo projekt, sidomos ata që kanë karakter shtetëror, donacionet janë të mirëseardhura, por nuk duhet lejuar që të jenë edhe

imponuese në çështjet thelbësore të Kosovës, siç ndodhi me regjistrimin, ku rreth 70% të mjeteve janë donacione;

- në emër të disa standardeve ndërkombëtare tash e 12 vjet po eksperimentohet me Kosovën në të gjitha fushat, ndërsa në rastin e regjistrimit dëshirohet dhunshëm të krahasohet zhvillimi demografik i Kosovës me Evropën, por jo edhe me vetveten;

- ndërrimi i konceptionit, pa u analizuar mirë efektet e tij, si dhe prerja e paparë mekanike e ndryshimit të definicioneve dhe klasifikimeve në çështjet esenciale, si p.sh. me popullsinë rezidente, ka si pasojë lëndimin e rëndë të realitetit demografik, social, etnik etj. të Kosovës;

- angazhimi i strukturave qendrore pushtetore në dy operacione masive njëkohësisht apo brenda një harku të shkurtër kohor në zgjedhje dhe regjistrim dhe preokupimi i tyre vetëm me zgjedhjet parlamentare e komunale e pastaj edhe me ato të presidentit nuk është e lejueshme;

- regjistrimi ndonëse është komponent i ndërlikuar profesional-teknik, mjerisht, bartësit e operativës dhe të menaxhimit nuk ishin profesionistët, pjesëtarët e aftësuar mirë dhe kuadrot me njohuri nga fusha e statistikës dhe të shkencave shoqërore, por njerëzit e partisë në pushtet, të klaneve, të familjarëve, të farefisit dhe projekti i shtrenjtë e i komplikuar rrëshqiti nga terreni profesional në terrenin familjar e klanor-partiak;

- paaftësia e Zyrës së Regjistrimit të Popullsisë dhe e udhëheqësit të saj, i cili nuk posedon asfarë përgatitjesh menaxhuese dhe profesionale, me mungesë njohurie dhe për operacionin më elementar, nxjerrjen e përqindjeve, por me mbështetje të fuqishme politike e të tjera;

- Zyra e Regjistrimit të Popullsisë, që i ka marrë të gjitha autorizimet financiare dhe operative, me Ligjin mbi Regjistrimin të 7 tetorit 2010 është një instancë e shpifur për të rrëmbyer mjete financiare në vend se të gjitha autorizimet si organizues dhe realizues i operacionit të regjistrimit t'i bartë Enti Statistikor i Kosovës;

- dorëheqja e u. d. të drejtorit të Entit Statistikor vetëm disa ditë para se të fillonte operacioni ishte një argument më tepër se sukcesi i këtij regjistrimi vëhej në pikëpyetje, si dhe largimi i ushtruesit tjetër të detyrës së këtij Enti këto ditë, vetëm një muaj para se të kumtoheshin rezultatet e para të regjistrimit;

- paaftësia e institucioneve qendrore politike dhe statistike që operacionin ta realizonin në të njëjtin interval kohor dhe në tërë territorin e Republikës si obligim kushtetues, çfarë është rasti me veriun e Kosovës, tregon për dështimin e gjithë operacionit;

- fakti që u shty regjistrimi për 5 ditë për disa komuna, pa pasur asnjë arsye të veçantë, përveç pse doli keq gjendja numerike, flet për dështimin e tij;

- dështimin e ndërmarrjes e konfirmojnë edhe njohuritë që i posedojnë ekspertët jashtë operativës, raportimet nga terreni gjatë fazës së realizimit të operacionit dhe pas tij, përfshirë deklaratat e personave të papërfshirë në regjistrim, kumtimi i disa të dhënave kundërthënëse nga vetë zyrtarët e MAP dhe të ESK etj.

- nuk u përfill fare mendimi i ekspertëve dhe i institucioneve shkencore, madje as i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve, e cila, me kohë u sugjeroi instancave vendimmarrëse (qysh më 2006 dhe pastaj në maj të vitit 2010) që, për të pasur një regjistrim objektiv, gjithëpërfshirës dhe cilësor, operacioni të merret me shumë seriozitet, duke marrë parasysh edhe vendimin për shtyrjen e tij dhe për rishqyrtimin e tërë çështjeve kontestuese, përfshirë edhe Ligjin për regjistrimin e popullsisë.

### **Standardet dhe pushteti: E. Hoxhaj si M. Savoviq!**

Në rastin e regjistrimit, të huajt u imponuan fuqimisht në çështjen strukturore dhe fundamentale të tij në konceptcionin, ku “popullsi rezidente” nuk mund të konsiderohen ata banorë që mungonin mbi një vit, sikundër që të tillët nuk mund të përfshihen në popullsinë e përgjithshme. Në vend se të analizohej me shumë kujdes zgjedhja e konceptcionit dhe realiteti sociodemografik kosovar në terren, u shqiptua diktati dhe ai u pranua pa hezitim nga instancat tona qeveritare, Komisioni Qendror i Regjistrimit (në krye të të cilit gjendej një hipokrit dhe injorant) dhe Enti Statistikor. Nuk ishte preokupim i të huajve komponenti gjithëpërfshirës dhe ana cilësore e të dhënave, por vetëm përfshirja e disa indikatorëve, në radhë të parë numri i përgjithshëm, i reduktuar dhunshëm, dhe përbërja etnike e tij.

Një varg rrethanash e bëjnë edhe regjistrimin e popullsisë në Kosovë të veçantë dhe të pakrahasueshëm me vendet tjera të rajonit dhe të Evropës. Lufta politike sot, bile në hapësirat tona, po bëhet edhe me shifra, ku qarqe të ndryshme ndërkombëtare po përpiqen që

Kosovës t'i japin dhunshëm dimension multietnik me qëllim që ta zvogëlojnë numrin e shqiptarëve dhe ta rrisin numrin e të tjerëve, para së gjithash të serbëve! Pranimi i vlerësimit se Kosova është rast i veçantë edhe në segmentin statistik-demografik është në përputhje të plotë me realitetin në terren dhe të vërtetën shkencore.

Në emër të zbatimit të standardeve ndërkombëtare nuk mund të largohemi krejtësisht nga specifikat tona, sikundër që nuk mund të pajtohemi që të eksperimentohet me Kosovën edhe në çështjet madhore të saj. Me faktin se "standardi ndërkombëtar" në rastin e regjistrimit është një porosi, secili vend ka të drejtën e vet edhe në rregullimin e kësaj materie. Fundja, midis këtij standardi dhe të drejtës së shtetit sovran për të zgjedhur konceptin e regjistrimit, në rastin e veçantë të Kosovës, ka mundur të gjendej një model i pranueshëm i regjistrimit, por gjithnjë më afër kriterit tradicional dhe të vërtetës shkencore dhe më larg një fiksioni. Nuk mund të bëhemi robër të disa standardeve derisa ato nuk gjejnë zbatim në terrenin tonë, sikurse politika e tetë standardeve të famshme për Kosovën.<sup>1</sup> Na kujtohen 8 standardet në fund të vitit 2003, kur i solli një zyrtar i lartë amerikan, Mark Grosman, si detyra për Kosovën, ndërsa zyrtari tjetër po ashtu amerikan, M. Abramovich, anëtar i ICG, i cili na ndihmoi shumë në Rambuje në vitin 1999, tha se "vetëm Danimarka dhe Norvegjia në këtë botë mund t'i përmbushin këto standarde"! Dhe 8 standardet shpejt u harruan. Në emër të "standardeve ndërkombëtare" po justifikohet dështimi i regjistrimit! Standardet po ngatërrohen me praktikën e regjistrimit në vendet europiane! Nëse ne jemi konsekuent në zbatimin e "standardeve ndërkombëtare", shtrohet pyetja: a ekziston një pyetësor unik, individual apo i ekonomive shtëpiake ose i

<sup>1</sup> *Këto tetë standarde ishin:* institucionet demokratike funksionale; sundimi i ligjit; lëvizja e lirë e njerëzve; kthimi i të shpërngulurve dhe riintegrimi i pakicave; ekonomia; të drejtat pronësore; dialogu me Beogradin dhe TMK-ja. Politika e tetë standardeve ishte një absurd. Së pari ishin bërë vetëm për serbët: kthyerjen e tyre dhe sigurinë. Së dyti, konceptualisht vështruar, vetë karakteri i ndërlikuar dhe afatgjatë i standardeve dhe përmbushja e tyre për një kohë kaq të shkurtër ishte absurdi tjetër, i paparë në raportet dhe zhvillimin shoqëror në vendet në transicion. Cili vend më i zhvilluar i botës mund t'i përmbushte? M Abramovich, një ish-zyrtar i lartë i SHBA-së pati thënë vetëm Danimarka dhe Norvegjia mund t'i përmbushin standardet e tilla, e këto nuk janë as anëtare të Grupit të Kontaktit. A nuk është një cinizëm kur edhe Rusia, plot krim të organizuar dhe stalinizëm, kërkonte respektimin e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit, demokratizimin e jetës, ekonominë e tregut?!

banesave për gjithë Europën që ne ta zbatojmë në tërësi? Natyrisht, nuk ekziston!

Pushtetarët tanë, që në çdo situatë janë inferiorë ndaj të huajve, në momente të caktuara "trimërohen" dhe kundërshtojnë, por kjo ndodh vetëm në rastin e marrjes së pushtetit! Numri dy i partisë në pushtet, anëtari i Qeverisë Enver Hoxhaj, më 13 janar 2011 tha se "zgjedhjet janë kryekput çështje e brendshme e Kosovës", duke injoruar këtu edhe OSBE-në dhe instancat e tjera. Kjo deklaratë e Hoxhajt na përkujton deklaratat e parreshtura famëkeqe të një ministreje për pakica dhe të drejta të njeriut në Serbi, në kohën e Millosheviqit, Margit Savoviq, që thoshte se "problemi i të drejtave të njeriut është çështje e brendshme e Serbisë" (!), që do të thoshte se regjimi serb kishte të drejtë t'i rrahte, t'i burgoste arbitrarisht, t'i shpërngulte, t'i vriste etj. shqiptarët, ndërsa OSBE-ja dhe bota demokratike nuk mund të përziheshin në punët e brendshme të Serbisë! Ose, në paralajmërimin e ICO-së se do ta anulojë vendimin e Qeverisë për rritjen e pagave për kategori të caktuara që tërheqin vota, njeriu tjetër, po ashtu numër dy i partisë në pushtet dhe në vetë pushtetin (zv.kryeministër), Hajredin Kuçi, më 2 shkurt 2011 deklaroi: "Le ta harrojë dikush që në Kosovë mund të shfuqizohen vendimet e institucioneve legjitime të pavarura" pa llogaritur pasojat e konfliktit Kosovë-FMN, pastaj thithjen e investimeve të huaja për projektet zhvillimore të Kosovës dhe sigurinë e tyre etj.

Nëse instancat politike në luftën e paskrupull për pushtet këtu dalin "autonome", pse të mos jenë autonome edhe në përzgjedhjen e konceptionit të regjistrimit të popullsisë, që pasqyron realitetin etnodemografik dhe shoqëror të Kosovës dhe rjedhimisht interesin madhor të saj.

### **Specifikat e popullatës shqiptare dhe të diasporës së saj**

Një numër shumë i madh i shqiptarëve (qindra mijëra) sot gjendet në botën e jashtme, kryesisht mbi 12 muaj, por shumë prej tyre pa status të rregulluar të qëndrimit, çfarë janë refugjatët, të zhvendosurit, azilantët, punëtorët sezonalë, të punësuarit në "të zezë", studentët dhe kategoritë e tjera që kanë ndonjë mbrojtje të përkohshme e të pasigurt etj., që pritet të riatdhesohen, që është edhe kusht për liberalizimin e vizave; vetëm nga Gjermania pritet të riatdhesohen mbi 12.000 kosovarë. Të dhënat për pjesëtarët e të gjitha këtyre kategorive,

që përkohësisht qëndrojnë në kurbet, duhet të mblidhen gjatë regjistrimit përmes pyetësorit individual dhe jo përmes të ashtuquajturës “listë suplementare” si një mashtrim ordiner dhe hipokrizi që e bëri ESK dhe instancat e caktura qeveritare, përfshirë veçanërisht Komisionin Qendror të Regjistrimit (KQR). Bashkatdhetarët e numëruar përmes kësaj liste nuk hynë në numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës. Në anën tjetër, meqenëse bëhet fjalë për një mashtrim, atëherë as kjo listë nuk do të jetë as përafërsisht e plotë dhe funksionale, prandaj edhe nuk u kumtua asnjë e dhënë nga kjo listë në rezultatet e para. Mbetet për t’u parë kur të jepen të dhënat në rezultatet përfundimtare, kur pritet të dalin vetëm disa dhjetra mijëra kosovarë në botën e jashtme, e jo qindra mijëra sa realisht edhe janë.

Sipas kriterit të propozuar se “personat që në momentin kritik të regjistrimit mungojnë mbi 12 muaj nuk përfshihen në regjistrim”, studentët kosovarë që studiojnë jashtë kufijëve shtetërorë, ku studimet e tyre zgjasin të paktën dy vjet rrezikohen të mos përfshihen fare në regjistrimin e përgjithshëm në Kosovë. Studentët dhe kategoritë tjera që i përmendëm (azilantët, të zhvendosurit, refugjatët, punëtorët sezonalë, të punësuarit në “të zezë” etj.) në asnjë mënyrë nuk regjistrohen si popullsi e përhershme në asnjë shtet, as në vendet ku qëndrojnë dhe jetojnë. Pra as në Kosovë e as në vendet imigruese! Fundja, ne na intereson përfshirja e tyre në Kosovë e jo në vendet imigruese; shërbimet e ndryshme të këtyre vendeve edhe i posedojnë të dhënat. Pas shpalljes së rezultateve të para të regjistrimit, kur u pa qartë se operacioni kishte dështuar, kryetari i Komisionit Qendror të Regjistrimit, një spekulant, në një bisedë televizive në RTK deklaroi se “vendet imigruese pasi t’i regjistrojnë shqiptarët do të na i dërgojnë të dhënat, të cilat pastaj ne do t’i fusim në numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës”! Kjo deklaratë nuk ka dyshim se është në anën tjetër të arsyës.

Sjelljet e papërgjegjshme ndaj mërgatës deri në stadin më bizar i shfaqti edhe ministrja e atëhershme e Ministrisë së Administratës Publike, znj. Edita Tahiri, e cila, në përballje me gazetarët rreth përfshirjes së diasporës në regjistrim, në fund të qershorit të vitit 2010 në mënyrën më cinike thoshte se bashkatdhetarët tanë në botën e jashtme mund ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre për t’u regjistruar, por duhet “vetë të vijnë në shtetin e tyre dhe të regjistrohen gjatë periudhës sa do të zgjasë procesi (!). Kjo, në një anë, flet për një absurd dhe, në anën tjetër, për mosnjohjen totale të çështjes.

Regjistrimi i popullsisë nuk është si operacioni i votimit në procesin zgjedhor: në regjistrim nuk është e domosdoshme prania e personit në vendbanimin e perhershëm sikurse në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, ku personi mbi 18 vjet duhet vetë ta hedhë votën, duke prezantuar dokumentin e identifikimit. Një ish-ministre tjetër zhurmëmadhe e këtij dikasteri në vitet 2005-2007, tash, në regjistrimin e vitit 2011, e ngriti zërin kundër krejt asaj që vetë e kishte shkaktuar; ajo i kishte shkatërruar të gjitha bërthamat profesionale, organizative dhe menaxhuese të Entit Statistikor të Kosovës dhe tërë organizimin e operacionit të regjistrimit në ato vite, duke përfutur me klanin e saj materialisht nga dy regjistrimet e dështuara provuese (2005, 2006) dhe duke shëtitur gjithë botën në emër të regjistrimit.

Tash po fillon riadhesimi i një numri jo të vogël të bashkatdhetarëve. Ministri ynë i brendshëm nënshkroi marrëveshje këto ditë me vendet e Beneluksit për t'i kthyer njerëzit tanë nga këto vende, të cilët nuk janë pjesë e popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës, sepse në regjistrim nuk ishin të përfshirë. Nesër do të nënshkruajë marrëveshje me vendet e tjera, p.sh. me Gjermaninë, Zvicrrën, ku kemi shumë kosovarë. Të dhënat duhet t'i ofrojnë familjarët, të afërmit dhe fqinjët e tyre në Kosovë. Në anën tjetër, pse u themeluan bërthamat diplomatike e konzulare? Për ta afirmuar Kosovën dhe për t'i mbrojtur të drejtat dhe interesat e bashkatdhetarëve, përfshirë dhe të drejtën për t'u regjistruar, për të votuar etj.

Një specifikë e veçantë te popullata shqiptare kudo që gjendet është lidhja e fuqishme emocionale e saj për truallin gjeoetnik, për pronën e paluajtshme, për shtëpinë, tokën, farefisin dhe të afërmit. Bashkatdhetarët tanë, në forma të ndryshme, në vit sjellin miliona euro në Kosovë, në vendlindjet e tyre, duke investuar në ndërtimin e shtëpive, në bujqësi, në biznese të ndryshme, i ndihmojnë familjarët dhe të afërmit e tyre me të holla dhe në mënyra të tjera. Për këto arsye ekzistojnë supozimet objektive që një numër i konsiderueshëm i punëtorëve “përkohësisht” të punësuar që nga fillimi i viteve të 70-ta të shek. XX në vendet evropiane do të kthehet në vendin e lindjes, përkatësisht në vendin e perhershëm të banimit pasi ta përfundojnë karrierën e punës dhe të pensionohen. Këta edhe janë tashmë në përfundim të kësaj karriere.

Në fillim të viteve të 70-ta, bashkatdhetarët tanë në botën e jashtme, veçanërisht në Evropë cilësoheshin zyrtarisht si kategori

”punëtorë përkohësisht të punësuar në botën e jashtme”, më vonë si ”qytetarë me qëndrim të përkohshëm në botën e jashtme”, nga vitet e 90-ta si diasporë apo edhe si mërgatë, ndërsa pas luftës si ”qytetarë jorezidentë”! Rreth konceptimit të këtyre kategorive ka dallime. Ende mbetet dilemë e hapur a mund të konsiderohen bashkatdhetarët tanë në Evropë si diasporë në kuptimin e plotë të fjalës, me shumë specifika, që nuk është shkëputur nga trualli gjeoetnik (ende mban kontakte të rregullta fizike me vendlindjen, me një pjesë të familjeve, me pronën e paluajtshme që ruan, me investimet që bën në vendlindje etj., që është një argument i fuqishëm pse shqiptarët në botën e jashtme duhet të përfshihen në regjistrim), siç ka ndodhur me shumë popuj të tjerë dhe me bashkatdhetarët tanë të shpërngulur në periudhat e hershme. Por kjo është temë për një debat tjetër.

Në këtë kompleks të ndërlikuar të rrethanave tona, konceptioni më i pranueshëm edhe për disa vjet është *konceptioni i popullsisë së përhershme* apo *popullsisë rezidente (population résidente)*, që do të thotë se të gjithë banorët e Kosovës që deklarojnë se në momentin e regjistrimit gjenden jashtë Kosovës, në shtetet e tjera dhe kanë status të ndryshëm qëndrimi duhet të konsiderohen popullsi e përhershme apo rezidente në Kosovë. Ky kriter duhet të jetë unik për të gjithë personat, pa marrë parasysh përkatësinë etnike. Në favor të kriterit “Popullsi rezidente”, shtetasit e Kosovës që jetojnë jashtë kufijve shtetërorë, pa marrë parasysh vitet e qëndrimit, kanë të drejtë të pajisen dhe me dokumentacion të shtetësisë së Kosovës (letërnjoftime, pasaporta) dhe të marrin pjesë në zgjedhjet e të gjitha niveleve në Kosovë.

Kur jemi te diaspora, nuk mund të mos theksohet fakti se diaspora shqiptare e Kosovës dhe e gjithë trungut gjeoetnik shqiptar ishte ajo që çau bllokadën diplomatike e mediatike dhe punoi fuqimisht në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, në ofrimin e ndihmave financiare për shqiptarët e përvuajtur dhe në mbështetjen e luftës tonë të armatosur. Pas çlirimit dhe pas ngritjes së institucioneve tona, diaspora jonë mjerisht sikur mbeti nën mëshirën e vetvetes: ndonjë vizitë të rrallë që i bëjnë liderët politikë janë më tepër në funksion të promovimeve të tyre dhe përfitimeve partiake-politike e financiare. Një bërthamë për diasporën (Departamenti për Çështje Jorezidente) në kuadër të Ministrisë së Kulturës të Qeverisë së Kosovës dhe pastaj brenda vetë kryeministrisë ishte për disa vite vetëm një dekor e asgjë më tepër. Kjo bërthamë dhe instancat e tjera kosovare nuk bënë gjë as për përfshirjen e shqiptarëve në regjistrimin civil dhe votues në

Kosovë, ku vetëm në Evropë mbetën jashtë procesit votues qinda mijëra shqiptarë, sikundër që e injoruan plotësisht përfshirjen e shqiptarëve në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë në mars të vitit 2011, përfshirë edhe kategoritë që nuk e kanë të rregulluar statusin e qëndrimit në vendet e huaja, që pritet të riatdhesohen, siç vumë në pah më parë. Nga zgjedhjet parlamentare të 12 dhjetorit 2010 doli një Qeveri, kur për herë të parë në qershor të vitit 2011 u formua Ministria e Diasporës! Mirëpo kjo ministri nuk u formua për t'u marrë njëmend me diasporën dhe për t'i zgjidhur problemet e saj, por për pazare politike, në kushtëzimet dhe kombinatorikat e koalicioneve për formimin e Qeverisë së re!

### **Pasojat e dështimit të operacionit**

Rezultatet e para që dolën nga regjistrimi i prillit 2011, të konceptuar dhe të realizuar keq, do të shtrembërojnë gjendjen në shumë indikatorë të zhvillimit shoqëror mbi të cilën bazë duhet të bëhet revidimi i një varg çështjesh të rëndësishme në shumë fusha, çfarë janë politikat e planifikimit hapësinor, urban dhe shoqëror, buxheti dhe BPV/GDP, shkalla e varfërisë, kontingjentet e punës dhe norma e papunësisë, raportet dhe çështjet kyçe politike, hulumtimet shkencore etj. Por shumë më keq për Kosovën dhe shqiptarët është lëndimi i anës cilësore të regjistrimit. Sa do të pësojë Kosova si tërësi, edhe më tepër do të dëmtohen njësitë më të vogla territoriale-administrative, çfarë janë komunitat, kryeqendra Prishtina dhe gjashtë qendrat tjera mezorajonale dhe selitë komunale të cilat financohen nga buxheti i Kosovës, por sipas numrit të banorëve. Nëse të dhënat e tilla as kuantitativisht e as kualitativisht nuk janë të vlefshme për ata që u destinohen, atëherë kujt do t'i shërbejnë ato?!

Ky regjistrim do të sjellë dëme të mëdha dhe në rrafshin politik, çfarë janë krijimi i dhunshëm i dimensionit multietnik të Kosovës, ku do të del një çelës i ri i zgjidhjes së raporteve politike në dëm të shqiptarëve! Edhe me regjistrimin e popullsisë, shtyerjen dhe mosmenaxhimin e tij në veri të Kosovës, kjo Qeveri e hapi rrugën legale për ndarjen e Kosovës dhe rrjedhimisht për krijimin e një entiteti të veçantë territorial-etnik për serbët në veri të Republikës.

Çfarë është logjika që në listat e votuesve (1.630.636 votues në zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010 ndaj absurdit që Kosova ka rreth 1.733.872 banorë, kur dihet se rreth 45% e popullatës i përket

kontingjentit votues, mbi 18 vjet) të figurojnë emrat e njerëzve në diasporë, ndërsa ata të mos përfshihen në regjistrim dhe të mos u mundësohet që të hedhin votën e tyre legjitime në Kosovë?! Në këtë numër të përgjithshëm prej 1.733.872 banorëve nuk mund të ketë më shumë se 800.000 votues, ose sipas këtij numri të votuesve ajo duhet t'i ketë së paku 3.100.000 banorë. Këto janë absurde, sikundër që është e pakuptueshme që në shumë komuna numri i votuesve të jetë sa numri i banorëve! Qeveria duhet t'u jep shpjegime qytetarëve të Kosovës si dhe pse ndodhi kjo, sepse përmes kontingjentit kontestues votues prej 1.630.636 vetave ka ardhur në pushtet dhe po e drejton Kosovën!

Ose, siç theksuam që në fillim, si të kuptohet fakti se Enti Statistikor i ish-Federats Jugosllave në vitin 1991 e vlerësoi numrin e popullsisë së Kosovës në 1.956.196 banorë, që për ekspertët e statistikës dhe demografët e Kosovës ishte i pranueshëm. Për periudhën 1991-2000 shtimi natyror i evidencuar në Kosovë, sipas statistikës zyrtare serbe mesatarisht në vit ishte rreth 38.000 veta, që do të thotë për 10 vjet janë shtuar rreth 380.000 banorë, dhe në periudhën 2001-2011 ky shtim, sipas statistikave të Kosovës, është mesatarisht në vit rreth 28.000 veta, me gjithë defektet në dëm të gjendjes reale (që në statistikën demografike njihet si nënregjistrim), që nënkupton se për këtë periudhë kemi pasur një shtim natyror përreth 280.000 veta. Kur të kalkuloohen këto shifra, çfarë rezultati del është e qartë për çdokend në Kosovë.

Regjistrimi i popullsisë në veri të Kosovës dhe numri i banorëve që do të dilte atje, nëse do të mbahej operacioni, nuk e ndërron shumë gjendjen në totalin demografik të Kosovës, të bërë të ditur në shpalljen e rezultateve të para nga ESK dhe KQR. Sepse, sipas regjistrimit të vitit 1991 tri komunat (Leposaviqi, Zveçani dhe Z. Potoku) kishin 34.884 banorë, ndërsa komuna e Mitrovicës kishte 104.855 banorë, ku rreth 26.000 banorë ose rreth  $\frac{1}{4}$  ishin serbë, sot jashtë procesit të regjistrimit. Pra numri i banorëve në këto katër komuna sot mund të jetë jo më shumë se 60.000 banorë. Nga statistikat vitale shihet se shtimi natyror i serbëve për këto vite në këto hapësira është stagnant ose shumë pak mbi të. Edhe Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI) para pak kohe ka dhënë shifrën se në Kosovë jetojnë rreth 130.000 serbë, prej të cilëve rreth 75.000 në pjesën në jug të lumit Ibër, ndërsa afër 55.000 në veri të tij. Numri prej 55.000 banorëve dhe numri prej 1.733.872 banorëve përbëjnë totalin prej 1.788.753 banorëve të Kosovës. Shifra prej 1.733.872 banorëve, zyrtarisht e shpallur, dhe

shifra prej 1.788.753 është e njëjta gjë, që tumir faktin se regjistrimi kuantitativisht është i dështuar. As rezultatet definitive që do të shpallen pas një viti nuk mund ta ndërrojnë fare situatën.

Pas refuzimit të serbëve të veriut të Kosovës që të dilnin në regjistrimin e marsit 2011, në shtator të këtij viti instancat statistikore dhe qeveritare të Kosovës paralajmëruan një improvizim dhe gënjeshtër tjetër: nxjerrjen e të dhënave për këtë pjesë të Kosovës nga një "anketë" e vitit 2009 që e kishte realizuar Enti Statistikor i Kosovës! Po të ishte kjo punë kaq e lehtë, pse atëherë nuk vepruan kështu edhe me krejt Kosovën? Pa harxhimin e 12 milion eurove, të kryhej regjistrimi në tërë Kosovën!

### **Çështja e riatdhesimit dhe regjistrimi i serbëve**

Ministri ynë i brendshëm këto ditë nënshkroi një marrëveshje me vendet e Beneluksit për t'i kthyer njerëzit tanë nga këto vende, të cilët nuk janë pjesë e popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës, sepse në regjistrim nuk ishin përfshirë. Nesër do të nënshkruajë marrëveshje me vendet e tjera, p.sh. me Gjermaninë, Zvicrën, ku kemi shumë kosovarë. Qeveritarët tanë këto ditë po bisedojnë me udhëheqjet komunale për t'i riatdhesuar qytetarët e Kosovës që gjenden në kurbet, të cilët gjithashtu mbetën jashtë numrit preliminar prej 1.733.872 banorëve! Ky regjistrim ishte aq i komplikuar sa që një numër i personave, veçanërisht të kombësisë shqiptare, për shkak të ridistributimit të madh të popullatës dhe migrimeve fshat-qytet (shtëpitë e djegura, zonat e minuara, uzurpimet etj.), edhe brenda Kosovës një numër i njerëzve ka mbetur i papërfshirë në operacion, sikundër që personat me dy vende të banimit (edhe në fshat, edhe në qytet) kanë mund të përfshihen dy herë, gjë që e shtrembëron gjendjen demografike në vendbanime dhe komuna dhe rrjedhimisht sjell probleme edhe në planifikimin hapësinor e edhe social në këto njësi.

Dalja e serbëve të Kosovës në regjistrim mbetet çështje e hapur dhe komplekse. Pjesa më e madhe e tyre as sot e gjithë ditën nuk i pranojnë institucionet qendrore të Kosovës, pra as sistemin e statistikave vitale dhe shoqërore. Në anën tjetër që nga viti 2005 ekziston plani i UNMIK-ut për formimin e qendrave të posaçme në Serbi dhe në Mal të Zi, që do ta organizonin regjistrimin e serbëve të Kosovës kurdo që ai të mbahej sipas konceptonit të popullsisë rezidente, që nënkupton përfshirjen e të gjithë serbëve që janë shpërngulur nga Kosova në Serbi e Mal të Zi që nga viti 1999 dhe më herët. Edhe me Planin e Ahtisarit, që është pjesë përbërëse e

sistemit tonë juridiko-politik, është paraparë që serbët të regjistrohen nën mbikëqyrjen e një komisioni të veçantë ndërkombëtar, ku Kosova nuk do të ketë asnjë qasje.

Sipas Planit të M. Ahtisarit, serbët e Kosovës kanë një diskriminim të paparë pozitiv dhe në përmasa botërore, ku, siç tha zëvendëskryenegociatori i M. Ahtisarit, Albert Rohan më 27 gusht 2010, “nuk ka shtet në botë ku pakica ka autonomi më të fortë se serbët e Kosovës. Nuk shoh asnjë arsye që veriut t’i jepet më shumë, përkundrazi të gjitha përpjekjet duhet të drejtohen për integrimin e kësaj pjese në sistemin e Kosovës”. Megjithë këtë favor, ata nuk pranuan t’i përgjigjeshin operacionit të regjistrimeve testuese (2005, 2006 dhe 2009), ndërsa faktori ndërkombëtar nuk ushtroi asnjë presion mbi Beogradin dhe mbi serbët e Kosovës që të dilnin në regjistrimin e prillit 2011, sikundër edhe në shumë çështje të tjera.

Serbia kishte planifikuar ta mbante regjistrimin e popullsisë në prill të vitit 2011, por pastaj ka vendosur ta shtyjë për tetor të këtij viti. Të gjitha supozimet flasin se shtyrja është bërë për shkak të serbëve të Kosovës. Përmes të ashtuquajtur “listë suplementare”, me një mjeshteri tinzare tentohet që të përfshihen në regjistrim serbët e shpërngulur nga Kosova pas çlirimit të saj në qershor të vitit 1999, pra para 12 vjetëve, përfshirë edhe ata të cilët tashmë i kanë shitur pronat e tyre në Kosovë dhe definitivisht e kanë braktisur atë. Edhe në çështjen e operacionit të regjistrimit si duket Beogradi do të jetë ai që do të vendosë a do të pranojnë serbët e Kosovës të regjistrohen apo jo. Për regjistrimin në Kosovë Serbia zyrtare e ka ngarkuar të ashtuquajturën “Ministri për Kosovë dhe Metohi”. Zyrtari i kësaj ministrie Oliver Ivanoviq thotë se “serbët nuk duhet të dalin në regjistrim, për dalje apo jo vendos Beogradi”. Ndërkaq shefi i ICO-së Pieter Feith më 28. 4. 2010 tha se “regjistrimi është një çështje që do të kërkojë bashkëpunim me Beogradin”, ndërsa serbët e Kosovës janë të instrumentalizuar nga Beogradi zyrtar. Operacioni në Serbi do të jetë plotësisht jashtë kontrollit dhe pa asnjë qasje të institucioneve përkatëse të Kosovës. Atje do të regjistrohen aq serbë sa dëshiron pushteti zyrtar i Beogradit. Operacionit sigurisht do t’i përgjigjen edhe serbët e Kosovës. Prandaj mundësitë e manipulimeve me numrin e serbëve të Kosovës mbesin të mëdha, gjë që do të dihet pas regjistrimit të popullsisë në Serbi, pra dhe në veri të Kosovës, por edhe në brendi të saj në fund të vjeshtës së këtij viti.



Dr. Frashër Demaj

## POZITA E SHKENCËS NË KOSOVËN E PAVARUR

Pozita e shkencës në Kosovë është e lidhur ngushtë me zhvillimet e gjithëmbarshme, posaçërisht me faktorët siç janë zhvillimi ekonomik, politik, arsimor, kulturor dhe social në përgjithësi. Këta faktorë janë të determinuar nga situata brenda Kosovës dhe nga komunikimet ndërkombëtare, meqë vendi ynë duke qenë shtet i ri, ende nuk është pjesë përbërëse e shumë forumeve ndërkombëtare, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të Republikës së Kosovës.

Dija absorbuese dhe kapacitetet teknologjike në Kosovë janë ndjeshëm të kufizuara, si në numër, ashtu edhe në shtrirje dhe në cilësi. Arsye për këtë deficit është mungesa e financimit të veprimtarive kërkimore dhe të zhvillimit teknologjik (KZHT) për të paktën 20 vjetët e fundit. Pa një financim të mjaftueshëm të KZHT-së, nuk mund të thuhet se kapacitetet përthithëse të mundshme në ekonomi dhe në komunitetin akademik në Kosovë shfrytëzohen në nivel të kënaqshëm dhe as që janë në gjendje për të përballuar me sukses progresin teknologjik<sup>1</sup>.

Puna kërkimore shkencore në Kosovë si kurrë më parë është sa e nevojshme, aq edhe e domosdoshme në mënyrë që institucionet tona të jenë në hap me zhvillimet më të reja në fushën e hulumtimit dhe prezantimit të të arriturave shkencore në vend dhe në botë. Shkenca do të duhej të jetë prioritet i të gjitha subjekteve relevante shtetërore, shkencore e profesionale në mënyrë që të jep kontributin e duhur në zhvillimin ekonomik e social dhe në afirmimin e vlerave tona shtetërore e kombëtare.

Puna kërkimore-shkencore dhe zhvillimi teknologjik është edhe më tej një mundësi e kufizuar në Kosovë. Ende nuk ekziston një sistem funksional i orientuar dhe produktiv për aq sa kërkohet dhe sa është e nevojshme. Një nga arsytet e këtij niveli të zhvillimit të shkencës në Kosovë ishte dëbimi i komunitetit akademik dhe i kërkimit shkencor në periudhën e viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, kur personeli akademik jo vetëm që ishte i izoluar dhe me mundësi shumë të kufizuara për kontakte me zhvillimet shkencore

---

<sup>1</sup> Programi kombëtar i Shkencës, mars 2010, Prishtinë, f. 5.

ndërkombëtare<sup>2</sup>, por ishte edhe i persekutuar dhe në të shumtën e rasteve ndiqej edhe penalisht nga organet e instaluara të pushtetit serb. Faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar në ngecjen e zhvillimit të hulumtimeve dhe kërkimeve në shkencën kosovare janë edhe dëmet materiale dhe jomateriale të shkatërruara gjatë luftës, që natyrisht nënkupton edhe një proces të vështirë të ngritjes infrastrukture dhe kadrovike në ditët tona.

Sot Kosova si shteti më i ri me njohje ndërkombëtare po bën hapa të rëndësishëm (edhe pse të pamjaftueshëm) në ngritjen, zhvillimin dhe konsolidimin e kapaciteteve shkencore në të gjitha fushat e dijes. Mirëpo trajtimi i shkencës nga institucionet e shtetit lë për të dëshiruar, meqë institucionet përkatëse që janë përgjegjëse për shkencën tash e 12 vjet, përkatësisht tashmë kur Republika e Kosovës ka mbushur 3 vjet të pavarësisë së saj, për arsye të pa kuptueshme, ende nuk e trajtojnë shkencën në përputhje me kohën në të cilën jetojmë dhe të paktën me minimumin e kërkesave normale për të realizuar sadopak objektivat tona në mënyrë që të jemi në hap me vendet e Ballkanit me pretendim ngritjen e cilësisë dhe kapaciteteve për t'u bërë konkurrentë në botën e zhvilluar. Këtë situatë më së miri e pasqyrojnë shifrat financiare të dedikuara për këtë veprimtari. Buxheti i përgjithshëm për kërkime shkencore në Kosovë edhe sot është jashtë çdo norme me vetëm rreth 0.1% dedikuar për shkencë nga Buxheti i Republikës së Kosovës<sup>3</sup>. Kjo përqindje e buxhetit e përkthyer në shifra monetare është ndjeshëm nën mesataren evropiane, madje edhe më poshtë mesatares së shteteve fqinjë në rajon, si dhe të shumë vendeve në zhvillim.

Përveç buxhetit të varfër për shkencën, në ditët tona hulumtimet, studimet dhe kërkimet shkencore në të gjitha fushat e dijes zhvillohen me probleme në shumicën e institucioneve shkencore e arsimore. Në veçanti hetohet mungesa e përfshirjes dhe e shfrytëzimit të potencialeve të gatshme shkencore nga institutet në procesin arsimor, në transmetimin e përvojave dhe dijeve tek studentët, etj.

Universitetet tona publike (i Prishtinës dhe i Prizrenit) "importojnë" kuadro sidomos nga Republika e Maqedonisë, nga Universiteti i Tetovës, i cili për nga eksperiencia dhe cilësia nuk e arrin nivelin e as eksperiencën e Universitetit të Prishtinës. Skandali

<sup>2</sup> 30-vjet të Institutit të Historisë (1967-1997), Prishtinë, 1998, f. 17-18.

<sup>3</sup> Më gjerësisht, shih buxhetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të dedikuar për zhvillimin e shkencës 2010-2011.

thellohet edhe më tepër kur anashkalohen kapacitetet shkencore të vendit të profileve dhe fushave të njëjta të studimit dhe angazhimi "part time" i mësimdhënësve bëhet nga dekanët dhe strukturat tjera drejtuese të UP jashtë çdo kriteri, duke e shndërruar kështu mësimdhënien dhe cilësinë e studimeve në "biznes të egër" për interesa krejt të ngushta individuale, grupore e klanore. Ky instalim i antivlerave dëmton rëndë të tashmen dhe të ardhmen e studimeve dhe të shkencës kosovare në përgjithësi.

Universitetet publike me degët e veta nëpër Kosovë dhe departamentet e ndryshme po kalojnë ende nëpër një tranzicion që duket i pambarim. Mungesa e punës kërkimore-shkencore në masë të madhe në universitete i shndërron ato në institucione arsimore pa tipare kërkimore-shkencore. Përveç kësaj Universitetet tona publike përballen edhe me fenomene të tjera që diskreditojnë këtë vatër të dijes. Ndër problemet kryesore që duhet trajtuar nga organet përkatëse të shtetit janë edhe mosmbajtja e rregullt e orëve dhe afatet shpeshherë të anuluarat e të stërzgjatura të provimeve, abuzimi i mësimdhënësve me nota, nepotizmi, abuzimi me tituj të masterit dhe doktoraturave. Një fenomen i veçantë është çështja e plagjiaturave, mospërfshirja në procesin mësimor e kadrove shkencore të instituteve, mungesa e bashkëpunimit kërkimor e shkencor brenda vendit, numri enorm i studentëve krahasuar me kapacitetet e Universitetit etj.

Gjithashtu edhe bartësit privat të arsimit të lartë, pavarësisht përpjekjeve të tyre për të ofruar arsim cilësor, nuk janë në nivelin e duhur bazuar në kërkesat e kohës për cilësi e aftësim profesional.

Në ASHAK përveç kushteve fizike, një ndërtesë moderne e cila ofron mundësi studimi, kushtet dhe mundësitë tjera janë shumë të kufizuara dhe problemi kryesor qëndron te ndarja e fondeve për punë hulumtuese e shkencore.

Instituti Albanologjik i akomoduar në një ndërtesë që plotëson kërkesat infrastrukturore, gjithashtu vuan nga mungesa e fondeve për punë kërkimore dhe për botimin e rezultateve shkencore. Në këtë institucion shkencor, për shkak të mungesës së fondeve, shumë dorëshkrime presin në radhë për të parë dritën e botimit. Gjithashtu kapacitetet shkencore të Institutit Albanologjik nuk shfrytëzohen për të transmetuar eksperiencën dhe dijen e tyre në mësimdhënie në Universitetin e Prishtinës<sup>4</sup>.

---

<sup>4</sup> Buxheti i Institutit Albanologjik të Prishtinës për vitin 2010-2011.

Instituti i Historisë ka mbetur i harruar nga shteti, meqë nuk ka kushte as fizike për punë normale kërkimore-shkencore. Problemi kryesor me të cilin përballet ky institucion është zhagitja jashtë çdo norme e kryerjes së punëve në ndërtesën e Institutit të Historisë dhe tendenca për ta tjetërsuar atë. Gjithashtu, Instituti i Historisë përballet me mungesë të pazakontë të mjeteve financiare që i nevojiten për hulumtime shkencore dhe për botimin e rezultateve shkencore<sup>5</sup>. Madje shteti ynë nuk e ka pa të udhës, të paktën deri më sot që ta financojë makroprojektin "Historia e Kosovës", që është një projekt ndër më me prioritet dhe më i rëndësishëm për afirmimin e vlerave historike e kulturore të vendit tonë.

Afërsisht në të njëjtën situatë gjenden edhe institucione tjera të shkencave natyrore, shkencave të inxhinierisë dhe teknologjisë, shkencave të mjekësisë, shkencave bujqësore, shkencave shoqërore dhe shkencave humane<sup>6</sup>.

Në një situatë të disfavorshme janë edhe revistat shkencore, të cilat janë një bazë e mirë e publikimit të rezultateve shkencore, prandaj ato duhet të përkrahen, të përsosen e t'i prezantohen opinionit të gjerë vendas dhe ndërkombëtar dhe të krijohen mundësi që revistat shkencore ("Kosova", "Gjurmime Albanologjike", "Kërkime" etj.) të Republikës së Kosovës të jenë konkurrenca me revistat shkencore me ISSN ndërkombëtare.

Pavarësisht të gjitha vështirësive, institucionet shkencore do të mundohen të zgjerojnë këndvështrimin e studimeve në fushat më të rëndësishme bashkëkohore, politike, diplomatike, shoqërore, teknologjike, ekonomike, kulturore, arsimore etj. Përkrahja financiare nga institucionet e shtetit dhe qasja në projekte ndërkombëtare janë mundësia e vetme për ta nxjerrë vendin nga kjo situatë joproduktive dhe jokonkurrense në raport me zhvillimet shkencore ndërkombëtare.

Andaj, duke u mbështetur në përvojat e deritashme të institucioneve kërkimore-shkencore dhe nevojave që ato kanë për status dhe një trajtim më të denjë institucional, e konsiderojmë të nevojshme që sot nga ky kollokuim të nxirren disa përfundime:

<sup>5</sup> Buxheti i Institutit të Historisë - Prishtinë për vitin 2010-2011.

<sup>6</sup> Ndarja dhe kategorizimi i shkencave sipas Manualit të Frascatit.

1. Rishqyrtimi i infrastrukturës ligjore për të krijuar bazë më të mirë në trajtimin e punës dhe nstitucioneve kërkimore-shkencore<sup>7</sup>.
2. Hartimi i strategjive e politikave për zhvillimin e arsimit të lartë me objektiva specifike, të realizueshme, të matshme dhe strategjike për përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulave dhe të cilësisë së tyre në bazë të legjislacionit dhe standardeve në fuqi në vendet e BE-së, si dhe në përputhje me Kartën e Bolonjës.
3. Modernizimi i infrastrukturës fizike për të gjitha institucionet kërkimore-shkencore (përfshirë këtu objektet, aparaturën, laboratorët, etj.)
4. Sigurimi i fondeve të nevojshme financiare për përgatitjen e kuadrit të ri shkencor për studime të masterit, të doktoraturës dhe të studimeve postdoktorature.
5. Sigurimi i buxhetit për punë kërkimore-shkencore për hulumtime arkivore, për organizimin e aktiviteteve shkencore, për veprimtarinë botuese dhe për nevoja të tjera të kësaj natyre.
6. Promovimi i programeve të ndryshme kërkimore-shkencore nën ombrellën e BE-së, si dhe mbajtja e lidhjeve të vazhdueshme me njësitë bazë që mbulojnë këto programe nëpër universitete dhe institute shkencore.
7. Asistimi në gjetjen e donacioneve dhe konkurrimi në projekte ndërkombëtare etj.

Këto dhe kërkesa të tjera të gjejnë zërin e arsyes dhe përkrahjen e institucioneve të Republikës së Kosovës në mënyrë që shkencën kosovare të jetë konkurrenente me zhvillimet e gjithëmbarshme në botë. Mbetet detyrë prioritare e institucioneve shtetërore dhe e atyre arsimore e kërkimore-shkencore qofshin publik apo privat që kapacitetet e tyre t'i ofrojnë në shërbim të krijimit të kushteve dhe thellimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore për ta avancuar shkencën e Kosovës në rang ndërkombëtar.

---

<sup>7</sup> Prof. dr. Jusuf Bajraktari, *Gjendja aktuale, perspektiva e studimeve dhe hulumtimeve historiografike në Kosovë, kumtesë e mbajtur në "Java e Shkencës", Prishtinë, 6.5.2009, f. 4.*



Prof. dr. Bejtush Gashi dhe Agron Jusufi

## KONCEPTET POLITIKE TË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË SIGURISË SË KOSOVËS

### Përmbajtje e shkurtër

Në shekullin XXI siguria më nuk identifikohet me fuqinë ushtarake, ndërsa përdorimi i forcës më nuk është monopol i shtetit. Sfidat klasike janë zëvendësuar me sfida të ndryshme, të cilat para së gjithash, nuk janë të lidhura për forcën klasike ushtarake dhe atributet e saj.

Kosova mbështet konceptin e ri të politikës së sigurisë, i cili nënkupton bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në nivel ndërkombëtar. Theksi i veçantë vendoset në faktin se sistemi bashkëkohor i sigurisë nuk ndikohet vetëm nga sfidat “tradicionale” që janë me ndikim të drejtpërdrejtë (akut), por edhe atyre “jo-tradicionale”, me ndikim të tërthortë (të vonuar). Gjithashtu, koncepti i sigurisë duhet të trajtojë në mënyrë të barabartë **sigurinë shtetërore** dhe **sigurinë shoqërore**, si përbërës të pandashëm të sigurisë kombëtare. Mirëpo për të përmbushur këtë synim në këtë fazë, Kosovës i mungon përcaktimi i qartë i mjedisit të sigurisë, ndërsa politika e sigurisë mbështetet në aftësinë /mbështetjen/ e KFOR-it dhe EULEX-it. Për krijimin e kësaj gjendjeje ndikim të madh kanë pasur aktivitetet e grupeve kriminale të të gjitha llojeve të sponsorizuara nga Serbia, të cilat kanë penguar dhe po i pengojnë institucionet kosovare të sigurisë që të ushtrjnë sovranitetin në tërë territorin e Kosovës.

Bashkëpunimi rajonal për të krijuar një frymë dhe një rend të ri nëpërmjet dialogut, bashkëpunimit e mirëbesimit është objektiv i sigurisë në planin afatshkurtër dhe afatgjatë. Në themel të këtij vizioni strategjik qëndron pranimi i shtetit të Kosovës nga ana e shteteve fqinje dhe kthimit të saj në faktor sigurie e stabiliteti në Evropën Juglindore.

*Fjalët kyçe: siguria, siguria shtetërore, siguria shoqërore, siguria kombëtare, siguria kolektive, siguria njerëzore, ekonomia e sigurisë, shtetndërtimi, korrupsioni, trafikimi me qenie njerëzore, trafikimi m,e materie të ndaluara.*

## Hyrje

Që nga themelimi, Instituti për Studime të Sigurisë dhe Integriteteve “Katana” ka insistuar në një koncept “ndryshe” për sigurinë e Kosovës. Këtë koncept, ISSI “Katana” e ka shtjelluar në disa raporte, publikime dhe konferenca, duke trajtuar probleme dhe sfida “organike” e “funktionale”, të cilat drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë ndikim të thellë në sigurinë e përgjithshme të vendit. Vetëm pak kohë para shpalljes së pavarësisë në Kuvendin e Kosovës, ISSI “Katana” ka publikuar një raport të shkurtër të titulluar “Sfidat e sigurisë pas shpalljes së pavarësisë”<sup>1</sup>. Në këtë raport është theksuar se procesi drejt pavarësisë është i pakthyeshëm, por gjithashtu është theksuar se institucionet vendore do të ballafaqohen me një sërë sfidash në ndërtimin e sistemit të mirëfilltë të sigurisë. Në këtë artikull, autorët vërtetojnë se gati tri vite e gjysmë pas shpalljes së pavarësisë dhe pikërisht në ditët e festimit të përvjetorit të 12 të çlirimit të vendit, “koncepti bashkëkohor” i sigurisë është projekt ende i pafilluar. Ndonëse pas shpalljes së pavarësisë janë bërë hapa të mëdhenj në këtë drejtim,<sup>2</sup> shtetit më të ri në botë ende i mungojnë dokumentet strategjike mbi sigurinë, sikundër i mungojnë edhe mekanizmat e participimit të institucioneve të ndryshme në rritjen e kapitalit të sigurisë.

Ky koncept i sigurisë, të cilin duhet ta ndërtojnë institucionet e vendit duhet të trajtojë krahas, si sigurinë shtetërore – kërcënimet ndaj sovranitetit, ashtu edhe sigurinë shoqërore (sociale) – kërcënimet ndaj identitetit të shoqërisë.<sup>3</sup>

## Koncepti bashkëkohor i sigurisë

Përkufizimi i nocionit të sigurisë ka ndryshuar thellësisht në përpjekje për të përfshirë të gjithë faktorët të cilët kanë kapacitet në përdorimin e forcës apo ushtrimin e dhunës përtej faktorëve tradicionalë (forca ushtarake, marrëdhëniet ndërkombëtare, etj., që në

<sup>1</sup> **Sfidat e sigurisë pas shpalljes së pavarësisë**, Grup autorësh, *Instituti për Studime të Sigurisë dhe Integriteteve “Katana”*, Prishtinë, shkurt (2008).

<sup>2</sup> Agjencia e Inteligjencës së Kosovës; Forca e Sigurisë së Kosovës; Ligji për Armë, etj.

<sup>3</sup> WAEVER Ole, BUZAN Berry, KELSTRUP Moretn dhe LEMAITRE Pierre: **Identity, Migration and the New Security Agenda** (1993).

masë të madhe përcaktojnë sigurinë shtetërore), duke zgjeruar kuptimin e viktimës për të përfshirë jo vetëm shtetin dhe sigurinë fizike të shtetit dhe të individit, por edhe ambientin ku zhvillohen veprimet e dhunës (nga ajo familjare, deri tek arena e veprimeve ushtarake në shkallë të gjerë), si dhe duke zgjeruar kuptimin e sigurisë për të përfshirë edhe lirinë e lëvizjes, lirinë nga sëmundjet, nga uria, nga represioni, etj.<sup>4</sup> Këta faktorë të rinj nuk mund të trajtohen përmes konceptit “tradicional” të sigurisë shtetërore, por, përmes konceptit të ri, që sigurinë shoqërore (sociale), nuk e trajton vetëm si element të sigurisë shtetërore, por edhe si objekt referues më vete i sigurisë.<sup>5</sup>

Siguria është parakushti themelor i ekzistencës dhe zhvillimit të njeriut dhe shoqërisë, ndërsa kuptimi dhe hulumtimi shkencor i saj përqendrohet në shtetin dhe në sistemin e politikës ndërkombëtare si sistem i shteteve. Në nivelin e tashëm të zhvillimit shoqëror, politika e sigurisë është e organizuar përmes sistemit të sigurisë, i cili analizon mundësitë e shkallës së organizimit për të kryer funksionin e sigurisë në shoqërinë bashkëkohore. Ajo është pjesë e politikës së përgjithshme shtetërore dhe realizohet si tërësi e qëllimeve të sigurisë kombëtare. Kjo nënkupton se për formulimin dhe zhvillimin e konceptit të sigurisë shteti duhet të merr parasysh si faktorët e jashtëm, ashtu edhe ata të brendshëm; si faktorët tradicionalë të sigurisë, ashtu edhe faktorët jotradicionalë.

Koncepti bashkëkohor i sigurisë është shtruar në forma të ndryshme nga disa autorë. Përkufizimet bashkëkohore, sidomos ato pas luftës së ftohtë sigurinë e përkufizojnë si nocion shumë më të gjerë dhe të pavarur nga siguria kombëtare.<sup>6</sup>

Gërshetimi i të gjitha këtyre kategorive dhe rrafsheve ka krijuar edhe faktorë të rinj (jotradicionalë) me ndikim në siguri: shoqëria civile dhe mediat, organizatat ndërkombëtare (qeveritare dhe joqeveritare), korporatat e mëdha multinacionale, globalizimi, ambienti, etj. Si rrjedhojë, edhe koncepti i sigurisë të cilin duhet ta ndërtojnë institucionet e Republikës së Kosovës duhet të marrin parasysh ndërveprimin dhe ndërvarësinë ndërmjet të të gjithë këtyre

<sup>4</sup> SACHS Stephen E: **The Changing Definition of Security**, *International Relations, Merton College, Oxford* (2003)  
[http://www.stevesachs.com/papers/paper\\_security.html](http://www.stevesachs.com/papers/paper_security.html)

<sup>5</sup> WAEVER et al (1993)

<sup>6</sup> Për disa definicione bashkëkohore, shih: **Studime bashkëkohore të sigurisë**, faqe 16. Oxford Press University; redaktuar nga Alan Collins (botimi shqip nga UET Press, redaktor Bashkim Gjergji), ISBN: 978-99956-39-14-3.

faktorëve, në ndërkohë që ato po bëhen shumë më të gjera dhe më të mjegjulluara.

Procesi i globalizimit ka krijuar mundësinë e bashkëveprimit në proceset e rendit të ri. Ky fakt reflektohet edhe në politikat e sigurisë së shteteve. Në këtë kuadër është paraqitur në teori dhe praktikë koncepti i ri i sigurisë – koncepti i sigurisë individuale (human security concept), i cili për ndryshim nga koncepti tradicional i sigurisë kombëtare i jep përparësi sigurisë së individit e jo shtetit si entitet. Pra “në sistemin e sigurisë bashkëkohore qytetari është boshti mbi të cilin duhet ndërtuar jo vetëm siguria kombëtare, por edhe ajo regjionale dhe globale<sup>7</sup>. Kjo qasje e re është rezultat i përfshirjes së shumë disiplinave të cilat merren me studimet e marrëdhënieve ndërkombëtare, strategjike, të drejtave të njeriut, të sigurisë, të paqes, etj.

Në këtë kuptim, politika e sigurisë në Kosovë do të duhej të përcaktohet në fusha të ndryshme shtetërore (politikat dhe institucionet e sigurisë, anëtarësimi në organizatat dhe organizmat ndërkombëtar të sigurisë, krijimi i lidhjeve regjionale dhe ndërkufitare për luftimin e krimit të organizuar, etj.) dhe shoqërore (sociale, mirëqenie, politike, ekologjike, shëndetësore, etj.) me qëllim të arritjes së sigurisë së përgjithshme të qytetarëve të saj dhe shtetit në tërësi.

## **Politika e sigurisë**

Në kuptimin e saj të gjerë, politika e sigurisë përkufizohet si veprimtari për arritjen e sigurisë kundrejt burimeve të kërcënimit të ardhshëm në natyrë, në shoqëri dhe ndërmjet shoqërive (shteteve). Në kuptimin e ngushtë, qëllimi i politikës së sigurisë është krijimi i konceptit të mekanizmave dhe të mjeteve me të cilat realizohet siguria e brendshme dhe e jashtme e shoqërisë, gjë që përbën konkretizimin e parimeve politike, tekniko-organizative dhe parimeve të tjera të politikës së sigurisë në kuptimin e gjerë të kësaj fjale. Politikat e sigurisë kombëtare mëtojnë të integrojnë politikat ekonomike, diplomatike dhe ushtarake me qëllim të përballimit të kërcënimeve ndaj interesave nacionale. Megjithatë, në botën “pas luftës së ftohtë”,

<sup>7</sup> Projekti për Raportim mbi Sigurinë Njerëzore, Shkolla për Studime Ndërkombëtare pranë Universitetit Simon Frasier në Vancouver.

<http://www.humansecurityreport.info/content/view/24/59/> dhe enciklopedia digjitale [http://en.wikipedia.org/wiki/Human\\_security](http://en.wikipedia.org/wiki/Human_security)

përqendrimi në çështjet e sigurisë ka bërë të qarta edhe mangësitë e kësaj qasjeje, ngase kërcënimet dhe sidomos rreziqet tashmë janë bërë të paqarta dhe më të “largëta”. Andaj edhe logjika dhe kohezioni i formulimit të këtyre politikave është bërë më pak bindës.

Studimet e ndryshme pohojnë se politikat qeveritare të cilat promovojnë sigurinë “joushtarake” ndikojnë në zhvillimin e vendit; ndërsa politikat e “pasigurisë” (konfliktet ushtarake), padyshim, sjellin shkatërrime dhe ndalim të zhvillimit ekonomik.<sup>8</sup> Kuptimi i kësaj ndërvarësie ka bërë që sfidat e menaxhimit të konflikteve të jenë më të vështira. Rëndësia dhe dominimi i qasjeve “klasike” të sigurisë, si frikësimi, balanci i forcave, siguria kolektive dhe mbrojtja kolektive po sfidohen/zëvendësohen me konceptet e reja të sigurisë së përbashkët, gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese. Institucione globale e regjionale po eksperimentojnë me teknika të reja të trajtimit të konflikteve, siç është diplomacia preventive, paqeruajtja, ndërtimi i paqes dhe intervenimi humanitar, shpesh me rezultate të përziera.<sup>9</sup>

Ideja e iniciativave ndërkombëtare, si p.sh. Pakti i Stabilitetit, nisët nga parimi i krijimit të ndërvarësisë ekonomike “brendaregjionale”. Ky parim paragjykon se liria ekonomike, prosperiteti dhe demokracia e rrënjosur do të sjellin normalitetin në regjion dhe do të mundësojnë integrimin e regjionit. Kjo nga besimi se nëse ekonomitë e vendeve janë në ndërvarësi, qeveritë dhe njerëzit do t’i ikin dhunës, ngase kompanitë dhe qytetarët do të pësonin humbje të thella ekonomike.<sup>10</sup> Përveç miliarda euro të investimeve në infrastrukturën ekonomike dhe institucionale, këto iniciativa i kushtojnë rëndësi të madhe çështjeve të sigurisë, duke e zgjeruar sferën e interesit edhe përtej çështjeve të sigurisë kombëtare: lufta e përbashkët regjionale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, bashkëpunimi në sigurinë kufitare, reformat në sektorin e sigurisë, etj. Në këtë mënyrë çështja e sigurisë kombëtare si thelb i sovranitetit

<sup>8</sup> STEWART Francis: **Development and Security**; *Queen Elisabeth House, University of Oxford, 2004.*

<sup>9</sup> S. Rajaratnam School of International Studies:  
<http://www.ntu.edu.sg/rsis/teaching/MSc.asp#>

<sup>10</sup> STANCHEV Krassen: **Vrojtim në ndërvarësinë ekonomike në Ballkan**, Drejtor Ekzekutiv i Institutit për ekonominë e tregut, Sofje. Ekstrakt nga *Kollokuiumi Ekonomik i NATO-së, Bukuresht, 2-4 maj 2001: Zhvillimet dhe reformat ekonomike në shtetet partnere në bashkëpunim: Lidhja në mes të ekonomisë, sigurisë dhe stabilitetit*, (faqe 73), NATO, Drejtorati për ekonomi dhe zyra për informim dhe publikime, Bruksel

shtetëror gjithnjë e më tepër po kalon në duar të institucioneve ndërkombëtare, duke rritur edhe më tepër ndërvaresinë e ekonomisë dhe sigurisë. Thembra e Akilit në këtë qasje ndaj sigurisë është se shtetet asnjëherë nuk mund të jenë tërësisht të barabarta apo tërësisht të ndërvarura. Nëse një shtet ka ndonjë përparësi strategjike ndaj shteteve tjerë, atëherë ai mund të orvatet të imponojë agjendën e vet në shkallë të caktuar, duke pretenduar sfera të ndryshme të interesit.<sup>11</sup>

Kosova është nën ndikimin e pozitës së saj gjeostrategjike dhe si pasojë edhe nën ndikimin e “lojërave diplomatike” në arenën ndërkombëtare. Ajo është pjesë e një mjedisi gjeostrategjik, që konsiderohet, nga njëra anë, si një mjedis ballkanik me të gjitha problemet historike të trashëguara të këtij rajoni dhe, nga ana tjetër, si një mjedis evropian mbi të cilin SHBA, në veçanti shtetet e Bashkimit Evropian ushtrojnë ndikim pozitiv për stabilitetin, demokratizimin dhe integrimin e saj në te. Pozita gjeografike e Kosovës merr një rëndësi të veçantë në raport me drejtimitet e rrugët që kalojnë nga Europa Veriore e Qendrore drejt Europës Jugore dhe pellgun e Mesdheut. Rajoni i Ballkanit ende ballafaqohet me probleme të cilat burojnë nga e kaluara, institucionet shtetërore në ndërtim dhe zhvillim të dobët ekonomik me shkallë të ulët të punësimit që mund të gjenerojnë kriza dhe të ndikojnë në stabilitetin e rajonit.

Me shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008, Kosova ka definuar orientimet e para strategjike të politikës së jashtme, të cilat kanë determinuar edhe formësimin e politikës së sigurisë, si dhe politikat e tjera, si pjesë përbërëse. Orientimet strategjike të politikës kosovare të sigurisë dhe politikës së jashtme janë: aktivitetet politike dhe diplomatike për rritjen e numrit të shteteve për njohjen ndërkombëtare të Kosovës; roli konstruktiv në politikat dhe organizatat ekonomike ndërkombëtare; angazhimi për rritjen e marrëdhënieve bilaterale me të gjitha shtetet partnere, posaçërisht me shtetet fqinje; aktivitetet politike, kulturore dhe ekonomike në afirmimin e Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare në realizimin e interesave nacionale; shqetësimi për kosovarët në botë, etj. Këto orientime strategjike mund të vërehen qartë në analizën e aktivitetit të

---

<sup>11</sup> Siç bën herë-pas-herë Rusia përmes bllokimit të sistemit të gazpërçuesve drejt Evropës Perëndimore, apo, siç bën aktualisht Serbia ndaj Kosovës duke e imponuar veten si faktor më të rëndësishëm në bisedimet me Kosovën dhe duke i konsideruar këto bisedime si çështje secesioni e jo si bisedime të dy palëve të barabarta.

veprimtarisë së parlamentit, i cili gjatë këtyre tri viteve ka miratuar një numër të konsiderueshëm të ligjeve nga lëmi i sigurisë, si dhe disa dokumente të rëndësishme të orientimeve strategjike.

Politika e sigurisë dhe e mbrojtjes së Kosovës është e definuar me Kushtetutë, e cila përcakton dhe trajton mjedisin e sigurisë, ngritjen dhe përshtatjen e institucioneve përkatëse për të parandaluar dhe minimizuar efektet e kërcënimeve dhe rreziqeve të brendshme e të jashtme. Ajo vepron në dy drejtime: së pari përcakton objektivat politike drejt së cilës orientohet strategjia dhe së dyti, përcakton rregullat për qeverisje gjatë veprimit. Koncepti bashkëkohor për strategjinë e sigurisë duket qartë në atë që strategjia shikohet si një gërshetim i objektivave, interesave dhe veprimeve ekonomike dhe strategjisë së forcave të armatosura. Mirëpo në këtë fushë ka ngecje, sepse Kosovës i mungojnë dokumentet e rëndësishme të veçantë, si p.sh. “Strategjia e përgjithshme e sigurisë së Kosovës” dhe përcaktimi i infrastrukturës kritike nacionale. Këta dy dokumente përcaktojnë dhe trajtojnë gjerësisht interesat e Kosovës, si dhe elementët kyç të qenies kombëtare për të cilat duhet të punojnë institucionet e sigurisë. Këto interesa janë: ruajtja e sovranitetit të Republikës së Kosovës, mbrojtja e rendit kushtetues, pavarësisë dhe integritetit territorial, liritë dhe të drejtat e njeriut, zhvillimi dhe mbrojtja e sistemeve parësore (transporti, lidhjet, energjia, furnizimi me ujë, furnizimi me artikuj ushqimor, elementet e identitetit dhe kulturës kombëtare, etj), zhvillimi dhe prosperiteti ekonomik, anëtarësimi në strukturat ndërkombëtare të sigurisë, etj. Për të theksuar rëndësinë e identifikimit të infrastrukturës kritike nacionale do të përmendim disa probleme që qytetarët e rëndomtë as nuk arrijnë t’i vërejnë, si: mungesa e kodit ndërkombëtar telefonik bën që të gjitha thirrjet telefonike nga Kosova (duke përfshirë edhe ato të institucioneve) të bëhen përmes një shteti tjetër (Serbia, Monako, Sllovenia). Ky sistem nënkupton se institucionet e huaja të grumbullimit të informacionit kanë qasje të hapur ndaj të gjitha bisedave zyrtare ndërmjet të gjitha institucioneve kosovare. Situata është e njëjtë edhe me kodin ndërkombëtar të internetit – i gjithë “lundrimi” në internet nga Kosova dhe në Kosovë bëhet përmes serverëve që gjenden në Serbi. Kjo nënkupton se Serbia mund të marrë peng të gjithë informacionin “virtual” të institucioneve kosovare, sikur ka bërë në vitin 1999 me dokumentacionin e shtypur.

Goditja e rrufesë mbi Termocentralin “Kosova B”, që ndodhi në vitin 2003, nxori jashtë funksionit tërë sistemin energjetik të Kosovës. Ajo çka nuk është trajtuar asnjëherë lidhur me këtë rast është se në

rast të një sulmi ushtarak nga ajri, apo ndonjë sulmi terrorist nga afërsia, i njëjti fat i pret jo vetëm termocentralet, por edhe të gjitha objektet e infrastrukturës kritike nacionale (duke përfshirë edhe objektet e qeverisë dhe të institucioneve tjera, sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm, etj).

Politika e bashkëpunimit dhe integrimi në institucionet ndërkombëtare të sigurisë, me theks të veçantë integrimi në NATO, si mjet për arritjen e stabilitetit në vend dhe rajon, përbën objektivin dhe zgjidhjen strategjike themelore për sigurinë e Kosovës dhe mbrojtjen e interesave kombëtare. Mirëpo shkalla e suksesit në realizimin e kësaj politike varet nga arritja e stabilitetit të brendshëm dhe e konsolidimit të shoqërisë demokratike dhe të drejtave të njeriut, zhvillimi ekonomik, ngritjen e kapaciteteve njerëzore (shkallës së arsimit “funksional” – të zbatueshëm); konsolidimi i institucioneve dhe instrumenteve të sigurisë, duke e afirmuar Kosovën në vazhdimësi si një faktor progresi e kontribuese në proceset e sigurisë rajonale dhe globale. Kosova, e mbështetur nga NATO-ja dhe EULEX-i, po ndërton një sistem europian të sigurisë, i cili mbështetet në bashkëpunimin reciprok në nivel rajonal dhe atë ndërkombëtar.

Ky koncept ka mbështetje të plotë në rrafshin profesional dhe financiar nga bashkësia ndërkombëtare, në veçanti nga NATO-ja, SHBA dhe Bashkimi Europian. Për të përmbushur këto objektiva, institucionet e Kosovës duhet të përshpejtojnë plotësimin e infrastrukturës ligjore për fushën e sigurisë, e cila duhet të jetë në harmoni të plotë me standardet dhe legjislacionin e Bashkimit Europian. Zhvillimi i legjislacionit dhe funksionimi efektiv i organeve të drejtësisë janë garanci për integrimin e Kosovës në Bashkësinë Europiane. Nga perspektiva e politikës kosovare, Bashkimi Europian dhe NATO janë faktorët kryesorë të arkitekturës europiane, të cilët kanë përjetuar ndryshime të mëdha pas zhvillimeve të viteve 90-ta. Në dokumente bazë të kësaj fushe (të cilat janë në fazën e hartimit) do të reflektohet politika e këtyre dy organizmave, duke ndjekur standardet dhe ndryshimet e tyre me synimin për krijimin e kushteve për integrim të plotë në këto struktura. Prezenca e NATO-së në Kosovë forcon shkallën e sigurisë dhe rritë faktorin mbrojtës, i cili është bazë e stabilitetit të përgjithshëm. Mirëpo rëndësi dhe rol të veçantë për stabilitetin e rajonit, me theks të veçantë të Kosovës, luan prania e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sepse ato ishin dhe janë promotor i stabilitetit dhe progresit rajonal.

Qëllimi kryesor i politikës së sigurisë së përgjithshme të Kosovës është hartimi i konceptit të gjerë të sigurisë (siguria individuale) dhe fuqizimi i sigurisë së përgjithshme në bashkëveprim me shtetet e tjera, mbi bazën e parimeve të OKB-së, OSBE-së dhe Këshillit të Europës. Ndërsa ruajtja e pavarësisë dhe e integritetit territorial të shteteve të Ballkanit Perëndimor është e një rëndësie të veçantë për Kosovën, si dhe për stabilitetin dhe sigurinë e këtij rajoni. Në këtë drejtim vendosja dhe shtrirja e misionit të “EULEX-it” në tërë territorin e Kosovës është e një rëndësie të veçantë, sepse ky mision po bën përpjekje që të përmbushen parimet bazë të Deklaratës së Lisbonës (1996) për “Modelin e sigurisë së përbashkët dhe gjithëpërfshirëse për Europën e shekullit XXI”<sup>12</sup>, si: “liria e shteteve që vetë të vendosin për angazhimet e veta në siguri, duke përfshirë aleancat dhe traktatet; pengimi i forcimit të një shteti kundrejt shteteve të tjera apo pretendimit për sfera të interesit; në modalitetet e sigurisë janë të obliguara të merren parasysh interesat legjitime të shteteve të tjera sidomos të shteteve fqinje”.

Synimi kryesor i EULEX-it është t’i ndihmojë dhe mbështesë autoritetet kosovare në çështjet e sundimit të ligjit, në mënyrë të veçantë në lëmin e veprimtarisë policore, gjyqësisë dhe doganave. Qëllimi i misionit nuk është të sundojë apo të administrojë në Kosovë. Ky është një mision teknik i cili mandat kryesor ka monitorimin, udhëzimin dhe këshillimin e institucioneve të Kosovës të cilat janë përgjegjëse në fushat përkatëse. Përkundër kësaj, këtij misioni iu kanë atribuar edhe një numër i kufizuar i kompetencave ekzekutive. Këto kompetenca, ndonëse të paspecifikuara, me gjasë i referohet autoritetit të EULEX-it për të kthyer ose anuluar vendimet operative të marra nga autoritetet kompetente të Kosovës, por edhe për të ushtruar detyra të drejtpërdrejta në ndjekjen dhe gjykimin e kryerësve të veprave penale. Si i tillë, ky mision ka përgjegjësi që ta zhvillojë dhe përforcojë edhe më tej sistemin e drejtësisë shumetnike dhe të pavarur në Kosovë, duke siguruar që institucionet e sundimit të ligjit nuk ndikohen politikisht dhe i përkrahin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira europiane. Është vendosur mbi bazën e një akti të Këshillit të Bashkimit Europian që emërtohet si: Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt

<sup>12</sup> <http://www.osce.org/mc/39539>

2008 mbi Misionin European për Sundim të Ligjit në Kosovë.<sup>13</sup> Përmes këtij dokumenti janë specifikuar kompetencat e EULEX-it, struktura, statusi, personeli etj. Në fakt vendosja e EULEX-it është bërë edhe mbi bazat e kornizës së Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Misioni i “EULEX-it” ofron ndihmë me ekspertë dhe ndihmë materiale për të gjitha çështjet për të cilat arrihet konsensus me institucionet e Kosovës.

Misioni i EULEX-it në Kosovë është punë komplekse, sepse këtë kompleksitet e kanë kushtëzuar jo vetëm zgjidhjet, kushtimisht thënë, të përgjithësuara që adreson dokumenti i sipërpërmendur i Këshillit të Bashkimit Evropian (2008/124/CFSP), sidomos në pjesën që adresohen përgjegjësitë ekzekutive, por edhe çështja e heterogjenitetit të përbërjes së këtij stafi, si dhe gjendja e përgjithshme në të cilën ndodhet segmenti i sistemit të drejtësisë dhe ai i funksionimit të strukturave shtetërore, sidomos në veri. Këta konsiderohen të jenë faktorët kryesor që ky mision nuk ka përmbushur objektivat e tij, ndërsa rezultatet mund të vlerësohen modeste, si : shtrirja e EULEX-it në tërë territorin e Kosovës, përfundimi i të gjitha lëndëve penale në Gjykatën Supreme të Kosovës të trashëguara nga UNMIK-u, zgjidhja e disa lëndëve penale të ndërlikuara në nivelet tjera të gjyqësisë, arrestimi i suksesshëm i disa personave të dyshuar për kryerje të krimeve të rënda gjatë periudhës së luftës dhe menaxhimi i disa rasteve penale të komplikuar, realizimi i disa aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvarrime dhe identifikim të mbetjeve mortore të periudhës së luftës, ndërmarrja e disa aktiviteteve të suksesshme në fushën e doganave, menaxhimi i vizitave të disa zyrtarëve të lartë serb të zhvilluara në Kosovë, etj. Përveç këtyre sukseseve të lartcekura, misioni është përcjellë edhe me shumë dështime, ndër të cilat veçojmë: vazhdimësia e mbetjes së disa zonave të territorit të Kosovës jashtë juridiksionit të institucioneve kosovare dhe të autoriteteve ndërkombëtare, funksionimi i strukturave ilegale serbe, funksionimi i shërbimit sekret serb dhe i disa shërbimeve tjera të ngjashme, mosrealizimi i demilitarizimit të vendit nga armët e paligjshme, mosfunksionalizimi i punës së gjyqësorit në pjesën veriore të Mitrovicës, defektet në funksionimin e pikave doganore 1 dhe 31 në pjesën veriore të Kosovës, nënshkrimi i protokollit për bashkëpunim policor me autoritetet gjegjëse të Serbisë, etj.

<sup>13</sup> Shih: [www.consilium.europa.eu/.../Council\\_JA\\_on\\_EULEX\\_Kosovo-Albanian-\(Final\).pdf](http://www.consilium.europa.eu/.../Council_JA_on_EULEX_Kosovo-Albanian-(Final).pdf).

Kosova duhet të mbështesë konceptin e ri të politikës së sigurisë, i cili nënkupton bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në nivel ndërkombëtar. Mirëpo për të përmbushur këtë synim në këtë fazë Kosovës i mungon përcaktimi i qartë i mjedisit të sigurisë, ndërsa politika e sigurisë mbështetet në aftësinë /mbështetjen/ e KFOR-it dhe EULEX-it. Për krijimin e kësaj gjendjeje, ndikim të madh kanë pasur aktivitetet e grupeve kriminale të të gjitha llojeve të sponsorizuara nga Serbia, të cilat kanë penguar dhe po pengojnë institucionet kosovare të sigurisë që të ushtrjnë sovranitetin në tërë territorin e Kosovës.

### **Siguria shtetërore e Republikës së Kosovës në rrethanat aktuale ndërkombëtare dhe vendore**

Siguria shtetërore përmban katër elemente bazë: *siguria fizike, autonomia, zhvillimi dhe rendi*.<sup>14</sup> Kosova u shpall si shtet i pavarur dhe sovran si rezultat i tensioneve të forta të politikës ndërkombëtare. Megjithatë, pikërisht si rezultat i këtyre tensioneve edhe pavarësia e edhe sovraniteti i shtetit më të ri në botë mbeten të cunguar.

Ndonëse **siguria fizike** e shtetit nuk vihet në dyshim për shkak të pranisë ushtarake të NATO-s,<sup>15</sup> synim i institucioneve të Kosovës duhet të jetë që NATO të jetë e pranishme në Kosovë jo përmes ushtrive të huaja, por që kapacitetet vendore të sigurisë (në veçanti FSK-ja) të jenë pjesë e NATO-s. Megjithatë, ende ekzistojnë elemente brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës, të cilët këtë prani e bëjnë të domosdoshme, e të cilat duhet trajtuar si sfida të sigurisë fizike (mungesa e strategjisë nacionale të sigurisë, mungesa e identifikimit të infrastrukturës kritike nacionale dhe përcaktimi i strategjisë për sigurinë e kësaj infrastrukture; pretendimet territoriale dhe institucionale të Serbisë, të cilat aktualisht shprehen përmes politikës “çorientuese” dhe degraduese ndaj çfarëdo nisme që ka të bëjë me Kosovën, etj).

Të tri elementët e tjerë të sigurisë shtetërore ende janë tejet të brishta dhe nën ndikimin e thellë të faktorëve të cilët përligjën

<sup>14</sup> MORGAN, Patrick **Siguria në politikat ndërkombëtare: qasjet tradicionale**. *Studime bashkëkohore të sigurisë, Pjesa I – Qasjet ndaj sigurisë*, faqe 28. Oxford Press University; redaktuar nga Alan Collins (botimi shqip nga UET Press, redaktor Bashkim Gjergji), ISBN: 978-99956-39-14-3

<sup>15</sup> **Sfidat e sigurisë pas shpalljes së pavarësisë**, Grup autorësh, *Instituti për Studime të Sigurisë dhe Integritimeve “Katana”*, Prishtinë, shkurt (2008)

shpalljen e pavarësisë sipas Pakos së Ahtisarit. Politikat e ekonomisë bashkëkohore në rrethana të globalizimit abstrahojnë rëndësinë e parimeve klasike të ruajtjes së infrastrukturës së domosdoshme për vetëpërbajtje ekonomike, ruajtjes së vendeve të punës, etj. duke i lëshuar vendin konkurrencës së hapur jo vetëm në shkallë regjionale, por edhe në shkallë globale. Parimi i Adam Smith për “dorën e padukshme” nuk përfshinë më vetëm ekonominë kombëtare, por, konkurrenca tanimë është bërë globale.<sup>16</sup> Koncepti i sigurisë bashkëkohore zhvillohet në mënyrë të organizuar si “sistem i sigurisë”, i cili në nivel shteti organizohet si sistem nacional i sigurisë, apo sistem i sigurisë kombëtare. Në zhvillimin e këtij koncepti ndikim të madh kanë edhe zhvillimet e reja gjeopolitike dhe gjeoekonomike, të cilat janë reflektuar në ridimensionimin e sistemit të sigurisë, duke përfshirë këtu edhe dimensionin e sigurisë të lidhur ngushtë me sigurinë dhe rendin publik<sup>17</sup>.

Megjithatë, në botën e globalizuar të fundit të shekullit XX dhe fillimit të këtij shekulli, ku monopoli në përdorimin e forcës<sup>18</sup> nuk është në duart e shtetit, shumë shtete, në kuptimin tradicional, janë “detyruar” të heqin dorë nga një pjesë e autonomisë së tyre të veprimit. Pas krizës globale financiare të vitit 2008 Irlanda, Portugalia, Greqia i janë nënshtruar rregullave të FMN-së dhe Bankës Botërore, duke hequr dorë nga “e drejta” e tyre për të qeverisur me buxhetin e tyre.

Ndikimi i këtyre institucioneve në **autonominë e veprimit të qeverive** u bë i qartë edhe në Kosovë pas vendimit për të ngritur rrogat e sektorit publik. Rezultatet, apo pasojat e këtij vendimi, do të bëhen të qarta pasi të fillojnë efektet e vendimit të FMN-së për të anuluar marrëveshjen për huazim me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Këto institucione kërkojnë kujdes dhe zbatim të rregullave të

<sup>16</sup> GASHI Bejtush, JUSUFI Agron: **Ekonomia e sigurisë**, “*International Studies*”, *A Review of International Relations, Foreign Policy and Diplomacy*. The Center for International Studies; Zagreb, në kroatisht (*Ekonomija Sigurnosti, slučaj za analizu: Kosovo poslije rata*), (gusht 2009).

<sup>17</sup> **Siguria personale në Kosovë, domosdoshmëri për rishqyrtim gjithëpërfshirës**, Grup autorësh, *Instituti për Studime të Sigurisë dhe Integriteteve “Katana”*, Prishtinë, Gusht (2007).

<sup>18</sup> WEBER Max: **Politika si profesion**, ligjëratë e mbajtur në Universitetin e Mynihut, në janar 1919.

[http://www.ne.jp/asahi/moriyuki/abukuma/weber/lecture/politics\\_vocation.htm](http://www.ne.jp/asahi/moriyuki/abukuma/weber/lecture/politics_vocation.htm)

caktuara edhe në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe aseteve publike. Si pasojë e këtyre ndikimeve, dhe në ambientin e tensionuar të brendshëm politik, disa qeveri me radhë po dështojnë në privatizimin e PTK-së dhe KEK-ut.

Në artikullin “Ekonomia e sigurisë”<sup>19</sup>, autorët kanë paraparë problemet e autonomisë së veprimit, marrjes së kompetencave dhe pushtetit real në fushën e sigurisë, si dhe ndikimin afatgjatë që do të ketë kufiza e efikasitetit të sektorit të sigurisë në nivelin e zhvillimit ekonomik dhe sigurisë së përgjithshme të vendit. Tani nuk kemi për qëllim të trajtojmë këto çështje në aspektin ekonomik, por të nxjerrim në pah ndikimin e tyre në sigurinë shtetërore. Është e qartë se ngecja në këtë proces do të ketë ndikim të thellë në elementin e tretë të sigurisë shtetërore – **zhvillimin ekonomik**, sepse Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbështetur zhvillimin ekonomik në ndërtimin e autostradës Morinë – Merdare, kurse ndërtimin e kësaj rruge e ka mbështetur në të hyrat që do të nxirren nga privatizimi i aseteve publike të përmendura.

Gjetja e rugëve të reja të furnizimit, ngritja e kapaciteteve vendore për zhvillim ekonomik, si dhe gjetja e tregjeve të reja është domosdoshmëri për të krijuar mundësi të reja investimi dhe për të ulur balansin e thellë negativ të tregtisë me jashtë, sidomos dhe në veçanti me Serbinë. “*Dalja në det*”, përkatësisht shfrytëzimi i portit të Shëngjinit, në vend të futjes së pakontrolluar të artikujve nga Serbia, përbën një element të rëndësishëm strategjik jo vetëm në kuptimin ekonomik, por edhe në kuptimin e sigurisë dhe stabilitetit regjional. Një zgjidhje e tillë është e domosdoshme, si përgjigje adekuate ndaj “stilit” çorientues dhe degradues të politikës së institucioneve të Serbisë.

Për të përmyllur qarkun, mungesa e zhvillimit ekonomik në kushtet e shtimit të popullatës, e cila vazhdimisht dyndet në vendbanimet urbane në kërkim të zgjidhjes së fatit, krijon parakushte për shfaqjen e problemeve të **rendit**, që është elementi i katërt i sigurisë shtetërore. Edhe faktorë të tjerë me rëndësi janë në përbërje të këtij elementi – aftësia e institucioneve shtetërore për të kontrolluar dhe administruar në tërë territorin e vet (që aktualisht sfidohet në veriun e vendit dhe në hapësirat tjera me “shumicë” serbe), bashkëpunimi ndërkuftar, regjional e ndërkombëtar, e që ndikon me

<sup>19</sup> GASHI Bejtush, JUSUFI Agron: **Ekonomia e sigurisë**, Figura 4. *Kufiza “Konsumi-Siguria” në rastin e Kosovës*, faqe 10.

të madhe në luftën kundër “sëmundjeve të shoqërisë bashkëkohore” – trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit me artikuj të ndaluar (droga, armët, artikuj strategjikë, etj).

Që pas shpalljes së pavarësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës më tepër është në kërkim të ritmit të vet se sa në trajtimin gjithëpërfshirës të problemeve të sigurisë shtetërore. Sado që mund t’i nënshtrohet kritikave të shumta, në aspekte të ndryshëm Strategjia e zhvillimit afatmesëm e miratuar nga Qeveria paraqet qasjen e parë të institucioneve vendore ndaj problemeve me të cilat përballet shteti i ri.

### **Siguria shoqërore e Republikës së Kosovës në rrethanat aktuale ndërkombëtare dhe vendore**

Mjedisi i sigurisë pa dyshim që paraqet sintezën e të gjithë nënsistemeve në shoqëri (ekonomia, shëndetësia, arsimi, shërbimet publike, etj.), sepse këto nënsisteme sigurojnë kushtet bazë për ekzistimin dhe zhvillimin e shoqërisë, cilësinë e jetës dhe veprimin në drejtim të rritjes së rezistencës së shoqërisë dhe institucioneve të saj.<sup>20</sup> Institucionet e Kosovës, të cilat ende janë në ndërtim e sipër dhe me mungesë të qartë të traditës dhe pa përvojë në trajtimin e sfidave të sigurisë, ende po hasin në pengesa nga jashtë dhe vazhdojnë të përballen edhe me problemet e akumuluarra përgjatë dy dekadave të kaluara. Sfidat e mjedisit të sigurisë shoqërore në Kosovë janë të shumta. Disa prej tyre kanë ndikim të drejtpërdrejtë (akut) ndaj sigurisë, kurse të tjerat kanë ndikim të tërthortë (të vonuar).

Ndër sfidat e grupit të parë ne do të veçojmë: korrupsioni dhe krimi i organizuar (trafikimi me qenie njerëzore, trafikimi ilegal me materie të kontrolluara – narkotikë, armë, teknologji, etj).

Korrupsioni është dukuri që nuk mungon edhe në vende me demokraci të zhvilluar<sup>21</sup>, por karakteristikë për këto vende është se korrupsioni zhvillohet në një terren mjaft të pafavorshëm për të lulëzuar, për të paktën katër arsye themelore: së pari, për shkak të një kuadri të plotë ligjor; së dyti, për shkak të rigozitetit me të cilin e zbatojnë ligjin institucionet që menaxhojnë luftën kundër korrupsionit; së treti, ekzistenca e një shoqërie civile të zhvilluar, tepër e

<sup>20</sup> GASHI Bejtush: Mjedisi i sigurisë në Kosovë, (faqe 1), *Revistë e shkencave shoqërore “Vizione” nr. 8, Shkup, 2006.*

<sup>21</sup> Global Corruption Report 2009 *Transparency International*, Cambridge University Press (2009), ISBN 978-0-521-13240-4.

mirorientuar dhe e ndjeshme për të reaguuar; së katërti, një standard më i lartë në zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve.<sup>22</sup>

Korrupsioni kërcënon vendosjen e ekonomisë së tregut. Ai shkakton një efekt deformues në politikat qeveritare për tregtinë dhe taksat dhe frenon investitorët potencialë. Është kërcënimi më i madh për demokratizimin e shoqërisë dhe për konsolidimin e institucioneve demokratike. Ai pengon zbatimin e strategjive dhe politikave të kontrollit të krimit dhe është një pengesë e madhe për zbatimin e suksesshëm të metodave dhe organizimit që vendosin ligjin. Privatizimi me çdo kusht i ndërmarrjeve shoqërore në zbatim të luftës kundër korrupsionit nuk është strategji e drejtë. Privatizimi në shumë vende të tranzicionit dhe vendeve në zhvillim shpesh ka degraduar në shitjen e asetëve publike (apo shoqërore) nën çmimin e tregut, në mënyrë jotransparente dhe korruptive. Përveç kësaj, praktikrat e tilla i hapin rrugë korrupsionit edhe pas privatizimit.<sup>23</sup> Stërzgjatja e procesit të privatizimit të PTK-së dhe pjesëve (shërbimeve) të KEK-ut është indikacion se edhe në këtë mes “ka diçka të kalbur”. Shpallja e hetimeve nga prokuroria e EULEX-it ndaj Dardafon-it dhe Devolli Company është veçse një gurë më tepër mbi këtë peshore.

Përveç korrupsionit “eklatant”, një praktikë e hidhur që duhet luftuar është edhe “mitmarrja detyruese”, që nënkupton nevojën e qytetarëve për të dhënë mito për të arritur diçka që atyre u takon me ligj dhe me normat qytetare. Sipas raportimit të mediave, kjo dukuri është e përhapur në të gjitha sistemet e pushtetit, si dhe në ndërmarrjet publike e shoqërore.

Kërcënimi i korrupsionit mund të luftohet duke përdorur strategjitë preventive që reduktojnë shanset për krim, heqin pikat e dobëta të sistemeve ekonomike dhe industriale për të shtuar rezistencën e tyre ndaj infiltrimit nga grupet e krimit të organizuar. Lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikëve të paligjshme varet nga efikasiteti i veprimit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Agjencisë së Inteligjencës, Policisë, Prokurorisë dhe gjyqësorit. Ruajtja e sigurisë së përgjithshme kërkon gjithashtu

<sup>22</sup> MAURO Paolo, Why worry about corruption? *International Monetary Fund*, Economic Issues, Washington D.C. (1997), ISBN: 1-55775-635-X.

<sup>23</sup> TANWEER AKRAM: Ineffective Privatization of Public Enterprises: The Case of Bangladesh, *UN Public Administration Network* (1999), <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/APCITY/UNPAN024962.pdf>

ndalimin e përdorimit të informacioneve të grumbulluara për qëllime të manipulimit të ndërjegjes së publikut. Qeveria e Kosovës duhet të intensifikojë funksionalizimin e plotë të këtij sistemi, duke përfshirë strukturat e grumbullimit dhe përpunimit të informacionit, veçanërisht atyre të fshehta (në kuptimin e misionit, procedurave dhe infrastrukturës ligjore), duke ndërtuar një sistem informacioni të integrueshëm dhe të ndërveprueshëm në mes vete, si dhe me strukturat homologe të rajonit dhe me agjenci të informacionit që kapërcejnë kufijtë tradicionalë dhe të përfshirë në konceptin “coalition of information”. Po ashtu nga organizmat ndërkombëtarë duhet të kërkohet garantimi me ligje të veçanta i mbrojtjes së informacionit të klasifikuar si shtetëror në fusha të veçanta, si dhe ai ndërshtetëror apo me organizma ndërkombëtarë, që buron nga marrëveshjet midis palëve.

Në vitet e fundit janë shtuar rastet e qytetarëve të Kosovës, që janë kapur gjatë kalimit klandestin të kufirit në shtete të ndryshme.<sup>24</sup> Në anën tjetër, që nga paslufta në Kosovë ka një numër konstant të të huajve, që kërkojnë azil apo strehim, si dhe të tjerë që kapen gjatë orvatjeve për kalim të paligjshëm të kufirit. Megjithatë, në kuptimin e trafikut ilegal dhe bashkëpunimit ndërkufitar e regional në luftën kundër tyre, Kosova më tepër shfrytëzohet si rrugë transiti drejt Europës Perëndimore. Shkaktar kryesor për këtë dukuri janë mungesa e kapaciteteve teknike dhe njerëzore, problemet e përmendura më herët lidhur me autonominë e veprimit institucional (problemët me kontrollin kufitar në veri të vendit), si dhe problemët në ndërlidhjen funksionale të sistemit të drejtësisë me institucionet e sigurisë.<sup>25</sup> Kosova ende shfrytëzohet si rrugë transiti drejt Europës Perëndimore, gjë që ende kërkon angazhim të thellë jo vetëm të institucioneve vendore, por edhe të EULEX-it, që ka për detyrë ngritjen e kapaciteteve njerëzore, të infrastrukturës ligjore e teknike për luftimin e këtyre dukurive.

Para luftës në Kosovë ka pasur shumë pak raste narkomanie. Keqpërdorimin e drogave e kanë bërë kryesisht personat të cilët kanë vijuar studimet në metropolet e ish-Jugosllavisë dhe më rrallë personat

<sup>24</sup> Rasti tragjik “Tisa” në vjeshtën e vitit 2009, kurse rasti i fundit ishte në fillim të muajit qershor 2011.

<sup>25</sup> Siguria personale në Kosovë, domosdoshmëri për rishqyrtim gjithëpërfshirës, Grup autorësh, *Instituti për Studime të Sigurisë dhe Integriteteve “Katana”*, Prishtinë, Gusht (2007).

të cilët në mërgim kanë qenë të përfshirë në qarqe të ndryshme dekadente. Pas luftës dekadencia<sup>26</sup> e stilit “perëndimor” ka filluar të përfshijë me të madhe Kosovën, sidomos rininë. Sot, sidomos në Prishtinë, “thithja” e hashashit është bërë dukuri e gjithëpranishme që nga shkollat e mesme të ulëta. Ata të cilët ende nuk e kanë provuar konsiderohen “të prapambetur”, “fshatar”, etj. Pra, tanimë Kosova nuk është vetëm vend transiti në trafikun ilegal të drogave, por, fatkeqësisht, po bëhet pikë gjithnjë e më e zezë edhe si vend përfundimtar (cak) i kësaj tregtie.

Të dhënat publike lidhur me këtë dukuri mungojnë tërësisht. Në mungesë të statistikave policore, burim i vetëm i informatave mbeten mediat, të cilat edhe vetë janë pjesë e këtij problemi. Televizionet kombëtare në mënyrë të pakontrolluar, në terminet e preferuara për rininë, sjellin këngë (spote) e seriale në të cilat dekadencia (promiskuiteti rinor, përdorimi i drogave “të lehta”, delikuenca, etj.) paraqitet si gjendje tërësisht normale.

Në mungesë të një alternative tjetër (p.sh aktivitete sportive e kulturore, që do të përfundojnë me gara qoftë në nivel të shkollave, komunave apo në nivel shtetëror), duket se për këto gjenerata kjo mbetet rruga e vetme, në ndërkohë që askush nuk merret me “anën tjetër të medaljes”. Në Qendrën Emergjente të QKUK-së gati çdo ditë arrin i pajetë nga një person i moshës së re për shkak të mbidozës me drogë, marrjes së “koktejeve” të pakontrolluara të drogës apo vetëvrasjes aksidentale nga përdorimi i barnave qetësuese për shkak të mungesës së drogës. Pamjet e personave të shtrirë pa vetëdije nëpër rrugicat, skutat e tunelet e Prishtinës janë bërë thujse “normale”, deri në masën sa që organizatat joqeveritare u sjellin edhe shiringa “për t’i mbrojtur nga infeksionet”, të cilat në të vërtetë janë tejet të pranishme (llojet e rënda të hepatitit, anemia e thellë, problemet e ndryshme psikiatrike, humbja e funksioneve të ndryshme neurologjike – dëgjimi, prekja, etj), të cilat i bëjnë këta persona të paafte për punë në moshën më produktive dhe i vënë në barrë të shoqërisë, duke gllabëruar kapacitetet edhe ashtu të mangëta të sistemit shëndetësor.

Sado që Policia e Kosovës e Reparti i Psikiatrisë në QKUK ballafaqohen me këtë gjendje çdo ditë, është e pamundur për ta që ta luftojnë këtë dukuri përdërisa nuk ekziston një strategji dhe një front i përbashkët i të gjitha institucioneve dhe shoqërisë civile. Për të

<sup>26</sup> Dekadencia: Gjendje e degjenerimit mendor apo moral; veprimet e tepruara apo jomorale, që përfshijnë seksin, alkoolin, ushqimin apo drogat.

përmirësuar situatën, së pari nevojitet një vlerësim kritik e analitik në nivel vendi. ISSI “Katana” ka hartuar një projekt shkencor pikërisht për këtë qëllim, por fatkeqësisht, ky projekt nuk është zhvilluar në mungesë të mbështetjes qoftë nga institucionet, qoftë nga OJQ-të e fondacionet e shumta, që kanë për mision të mbështesin shëndetin dhe sigurinë e rinisë.

Një e arritur e madhe në luftën kundër trafikimit ilegal me armë ka qenë miratimi i Ligjit për armë nga përbërja e kaluar e Kuvendit të Kosovës në vitin 2009. Përkundër problemeve të shumta teknike në funksionalizimin e këtij ligji, ai tani ka filluar të zbatohet. Qytetarët e Kosovës, të moshës mbi 21 vjeç, kanë të drejtë të posedojnë armë të kategorive dhe kalibrit, të cilat janë të lejuara me ligj. Mundësia e pajisjes me armë zjarri dhe municion në mënyrë legale, si dhe mundësia për të qitur me armë zjarri në poligone të shenjëtarisë sportive praktikisht e bënë të panevojshëm furnizimin klandestin me këta artikuj për shumicën dërmuese të qytetarëve, duke lehtësuar kështu barrën e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe të Sektorit të Krimeve të Rënda në Policinë e Kosovës.

Miratimi i Ligjit për tregtinë e mallrave strategjike, si dhe Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri janë hapa të rëndësishëm në luftën ndërkombëtare kundër terrorizmit. Zbatimi i këtyre ligjeve do të vë kontroll në qarkullimin e mallrave dhe artikujve strategjikë (artikujve me përdorim të dyfishtë)<sup>27</sup>. Këtu përfshihet sidomos teknologjia informative, e cila në Kosovë është në zhvillim e sipër dhe mund të keqpërdoret gjatë eksportit, apo mallra dhe artikuj të teknologjisë së lartë, të cilët mund të importohen nga vendet e zhvilluara dhe pastaj pjesë të tyre të riekportohen në vendet e treta, e që përfundimisht mund të përdoren me qëllim të rrezikimit të sigurisë në vendin e destinacionit.

**Ndër sfidat e grupit të dytë do të veçojmë:** cilësinë e ulët të arsimit në të gjitha nivelet, me pasojë “analfabetizmin” funksional; mungesën e politikës agrare dhe strategjisë së urbanizimit; integrimin e pakicës serbe në institucione shtetërore; ndikimin e Beogradit ndaj pakicës serbe; etj.

<sup>27</sup> Mallra dhe artikuj të cilët përpos përdorimit për të cilin janë porositur, mund të kenë edhe zbatim tjetër që mund të rrezikojë sigurinë e përgjithshme.

Ndonëse sivjet është kryer regjistrimi i parë i popullsisë pas tridhjetë viteve, të dhënat nga ky regjistrim ende nuk janë publikuar. Sidoqoftë, Kosova është e njohur për faktin se ka popullatën më të re në kontinent. Ne tashmë kemi tërhequr vërejtjen se sado i mirëseardhur ky fakt, në kuptimin pozitiv, për sa i përket kapacitetit zhvillimor është e domosdoshme që të investohet në ruajtjen e këtij kapaciteti nga degradimi dhe shkatërrimi.<sup>28</sup> Niveli tepër i ulët i arritjes së suksesit në provimin e maturës po e detyron Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të bëjë atë që nuk duhet bërë – të ulë prapen e kalueshmërisë së testit. Sistemi privat i arsimit në Kosovë ka krijuar një **inflacion** të kuadrove dhe thirrjeve shkencore në drejtimet e shkencave shoqërore (sociale) - juristë, bankierë, menaxherë, kriminalistë, politologë, diplomatë, etj, të cilët nuk arrijnë të gjejnë zbatim praktik, në ndërkohë që drejtimet teknike dhe shkencat natyrore – mjekësia, ndërtimtaria, makineria në sektorin privat as nuk ekzistojnë, kurse në Universitetin e Prishtinës janë thuajse para shuarjes.

Përmirësimi i dukshëm i infrastrukturës rrugore padyshim se është një e arritur e madhe në Kosovën e pavarur. Por kjo e arritur duhet të shtrihet edhe me investime të tjera në zhvillimin e urbanizimit edhe jashtë qyteteve të mëdha. Ne kemi tërhequr vërejtjen mbi ndikimin e planifikimit hapësinor dhe urbanistik,<sup>29</sup> si dhe mënyrës së organizimit të institucioneve të sigurisë,<sup>30</sup> në gjendjen e sigurisë personale dhe sigurisë së përgjithshme të vendit. Duhet lavdëruar orvatjet e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që nën kushtet e vështira të shtrëngimeve buxhetore të ndërmarrë hapa në nxitjen e bujqësisë dhe blegtorisë.<sup>31</sup> Investimet në bujqësi ndikojnë në rritjen e shkallës së punësimit, ulin varësinë e vendit ndaj importit të produkteve bujqësore, si dhe ulin nevojën e dyndjes nga fshatrat në qytete.

<sup>28</sup> GASHI Bejtush, JUSUFI Agron: **Ekonomia e sigurisë**, “*International Studies*”, *A Review of International Relations, Foreign Policy and Diplomacy*. The Center for International Studies; Zagreb, në kroatisht (*Ekonomija Sigurnosti, slučaj za analizu: Kosovo poslije rata*), (gusht 2009).

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> **Siguria personale në Kosovë, domosdoshmëri për rishqyrtim gjithëpërfshirës**, Grup autorësh, *Instituti për Studime të Sigurisë dhe Integriteteve “Katana”*, Prishtinë, gusht (2007).

<sup>31</sup> <http://www.mbpzhr->

[ks.net/advCms/documents/60485\\_115288\\_Plani\\_per\\_bujqesi\\_pylltari\\_dhe\\_zhvillim\\_rural.pdf](http://www.mbpzhr-ks.net/advCms/documents/60485_115288_Plani_per_bujqesi_pylltari_dhe_zhvillim_rural.pdf)

Integrimi i pakicave në shoqëri dhe në institucione shtetërore është një ndër parakushtet për anëtarësim në BE. Mirëpo vënia e nevojave të një grupi të çfarëdo përkatësie (qoftë ekonomike-sociale, apo etnike) përpara nevojave dhe mirëqenies së shoqërisë në përgjithësi asnjëherë nuk sjell efektet e pritura. Në fakt, historia njerëzore ka dëshmuar se këto orvatje gjithëherë përfundojnë me katastrofa të individëve, apo edhe tërë shoqërisë. Orvatjet e tilla në Kosovën e viteve '90 përfunduan me luftën e hapur të UÇK-së në fund të shekullit XX, kurse aktualisht jemi dëshmitarë të kryengritjeve dhe luftërave civile në thuajse mbarë vendet arabe. Prandaj institucionet kosovare duhet të mësojnë nga përvojat e hidhura të së kaluarës dhe të ndryshojnë qasjen e gabuar ndaj sigurisë së pjesëtarëve të pakicave, të cilën UNMIK-u e ka “trashëguar” nga gjendja e para-luftës dhe është munduar që “trashëgim” t’ia lë edhe institucioneve vendore.<sup>32,33</sup>

Ndikimi i Beogradit ndaj serbëve në Kosovë ka rënë në shkallë të konsiderueshme gjatë viteve të pasluftës, e sidomos pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008. Kjo është dëshmuar edhe me rastin e zgjedhjeve lokale në vitin 2009, si dhe në zgjedhjet qendrore në fund të vitit të kaluar, por megjithatë ky ndikim ende mbetet problematik, sidomos në veri të vendit. Përveç si problem politik, ky ndikim është edhe kërcënim për sigurinë e përgjithshme. Serbët lokal në Zveçan tashmë disa herë po e bllokojnë magjistralen, duke kundërshtuar jo vetëm Policinë e Kosovës, por edhe KFOR-in dhe EULEX-in për shkaqe nga më të ndryshmet,<sup>34</sup> duke dëshmuar se në çdo kohë mund të shkaktojnë trazira të sigurisë.

## **Përfundime**

Në shekullin XXI siguria më nuk identifikohet me fuqinë ushtarake, ndërsa përdorimi i forcës më nuk është monopol i shtetit.

<sup>32</sup> **Siguria personale në Kosovë, domosdoshmëri për rishqyrtim gjithëpërfshirës**, Grup autorësh, *Instituti për Studime të Sigurisë dhe Integritimeve “Katana”*, Prishtinë, gusht (2007).

<sup>33</sup> **Policimi në bashkësi, strategji e zbatueshme apo sfidë e pakapërcyeshme**, Grup autorësh, *Instituti për Studime të Sigurisë dhe Integritimeve “Katana”*, Prishtinë, Nëntor (2007).

<sup>34</sup> Pengimi i arrestimit të të dyshuarve për krim të organizuar, pengimi i bllokimit të importit të paligjshëm nga Serbia, pengimi i ndërrimit të komandantit të stacionit policor, etj.

Sfidat klasike janë zëvendësuar me sfida të ndryshme të cilat para së gjithash nuk janë të lidhura për forcën klasike ushtarake dhe atributet e saj. Ato vijnë nga burimet nga më të ndryshme dhe vështirë mund të parashihet natyra e tyre, intensiteti i rrezikut, vendi dhe koha e shpërthimit të tyre dhe kontinuiteti i zgjatjes. Këto zhvillime kanë ndryshuar edhe përkufizimin e shtetit nga kuptimi ekonomik i Adam Smith-it apo kuptimi i sigurisë i Max Weber-it.

Periodha që po jetojmë, përveç globalizimit ekonomik paraqitet edhe si globalizim i rreziqeve dhe i kërcënimeve të fushës së sigurisë ndërkombëtare, rajonale, nacionale dhe individuale-njerëzore. Globalizimi, duke favorizuar lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave, ka krijuar edhe mundësitë e përfitimeve për krimin dhe terrorizmin. Ndërvarësia dhe ndërveprimi i ekonomisë dhe sigurisë është shtuar, por me gjithë këtë shtim, këto dukuri janë bërë gjithnjë më amorfe dhe më të papërcaktuara. Siguria shoqërore më nuk mund të trajtohet ngushtë si pjesë e sigurisë shtetërore, por duhet të trajtohet si çështje e veçantë dhe e rëndësishme e interesit nacional. Institucione dhe nisma të shumta ndërkombëtare janë themeluar dhe veprojnë duke shpenzuar shuma të majme financiare për të “përbashkuar” këto dy sektorë jetikë për çdo shtet dhe komb.

Pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008, Kosova ka qenë në masë të madhe paqësore dhe stabile, por bashkësia ndërkombëtare nuk ka ofruar mbështetje adekuatë për të garantuar sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës dhe për të siguruar shmangien e çdo përpjekjeje që synon ndarjen e vendit.

Misioni i EULEX-it është përcjellë edhe me shumë sfida, ndërsa më kryesoret konsiderohen: përgjithësimi, përkatësisht paqartësia e funksioneve ekzekutive të EULEX-it, ekzistimi i një gjendjeje jo të qëndrueshme të sigurisë në vend, funksionimi i sistemit tripartit të pushtetit (UNMIK- EULEX- Institucione të Kosovës), çështja e personave të zhdukur, përbërja heterogjene e Misionit të EULEX-it etj. Ndërsa dështimet kryesore i referohen çështjes së mbetjes së disa zonave të Kosovës jashtë juridiksionit të autoriteteve të ligjshme të vendit, vazhdimësia e funksionimit të strukturave ilegale serbe, funksionimi i shërbimit sekret serb, mosdemilitarizimi i vendit nga armët e paligjshme, mosfunksionimi i punës së gjyqësorit në pjesën veriore të Mitrovicës, defektet në funksionimin e pikave doganore 1 dhe 31 në pjesën veriore të Kosovës, etj.

Bashkëpunimi rajonal për të krijuar një frymë dhe një rend të ri nëpërmjet dialogut, bashkëpunimit e mirëbesimit është objektiv i sigurisë në planin afatshkurtër dhe afatgjatë. Në themel të këtij vizioni strategjik qëndron pranimi i shtetit të Kosovës nga ana e shteteve fqinjë dhe kthimit të saj në faktor sigurie e stabiliteti në Evropën Juglindore. Republika e Kosovës synon të jetë një faktor stabiliteti e paqeje në rajon dhe nuk shpreh armiqësi dhe pretendime territoriale për ndryshim kufijsh. Kosova është kundër krijimit të krizave e konflikteve rajonale dhe të zgjidhjes së tyre me mjetet e dhunës. Në këtë koncept një ndër synimet strategjike është ngritja e strukturës së sistemit të sigurisë dhe sigurimi i kapaciteteve për zhvillimin e operacioneve të mbështetjes së paqes, në mbështetje të ligjit ndërkombëtar dhe parimeve humanitare nën drejtimin e Kombeve të Bashkuara, NATO-s<sup>35</sup> dhe Bashkimit Europian.

Objektivi strategjik i politikës së sigurisë së Kosovës është integrimi në strukturat euroatlantike të sigurisë. Anëtarësimi i Kosovës në NATO dhe BE është objektiv parësor dhe afatgjatë, i cili ka mbështetjen e plotë të popullit të Kosovës dhe të spektrit politik. Kosova nuk e mbështetë sigurinë e vendit thjesht në forcat e veta, por në përpjekjet e përbashkëta përmes integritit dhe bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë.

Kosova ka mundësinë historike të ndërtojë një shtet modern dhe shembull në rajonin tonë, ku shtetasit e saj, pavarësisht përkatësisë etnike apo fetare ta ndejnë veten të barabartë, ku familjet të jenë të garantuara që të ndërtojnë të ardhmen e tyre dhe të fëmijëve të tyre sipas kontributeve të barabarta, ku shpresa për të ardhmen të jetë më e madhe se frika nga e kaluara.

Në konceptin bashkëkohor të sigurisë, siguria kombëtare nuk përfshinë vetëm sigurinë territoriale të një shteti dhe aftësinë e tij për të kontrolluar sigurinë fizike të qytetarëve (siguria shtetërore), por edhe faktorë të tjerë, të cilët kanë ndikim të tërthortë në gjendjen e sigurisë kombëtare – arsimi, gjendja sociale, konsumi, etj (siguria shoqërore). Në Kosovën e pasluftës, siguria kombëtare (ndonëse gabimisht) zakonisht është identifikuar me atë shtetërore. Si rrjedhojë, në pranimë e bashkësisë ndërkombëtare (civile e ushtarake) dhe me garancitë e tyre për tërësinë territoriale dhe kapacitetet e tyre për

---

<sup>35</sup> NATO-ja konsiderohet/konceptohet si një komunitet, ku vendet bashkohen për të siguruar mbrojtjen kolektive dhe ruajtjen e paqes e sigurisë nëpërmjet kontributeve, që secili vend anëtar ofron për sigurinë dhe mbrojtjen kolektive.

parandalimin e trazirave në shkallë të gjerë Kosova është konsideruar e sigurt.

Përderisa kjo prani ishte e mjaftueshme për sigurinë shtetërore, mostrajtimi i duhur dhe me kohë i elementeve të sigurisë shoqërore tani është paraqitur si problem mjaft i ndërlikuar, në të cilin ndikimi i bashkësisë ndërkombëtare, nuk ka qenë në shkallën e duhur. Për pasojë sot Kosova nuk rrezikohet as si shtet e as si territor, por kosovarët jetojnë në kushte gjithnjë e më të vështira të sigurisë shoqërore. Për të përmirësuar këtë gjendje nevojitet angazhim i thellë i institucioneve vendore.

## **Rekomandimet**

- Zhvillimi kombëtar – ekonomik, social, arsimor apo përmirësimet politike – konsiderohet një komponent qendror i sigurisë së shtetit.<sup>36</sup> Mënyra se si institucionet e Kosovës do t'i trajtojnë sfidat aktuale dhe ato që do të paraqiten në të ardhmen janë përcaktues edhe të sigurisë kombëtare në të ardhmen e vendit. Në këtë proces, zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve të sigurisë (Policia e Kosovës, FSK-ja, AIK), ndërlidhja e këtyre kapaciteteve në një “front” gjithëpërfshirës përmes “Strategjisë së sigurisë kombëtare” janë elementi kyç.
- Institucionet e sotme të Republikës së Kosovës kanë përgjegjësi jo vetëm ndaj votuesve të vet, por edhe ndaj gjeneratave të ardhshme. Veprimet, të arriturat dhe dështimet e këtyre institucioneve do të lënë gjurmë të thellë në sovranitetin, integritetin dhe autoritetin e Kosovës si shtet. Institucionet e sigurisë<sup>37</sup> duhet ta kuptojnë drejt këtë përgjegjësi dhe të fillojnë të marrin përsipër fatin e vendit.
- Në çdo nivel trajtimi, siguria kombëtare duhet të shqyrtohet në të dy rrafshet – shtetëror dhe shoqëror. Në këtë proces duhet të

<sup>36</sup> MORGAN, Patrick **Siguria në politikat ndërkombëtare: qasjet tradicionale.** *Studime bashkëkohore të sigurisë, Pjesa I – Qasjet ndaj sigurisë*, faqe 29. Oxford Press University; redaktuar nga Alan Collins (botimi shqip nga UET Press, redaktor Bashkim Gjergji), ISBN: 978-99956-39-14-3

<sup>37</sup> Qeveria në përgjithësi, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e FSK-së, Agjencia Kosovare e Intelgjencës dhe Policia e Kosovës.

shqyrtohen jo vetëm faktorët tradicionalë, por edhe të gjithë faktorët e rinj të cilët janë paraqitur në dekadën e fundit.

- Grupe të zhvillimit të mendimeve (“think tank”) duhet të ngrihen me qëllim të shtjellimit të të gjitha opsioneve të mundshme për trajtimin e sfidave të sigurisë, si atyre tradicionale dhe jotradicionale. Në këto grupe duhet të përfshihen jo vetëm politikanët dhe ekspertët e sigurisë, por edhe ekspertë nga shkencat e ndryshme sociale (historia, sociologjia, antropologjia, ekonomia, marrëdhëniet ndërkombëtare, etj) dhe shkencat natyrore (metalurgjia, xehetaria, energjetika, shëndetësia, etj).
- Çdo ministri në fushën e vet të veprimit (në bashkëpunim me institucionet e qeverisjes vendore) duhet të hartojë listën e objekteve, shërbimeve dhe vlerave që përbëjnë infrastrukturën kritike nacionale.
- Një grup gjithëpërfshirës nga institucionet përgjegjëse shtetërore dhe shoqëria civile duhet të fillojë punën e mundimshme dhe të gjatë në hartimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Kosovës, si dhe hartimin e ligjit për mbrojtjen e infrastrukturës kritike nacionale.

Mr. sc. Sabit Syla

## BASHKËPUNIMI KOSOVË - SHQIPËRI

Vitet '70 të shekullit XX i karakterizojnë shkëmbimet arsimore, kulturore e shkencore ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe Kosovës. Përmirësimi i marrëdhënieve lidhej ngushtë me zhvillimet ndërkombëtare, me luftën e brendshme në Jugosllavi dhe përpjekjet e Titos për të krijuar balanca brenda vendit, me rritjen e ndërgjegjësimit të shqiptarëve në Kosovë dhe me shtimin e kërkesave të tyre për më shumë të drejta kombëtare dhe institucione të lira, por dhe me shtimin e interesit të vetë Shtetit Shqiptar për të përmirësuar marrëdhëniet me Jugosllavinë. Në fillim të viteve '70, u bë e mundur të vendoseshin kontakte të drejtpërdrejta ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Kjo lidhje ndodhte për herë të parë që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Deri në atë kohë marrëdhëniet zhvilloheshin brenda kuadrit të Federatës Jugosllave apo Republikës së Serbisë. Pas përmirësimit të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, dy shtetet fqinjë shkëmbyen përfaqësuesit diplomatikë mes tyre dhe u krijuan premisat e para për të pasur marrëdhënie të drejtpërdrejta ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe Kosovës. Duke pasur në konsideratë faktin që të dy vendet, pavarësisht nga afrimet e çastit kishin diferenca të rëndësishme në sistemet e qeverisjes, për shqiptarët e Kosovës marrëdhëniet kishin rëndësi jo vetëm në fushën kulturore, arsimore e shkencore, por dhe në sferat e tjera të jetës politike.

Në këtë kuadër, u kërkuan dhe u hartuan forma të institucionalizuara të bashkëpunimit. Një nga këto ishin protokollat për bashkëpunim që u nënshkruan midis Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës, të cilat kishin për qëllim që të ndihmonin në ngritjen e nivelit të kuadrove të reja të UP-së, duke shkuar për specializim dhe eksperiencë pranë katedrave dhe sektorëve të ndryshëm të USHT-së dhe duke dërguar nga Universiteti i Tiranës i disa kuadrove të saj mësimore-shkencore pranë UP-së për të zhvilluar ligjërata, leksione dhe cikle leksionesh me studentë dhe kuadro të UP-së<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme - Tiranë (më tej: AMPJ), viti 1971, dos. 639, fq. 13-19; 30. Informacion mbi marrëdhëniet me Kosovën, 18 qershor 1971.*

Universiteti i Prishtinës e zhvilloi bashkëpunimin me Universitetin e Tiranës në bazë të protokollit të nënshkruar që nga viti 1970. Prej asaj kohe, për çdo vit shkollor këto dy universitete kanë nënshkruar protokolle për bashkëpunim mësimor-shkencor, përveç vitit shkollor 1975/1976<sup>2</sup>. Zhvillimi i bashkëpunimit ndëruniversitar kishte rëndësi të madhe politike në një kohë kur marrëdhëniet midis dy vendeve nuk ishin krejtësisht të normalizuara. Midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë nuk ekzistonte një program i nënshkruar ndërshtetëror mbi bashkëpunimin kulturor-arsimor. Bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri u realizua kryesisht nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta të institucioneve dhe organizatave përkatëse, si: bashkëpunimi ndëruniversitar i shtëpive botuese, bibliotekave, arkivave e muzeve, radiotelevizioneve, këmbimit të shoqërive kulturo-artistike e sportive, filmit, pjesëve teatrale e formave të tjera.

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës nënshkruan midis tyre protokollin për : shkëmbim përvoja e konsultime, kërkime arkivale bibliografike, ekspedita shkencore, ligjërata e shkëmbime të literaturës shkencore etj.<sup>3</sup> Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve e Republikës së Shqipërisë dhe Shoqata e Kompozitorëve e Kosovës, me qëllim që të vendosnin e forconin më tej midis tyre marrëdhëniet, miratuan protokollin për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në shkëmbim përvoja e konsultime, ligjërata, shkëmbime materialesh muzikore, botime e shkëmbime vizitash<sup>4</sup>. Qe arritur marrëveshja e bashkëpunimit kërkimor-shkencor edhe ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit Shqiptar dhe Drejtorisë së Arkivit të Kosovës<sup>5</sup>. Po ashtu që nënshkrua Protokollin mbi Bashkëpunimin midis Radiotelevizionit të Prishtinës dhe Radiotelevizionit Shqiptar. Sipas marrëveshjes, u këmbyen filma arsimorë e shkencorë të

<sup>2</sup> *Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës* (më tej: *ASHAK*), Fondi: Sekretariati Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme, viti 1972-1984, nr. i lëndës 1-97, kutia 4, fq. 4-5. Bashkëpunimi në lëmin e shkencës dhe arsimit.

<sup>3</sup> *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme, viti 1972-1984, nr. i lëndës 1-97, kutia 4, fq. 25. Bashkëpunimi ndërkademi; *AMPJ*, viti 1980, dos. 1194, fq. 1-5.

<sup>4</sup> *AMPJ*, viti 1980, dos. 1193, fq. 1-7. Protokoll i bashkëpunimit ndërmjet Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës, 1980-1981.

<sup>5</sup> *AMPJ*, viti 1980, dos. 1195, f. 1-11. Marrëveshje e bashkëpunimit kërkimor-shkencor në mes Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit Shqiptar dhe Drejtorisë së Arkivit të Kosovës, 1980-1981.

popullarizuar, filma dokumentarë-fejtonistikë, emisione muzikore, u bë pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme, në fushën teknike e këmbime tjera të ndërsjella<sup>6</sup>.

Edhe pse ky bashkëpunim u zhvillua në kushte shumë të ndërlikuara, të jashtme dhe të brendshme, të gjendjes së ndërlikuar dhe në marrëdhëniet nacionale në Jugosllavi, Serbi e Kosovë, ai pati avantazhe në afirmimin e përgjithshëm kombëtar.

Sot bashkëpunimi midis dy vendeve paraqitet si detyrë me rëndësi, me shumë përgjegjësi dhe me interes, si sferë e veçantë e zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet Tiranës dhe Prishtinës. Sot me format të ri dhe me dimensione më të reja, bashkëpunimi është instrument, jo vetëm i marrëdhënieve të mira, por edhe shprehje e forcimit dhe zgjerimit të dijes, mishërimit të ndihmës reciproke, por dhe ndikimit të përparimit kulturor e shoqëror, si nevojë shumë e domosdoshme. Ky bashkëpunim duhet avancuar më tej dhe me më shumë rezultate. Megjithëse ekzistojnë marrëdhënie të shkëlqyera, ato duhet të rriten në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë, të zhvillohen e intensifikohen në të gjitha drejtimet në të mirë të kombit, por dhe të paqes e stabilitetit në rajon.

Bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri duhet të shtrihet në të gjitha sferat e jetës, duke u zbatuar përmes projekteve të përbashkëta në fushën e arsimit, bujqësisë, agrobiznesit, në lëmin e drejtësisë, diplomacisë, ushtrisë, në përvojë, planifikim dhe reformim të sistemit shëndetësor dhe në rrugën e integritit drejt strukturave euroatlantike. Një integrim i tillë është edhe faktor me interes i çështjes shqiptare. Me një fjalë, Tirana dhe Prishtina, si kryeqendra të rëndësishme shkencore e kulturore, politike e diplomatike, duhet të krijojnë një program të përbashkët bashkëpunimi, me ekspertë të fushave të ndryshme, si: informative, politike, diplomatike, ushtarake, ekonomike, zbuluese, strategjike etj.

Theks të veçantë në këtë kumtesë do të vë në bashkëpunimin në lëmin e arsimit, kulturës dhe shkencës, si një nga detyrat më të rëndësishme. Mjaft rezultate në këtë drejtim janë shënuar, por kishte edhe oscilime në këto raporte. Prandaj, duhet evituar mangësitë e

---

<sup>6</sup> *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1962/1984, Nr. i Lëndës 1-55, kutia 1, f. 3. Informatë mbi bashkëpunimin shkencor, kulturo-arsimor dhe teknik i KSA të Kosovës me shtetet fqinjë, Prishtinë, mars 1973.

shfaqura. me një punë më të madhe në të gjithë sektorët. Sot duhet të përcaktojmë mirë praktikat e bashkëpunimit dhe koordinimit të tyre.

Në përputhje me politikën dhe interesat e ndërsjella se në cilat fusha mund të zhvilloheshin më tej marrëdhëniet, mendoj se ekzistojnë të gjitha mundësitë drejt zgjerimit të tyre. Për këtë arsye institucionet në lëmin e arsimit, kulturës dhe shkencës, duhet iniciuar nënshkrimin e marrëveshjeve në shumë fusha. Bashkëpunimi duhet zhvilluar në bazë të protokolleve dhe platformave e objektivave të përbashkëta afatshkurtra, afatmesme e afatgjata. Marrëdhëniet e ndërsjella do të jenë të dobishme dhe me interes kombëtar .

Prandaj, në këtë kuadër, duhet hartuar dhe zbatuar plane orientuese zhvillimore. Si forma të mira shoh nevojën për ndihmë të njëri-tjetrit në ngritjen e nivelit të kuadrove të reja, specializimit dhe eksperiencës pranë katedrave dhe sektorëve të universiteteve nga të dyja anet. Po ashtu, shoh nevojën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të tjera shkencore, shkëmbimin e përvojave nëpërmjet konsultimeve, kërkimeve arkivale e bibliografike, ekspeditave shkencore, ligjëratave, shkëmbimeve të literaturës shkencore etj. Realizimi i tyre i kontribuon lehtësimit dhe përparimit të procesit mësimor, zhvillimit të shkencës dhe afirmimit të rezultateve shkencore.

Bashkëpunimi duhet gjetur mbështetje dhe përkrahje të plotë nga institucionet në Tiranë dhe Prishtinë. Kështu, bartës të projekteve të përbashkëta duhet të jenë si akademitë e shkencave, ashtu dhe institutet e historisë, universitetet etj. Andaj duhet insistuar në një bashkëpunim të plotë të në gjitha sferat e jetës.. Posaçërisht duhet angazhuar në hartimin e planeve e programeve të përbashkëta dhe unifikimin e teksteve shkollore. Në këtë kuadër, përparësi duhet dhënë plan-programeve e teksteve shkollore, me mësim të lëndëve kombëtare nëpërmjet të cilave kultivohet atdhedashuria.

Gjendja e krijuar tashmë është e favorshme, duke dhënë mundësinë e forcimit të lidhjeve në të gjitha aspektet, që marrëdhëniet të zhvillohen me interes dhe në një shkallë gjithnjë e më të gjerë.

Institucionet shkencore në Tiranë dhe Prishtinë duhet paraprirë integrimi të përbashkëta në planin arsimor, kulturor e shkencor, duke u bërë piemonte të tyre, ndërsa institucionet politike duhet dhënë dritën jeshile për këtë.

*Kollokiumi shkencor:  
Bashkëpunimi Kosovë-Shqipëri*

---

Realizimi i ngushtë i bashkëpunimit do t'i kontribuojë lehtësimit dhe përparimit të procesit mësimor e afirmimit të rezultateve shkencore përmes të cilave do të vazhdohet prania, ndikimi, roli dhe afiniteti i përbashkët për një sërë detyrash me karakter arsimor e kulturor, duke kontribuar kështu dhe afirmimin e mëtejshëm kombëtar.

Bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri natyrisht se duhet të jetë edhe më i gjerë. Në kuadër të tij duhet shikuar edhe mundësitë për shtrirje të tij te shqiptarët që kanë mbetur jashtë kufijve të dy shteteve shqiptare. Për të realizuar këtë duhen një sërë platformash, planesh e objektivash të caktuara e të hartuara mirë. Tirana dhe Prishtina duhet që të ndihmonin popullsinë shqiptare në ato vise në drejtim të zhvillimit të përgjithshëm arsimor e kulturor, në luftën e tyre për të ruajtur dhe forcuar të drejtat që u takojnë e për të zhvilluar më tej traditat kombëtare, arsimin, kulturën e shkencën, në mënyrë që ato të mos mbeten e zhvillohen të shkëputura nga traditat, arsimi, kultura dhe shkenca kombëtare.



Akademik Pajazit Nushi

**Fjala përmbyllëse** e punimeve të Kollokuiumit “Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Kosovës”

Pas paraqitjes dhe shqyrtimit të katërmbëdhjetë temave aktuale mbi sfidat e Kosovës dhe ardhmërinë e Republikës së Kosovës, më lejoni që me pak fjalë të bëj përfundimin e këtij tubimi shkencor. Jam i një mendjeje se trajtimi i këtillë i çështjeve me rëndësi kruciale për të tashmen, sidomos për të ardhmen e Kosovës ka dëshmuar aktualitetin e çështjeve të shtruara në këtë kollokuium, duke sugjeruar njëkohësisht edhe nevojën e shqyrtimit të këtij niveli sipas kërkesave dhe ndryshimeve politike, ekonomike dhe sociale të Republikës së Kosovës. Temat e përpunuara treguan se sot Kosova ballafaqohet me sfida të disallojshme. Identifikimi i këtyre sfidave u paraqit premisë e domosdoshme e parashikimit të zhvillimeve shtetndërtuese të Kosovës në vitet e ardhme. Kompleksiteti i kushteve dhe i raporteve të sotme të Kosovës në planin e brendshëm dhe atë të jashtëm kërkon qëndrueshmëri të vazhdueshme studimore të këtyre sfidave dhe të përcaktimit të rrugëve dhe faktorëve të përshpejtimit zhvillimor të shtetit në ndërtim të mirëfilltë të Kosovës. Ndërlikueshmëria e karakterit të sfidave dhe e raporteve ndërmjet tyre më shtyn të propozoj që t’i këthehem shqyrtimit të kësaj teme sipas nevojave aktuale dhe të bëjmë tekstin e veçantë të përfundimeve dhe të rekomandimeve të mundshme, të rëndësishme sidomos për veprimtarët politikë të të gjitha niveleve dhe të fushave zhvillimore e shtetndërtuese të Kosovës. Nga analiza që i bëtë sfidave të ndryshme të shtetndërtimit të Kosovës në momentin e dhënë dallohet nevoja e shqyrtimit të njëmendtë të të gjitha attributeve të një shteti funksional të mirëfilltë.

Seksioni i Shkencave Shoqërore i Akademisë së Shkencave dhe Arteve i Kosovës do të bëjë publikimin e kumtesave dhe të diskutimeve të këtij Kollokuiumi shkencor në një përmbledhje të veçantë dhe secili autor do të ketë mundësinë që kontributin e tij të shtrirë deri në 16 faqe (një tabak autori) të na e dërgojë deri në mbarim të qershorit të këtij viti.

Në fund u jemi shumë mirënjohës dhe falënderues për pjesëmarrjen Tuaj në punimet e këtij Kollokuiumi.

Ju falemnderit.

## PËRMBAJTJA

Pajazit Nushi, <b>FJALA E HAPJES</b> .....	5
Esat Stavileci, <b>REPUBLIKA E KOSOVËS TRE VJET NGA SHPALLJA E PAVARËSISË</b> .....	9
Arian Starova, <b>MBI SFIDAT PARËSORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b> .....	23
Ibrahim Gashi, <b>REPUBLIKA E KOSOVËS SI SUBJEKT LEGAL NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE</b> .....	31
Isa Mustafa, <b>QËNDRUESHMËRIA E POLITIKAVE MAKROEKONOMIKE ZHVILLIMORE TË KOSOVËS</b>	41
Riza Smaka, <b>SHKAQET DHE DIMENSIONET PËR MODIFIKIME DHE NOVELIME KUSHTETUTARE</b> ....	49
Ramadan Qehaja, <b>VLERËSIM KRITIK I SFIDAVE TË SIGURISË DHE TË ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS</b> .....	67
Mazllum Baraliu, <b>GJENDJA DHE PROBLEMET E LEGJISLACIONIT ELEKTORAL DHE KODIFIKIMI I TIJ SI IMPERATIV</b> .....	75
Mark Krasniqi, <b>KOSOVA NË VEPRA TË AUTORËVE SERBË</b> .....	97
Pajazit Nushi, <b>TË DREJTAT E NJERIUT DHE KORELATAT TEORIKE E PRAKTIKE ME FAKTORËT SHTETNDËRTUES TË KOSOVËS</b> .....	109
Hivzi Islami, <b>SHKAQET DHE EFEKTET E DËSHTIMIT TË REGJISTRIMIT TË POPULLSISË</b> .....	115
Frashër Demaj, <b>POZITA E SHKENCËS NË KOSOVËN E PAVARUR</b> .....	129
Bejtush Gashi, Agron Jusufi, <b>KONCEPTET POLITIKE TË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË SIGURISË SË KOSOVËS</b> .....	135
Sabit Syla, <b>BASHKËPUNIMI KOSOVË-SHQIPËRI</b> .....	159
Pajazit Nushi, <b>FJALA PËRMBYLLËSE</b> .....	165

**SFIDAT E SHKETNDËRTIMIT DHE  
E ARDHMJA E KOSOVËS  
2012**

*Botues*  
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

*Lektor:*  
Shefqet Riza

*Redaktor teknik:*  
Taulant Veseli

*Realizimi kompjuterik:*  
ASHAK

Madhësia: 10.3 tabakë shtypi  
Tirazhi: 300 copë  
Formati: 16x24 cm

Shtypi:  
Prograf  
Prishtinë

Katalogimi në publikim - (CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

323.1(496.51)

Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Kosovës : Kollokuiumi  
Shkencor 15 qershor 2011 / redaktor Pajazit Nushi. - Prishtinë :  
Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2012. 544 f. :  
ilustr. ; 24 cm. (ASHAK : Seksioni i Shkencave Shqërore)

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze

1.Nushi, Pajazit

**ISBN 978-9951-615-05-1**